



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Berat”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË BERAT

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	22
II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....	25
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA	25
1. Objektivi i auditimit.....	25
2. Qëllimi i auditimit.....	26
3. Identifikimi i çështjes.....	26
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	26
5. Përgjegjësitë e audituesve	27
6. Kriteret e vlerësimit	27
7. Standardet e auditimit	28
8. Metoda e auditimit.....	28
9. Dokumentimi i auditimit.....	30
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	31
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	31
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	31
2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	31
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	48
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.....	80
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	106
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	158
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.....	177
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	182
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	217
MASA DISIPLINORE.....	255
V. ANEKSET.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 208/1 Prot, datë 10.03.2023 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 27.03.2023 deri në datë 05.05.2023, në Institucionin Bashkia Berat u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i aseteve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 19 akt konstatime.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, me subjektin Bashkia Berat nuk është kërkuar që të kryhet takimi përmblylës pranë zyrave të KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a në raportin përfundi mtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
I	<ul style="list-style-type: none">-Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se Bashkia Berat nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranura të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullin III, pika 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.-Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimt për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.-Për vitin 2022 titullari i Bashkisë Berat nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.-Për 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e	31-47	Lartë	<ul style="list-style-type: none">-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.-Titullari i institucionit të ngrëjë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune real për zbatimin e menjëhershëm të tyre.-Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

<p>kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”.</p> <p>-Bashkia Berat e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me shkresën nr. 737, datë 07.02. 2018 “Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Berat dhe institucioneve në varësi”. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.</p> <p>-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.</p> <p>-Bashkia Berat për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.</p> <p>-Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të riskut për vitin 2022, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut, nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.</p> <p>-Titullari i Bashkisë për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.</p> <p>-Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Berat, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.</p> <p>-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Berat ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim nenin 8 të këtij ligji.</p> <p>-Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Berat mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.</p>			
--	--	--	--

2	<p>Njësia e auditit të brendshëm sipas strukturës së miratuar përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në fakt kjo njësi nuk është e plotësuar sipas strukturës së miratuar, pasi për vitin 2022, përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.212, date 30.03.2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 2, ku përcaktohet se Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi 3 anëtarë, përfshirë drejtuesin e njësisë.</p>	31-47	Lartë	<p>Titullari i institucionit dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditit të Brendshëm me specialistë sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim kryerjen e auditimeve pa cënuar veprimtarinë e kësaj strukture, marrjen e masave për kryerjen e auditimeve me risk, rritjen e numrit të auditimeve dhe evidentimin e problematikave, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në dobi të komunitetit duke eliminuar në të ardhmen mangësitë e konstatuara.</p>
3	<p>Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka hartuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Berat.</p> <p>-Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk është hartuar “Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.</p> <p>-Njësia e Auditit të Brendshëm megjithëse ka realizuar planin vjetor të auditimeve, konstatojmë se nuk janë audituar drejtori që paraqesin risk në këtë Bashki si, Drejtorja e Integritimit Europian dhe Projekteve, Drejtorja e Tatim taksave dhe tarifave të bizneseve, Drejtorja e Planifikimit Urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve Drejtorja e shërbimit social dhe ndihmës ekonomike, Drejtorja e Turizmit dhe aktiviteteve, etj.</p> <p>-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.</p> <p>-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.</p> <p>-Nuk janë audituar fushat me risk si edhe nuk është audituar ecuria dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH.</p> <p>-Mungon memo e planifikimit të auditimit në të gjitha dosjet e auditimit.</p> <p>Për vitin 2022, mbi 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Berat, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim</p>	31-47	Lartë	<p>-Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e realizimit të tyre.</p> <p>-Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në drejtori që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.</p>
4	<p>Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, kanë</p>	47-79	Lartë	<p>Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtorisë së</p>

	<p>diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar konkretisht, totali i buxhetit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 2,153,808 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,769,650 mijë lekë ose në masën 82% me një mosrealizim në vlerën 384,158 mijë lekë.</p> <p>-Për Artikullin 600 "Paga" është planifikuar në vlerën 480,793 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 440,671 mijë lekë ose në masën 92%. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë e vendeve vakant në strukturë si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë. Konkretisht numri i punonjësve në strukturën e Bashkisë Berat për vitin 2022 është 776 punonjës dhe numri faktik mesatar është 733 pra ka 43 vende vakante ku struktura është realizuar në masën 94%.</p> <p>-Për Artikullin 601 "Sigurime shoqërore" është planifikuar në vlerën 80,935 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 74,626 mijë lekë ose në masën 92%.</p> <p>-Për Artikullin 602 "Mallra dhe shërbime të tjera" është planifikuar në vlerën 450,600 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 340,481 mijë lekë ose në masën 76%.</p> <p>-Për Artikullin 603 "Subvencione" është planifikuar në vlerën 33,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 33,000 mijë lekë ose në masën 100%.</p> <p>Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për F.. "T." Sh.a, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë. Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga F. "T." Sh.a për financimin e shpenzimeve të domosdoshme.</p> <p>-Për Artikullin 604 "Transferta korrente të brendshme" është planifikuar në vlerën 10,742 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 9,168 mijë lekë ose në masën 85%. Këto shpenzime përfaqësojnë detyrimet kontraktuale apo ligjore ndaj agjentëve për arkëtimin e taksave dhe tarifave si psh Ujësjiellësi për tarifën e arketuara nga familjet, Drejtoria Rajonale e Tatimeve për për Tatimin e thjeshtuar dhe Tatimit mbi të ardhurat personale.</p> <p>-Për Artikullin 606 "Transferta për buxhetet, familjet dhe individët" është planifikuar në vlerën 510,914 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 484,037 mijë lekë ose në masën 95%. Transfertat për përfituesit e ndihmës ekonomike, paaftësisë, bursat për nxënësit e arsimit parashkollor dhe të mesëm, ndihmat për rastet e fatkeqësive.</p> <p>-Për Artikullin 609 "Fondi rezervë dhe i kontigjencës" është planifikuar në vlerën 581,821 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 387,664 mijë lekë ose në masën 67%.</p>			<p>Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.</p>
5	<p>Bashkia Berat në datën 01.01.2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 95,527,220 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 77,527,220 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 60,876,887 lekë, ose 78 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 16,650,333 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja</p>	47-79	Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të</p>

	<p>të prapambetura në vlerën 1,367,992 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 36,018,325 lekë. Bashkia Berat ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, të cilat janë detyrime për investime nga Ministria e Infrastrukturës në vlerën 75,056,351 lekë, është krijuar gjatë vitit 2022 detyrim me vlerë 138,662,088 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në vlerën 173,518,439 lekë.</p> <p>Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2022, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur me 59,508,895 lekë, ose në masën prej 41.5%.</p> <p>Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 32,415,751 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 1,067,850 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 576,800 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 1,706,384 lekë, detyrime të tjera në vlerën 251,540 lekë.</p>			<p>prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.</p>
6	<p>Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura.</p>	47-79	Lartë	<p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.</p> <p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit buxhetor aktual.</p>
7	<p>Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Berat në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në ifrastrukturë dhe DRSHTRR Berat në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Berat nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në</p>	47-79	Lartë	<p>Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo</p>

	<p>bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura.</p>			<p>të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me insitucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.</p>
8	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 7 (shtatë) procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjen. Gjithashtu rezultoi se disa prej kërkesave të veçanta si licenca, akte ekspertiza ligjore etj., në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. Vendosja e kriterëve kufizues dhe të pa argumentuara sjellin për pasojë diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu në 4 procedura prokurimi rezultoi se nuk janë argumentuar specifikimet teknike të vendosura. Veprime e mosveprime këto të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik</p>	108-160	Lartë	<p>Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.</p>
9	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit për vitin 2022 rezultoi se janë kryer 2 procedura prokurimi ndara nga njëra tjetra, me të njëjtin kod CPV dhe objekt prokurimi, të cilat konsiderohen copëzime fondesh dhe shmangie nga kryerja e procedurave standarde të prokurimit. Procedura të cilat janë trajtuar sipas kriterëve midis kufijve të ulët dhe të lartë monetar, pra nëse do të kryheshin së bashku vlera e tyre shkon mbi kufirin e lartë monetar. Kryerja në mënyrë copëzuar të fondeve, ul afatet e pranimit të dokumentacionit, nuk u jep kohë OE të marrin informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e përgatitjes së dokumentacionit mbi kriteret e kërkuara, <i>duke sjellë një konkurrencë jo të ndershme, pabarazi midis OE, përdorim fondesh jo në përputhje me parimet e efikasitetit, efektivitetit, nuk nxit pjesëmarrjen, trajtimin e barabartë, dhe mosdiskriminimin e OE.</i></p>	108-160	Lartë	<p>Autoriteti kontraktor Bashkia Berat, të marrin masat që, gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore.</p>
10	<p>Në dosjen teknike të investimit sipas kontratës “Blerje asfalt” është paraqitur një projektzbatim i cili nuk është nënshkruar nga personat e cituar, duke mos vërtetuar në këtë mënyrë procesin e ndjekur për hartimin e projektzbatimit, subjekti, apo personat të cilët e kanë</p>	108-160	Lartë	<p>Bashkia Berat të marrë masat e duhura për realizimin e investimeve në respekt të dispozitave ligjore për realizimin e tyre. Krahas tenderimit për bazë materiale, duhet të bëhen</p>

	<p>realizuar etj. Për këtë kontratë arrihet në konkluzionin se realizimi i punimeve civile nga subjekte të pa licencuara, nuk jepet garanci për realizimin e investimit konformë kushteve teknike të zbatimit.</p> <p>Nuk garantohet cilësia e materialeve të përdorura në ndërtim, për pasojë nuk garantohet jetëgjatësia e punimeve, rrjedhimisht eficienta e përdorimit të fondeve.</p> <p>Ndërtimi në përgjithësi dhe i infrastrukturës në këtë rast, kërkon realizimin e disa proceseve që kanë lidhje me përgjegjësinë e realizimit më cilësi, në sasi dhe sipas projekteve të miratuara, të mbikëqyrjes hap pas hapi dhe dokumentimit. Në mungesë të certifikatave të cilësisë së materialeve, në mungesë të testimit, në mungesë të librit të masave, nuk mund të jepet një opinion nëse punimet janë realizuar me cilësi dhe sasinë e kërkuar.</p>			tenderime për realizimin e punimeve nga subjekte të licencuara sipas objektit në të cilin prokurohet, si dhe realizimi i punimeve duhet të dokumentohet dhe raportohet për të garantuar realizim në sasi dhe cilësi.
I1	<p>Nga auditimi konstatohet se ka kaluar një periudhë mbi 6 muaj referuar kolauditimit të punimeve dhe objekti nuk është marrë akoma në dorëzim nga Bashkia Berat.</p>	108-160	Lartë	Bashkia Berat të marrë masa për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve sipas kontratës përkatëse.
I2	<p>Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit gazoil për 5 automjete të Aparatit të Bashkisë Berat konstatohet se, nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.,. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.</p>	213-217	Lartë	<p>-Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.</p> <p>-Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për automjetet, makineritë-pajisjet e bashkisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.</p>
I3	<p>Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat më datën 31.12.2022 (vlerë e cila e konstatuar përgjatë auditimit), konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 411,883,674 lekë (prej 279,310,927 lekë ose 67.8 % të debitorëve e zënë debitorët e taksave) ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 434,784,105 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 155,473,178 lekë.</p> <p>2. Gjithashtu konstatohet se, për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nga analiza e kësaj llogarie vlera prej 62,019,852 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë</p>	47-79	Lartë	<p>-Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të sistemoj llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.</p> <p>-Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për evidentimin dhe</p>

	analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish-Komunat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish-Komunat kaluan në administrim nga Bashkia Berat, me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për gjetjen e origjinës dhe arkëtimin e kësaj vlere.			dokumentimin në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 62,019,852 lekë trashëguar nga ish-Komunat.
14	<p>Nga auditimi konstatohet se, në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj..) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël.</p> <p>Për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 2 prona si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 7659 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 49 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) NJSH, ndërsa 2 objekte janë transferuar me VKM e sipercituara dhe janë të pajisura me certifikat pronësie. Nga Drejtoria e Shërbimeve, Emergjencave civile dhe Pronave, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Berat në Drejtorinë rajoneve të ASHK Berat, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 51 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Berat. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.</p>	47-79	Lartë	<p>-Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrën masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.</p> <p>-Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.</p> <p>- Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 51 prona të certifikuara në ASHK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiare.</p>
15	Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se deri më datën 31.12.2022, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 97,337,675 lekë në total në Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë Sh.a dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Berat.	47-79	Lartë	Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për sistemin e vlerën 97,337,675 lekë në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e cila i përket aktiveve të transferuara nga Bashkia Berat drejt Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë.
16	Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 283,538,478 lekë kosto historike. Në këtë vlerë është përfshirë edhe tre mjete konkretisht Kamion me targe TR...., Fadroma B., Ekskavator N.. me vlerë kosto historike 4,922,000 lekë të cilat nuk është në gjendje pune. Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së	47-79	Lartë	Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemin e vlerës 4,922,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 3 automjeteve të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive

	përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 4,922,000 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohesh në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.			afatgjata të dëmtuara”.
17	Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, me NUIS “J.....” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë.	47-79	Lartë	Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
18	Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 21,101,803 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 414,238,546 lekë dhe pakësim në vlerën 430,582,053 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,758,296 lekë. Shtesa e detyrime të Bashkisë Berat për llogarinë 401-408 gjatë vitit 2022 është në vlerën 4,758,296 lekë e cila përbëhet nga 20 shpenzime kryesisht kontrata supervizimi/mbikëqyrje, shërbime dhe blerje mallrash të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten më sipër. Angazhime të marra mbi bazën e planifikimit të pritshëm për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë por këto angazhime janë marrë pa u siguruar të ardhurat reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 217,685,991 lekë.	47-79	Lartë	Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 217,685,991 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

	Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 279,603,637 lekë dhe pakësim në vlerën 246,211,533 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,685,991 lekë të cilat i përkasin kryesisht vendimeve gjyqësore, shërbimeve dhe blerjeve.			
19	Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 85,583,155 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit Berat. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 20,346,860 lekë dhe pakësim në vlerën 17,434,270 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 88,495,745 lekë. Për 109 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia janë ngurtësuar fonde në vlerën 63,016,632 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.	47-79	Lartë	Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.
20	Nga auditimi i procesit të nxjerrjes jashë përdormit të aktiveve, në dy raste për Qendrën Lira dhe Agjencinë e Shërbimeve Publike Berat, në total janë asgjësuar aktive në vlerën totale 1,727,548 lekë për të cilat nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Konkretisht nuk dokumentohet mënyra e dorëzimit të aktiveve në vend depozitim.	47-79	Lartë	Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.
21	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planit e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit., përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjia “30 Vjetori”, Berat; 2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjia “Clirim”, Berat; 3. “ Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masat e duhura për të verifikuar materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse, përpara miratimit të lejeve.

	eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat.			
22	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika në të cilën pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)", për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja "30 Vjetori", Berat; 2. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat; 3."Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat; 4. "Magazinë për bujqësinë 2 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja "Parangua", Berat.	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.
23	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen e mënyrës dhe mungesën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)", për të cilën është marrë vendimi Nr.432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja "30 Vjetori", Berat; 2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr.636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat.	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi. Gjithashtu në parcelat të cilat pozicionohen në zonat e reja për zhvillim dhe kufizohen/bëjnë pjesë në njësi për të cilat është parashikuar zhvillimi i Planit të Detajuar Vendor, bashkia të procedojë me miratimin e PDV-së për të gjithë zonën, në të cilën parashikohet edhe koncepti për infrastrukturën e re, e më pas të vijojnë me miratimin e lejeve të ndërtimit.
24	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktikë tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores së planit të miratuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat; 2."Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat.	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar tipologjinë e ndërtimit të lejuar në bazë të njësive strukturore, të përcaktuara sipas planit dhe të zhvillojë propozime të reja për përmirësim e Planit të Përgjithshëm Vendor, në bazë të nevojave dhe kërkesave të reja të zhvillimit të qytetit.
25	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit

	me mosparaqitjen e saktë të rievimit topografik që pasqyron gjendjen ekzistuese të parcelës e objekteve me të cilat kufizohet dhe mospasqyrimi i duhur i planvendosjes në të cilën evidentohet njolla e objektit mbi parcelën që do të zhvillohet, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1."Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat; 2."Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat.			pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem, si edhe të verifikojë planvendosjen që të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konform kushteve teknike të projektimit.
26	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1."Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat; 2. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat; 3. "Magazinë për bujqësinë 2 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja "Parangua", Berat.	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.
27	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m ² , por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m ² , duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat	160-178	Lartë	Nga DPZHT Berat të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje aplikimin e lejeve të ndërtimit dhe sipërfaqeve të ndërtimit, në mënyrë që mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.
28	Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Berat nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 55/15, datë 27.07.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht: -Nga 25 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 Masa Organizative, janë realizuar 1 masë, janë në proces 7 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa. -Nga 6 Masa Dëm Ekonomik, janë pranuar plotësisht	184-218	Lartë	Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara duke rikërkuar zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon; Për 7 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, 3 masa janë pjesërisht të zbatuara si dhe për 14 masa organizative të pa zbatuara. Për 4 masa dëm ekonomik, të cilat

	<p>për zbatim 6 Masa, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe janë ende në proces zbatimi 4 masa.</p> <p>-Nga 10 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 10 masa, të cilat janë në proces zbatimi 10 masa.</p> <p>-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Berat: 1 rekomandim për 13 punonjës në lidhje me procedurat e prokurimit, i cili është i pa zbatuar, 1 rekomandim për 2 mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e punimeve i cili është realizuar, 1 rekomandim për 3 punonjës për probleme të konstatuara në fushën e IMT, i cili nuk është pranuar, pra i pa realizuar si dhe për 2 punonjës të PMZSH, i cili është realizuar. Gjithashtu është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezultoi e pa zbatuar.</p>			<p>janë ende në proces zbatimi.</p> <p>Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, nga të cilat janë 10 masa në proces zbatimi;</p> <p>Për rekomandimin e lënë në lidhje me marrjen e masa disiplinore, të lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkia Berat, nga ku rezultoi asnjë masë e dhënë për 13 punonjës dhe një masë administrative të cilat janë pa realizuar.</p>
29	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Berat nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 55/15, datë 27.07.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:</p> <p>-Nga 25 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 Masa Organizative, janë realizuar 1 masë, janë në proces 7 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.</p> <p>-Nga 6 Masa Dëm Ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim 6 Masa, nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe janë ende në proces zbatimi 5 masa.</p> <p>-Nga 10 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 10 masa, të cilat janë në proces zbatimi 10 masa.</p> <p>-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Berat: 1 rekomandim për 13 punonjës në lidhje me procedurat e prokurimit, i cili është i pa zbatuar, 1 rekomandim për 2 mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e punimeve i cili është realizuar, 1 rekomandim për 3 punonjës për probleme të konstatuara në fushën e IMT, i cili nuk është pranuar, pra i pa realizuar si dhe për 2 punonjës të PMZSH, i cili është realizuar. Gjithashtu është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezultoi e pa zbatuar.</p>	184-218	Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara duke rikërkuar zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;</p> <p>Për 7 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, 3 masa janë pjesërisht të zbatuara si dhe për 14 masa organizative të pa zbatuara.</p> <p>Për 6 masa dëm ekonomik, të cilat janë ende në proces zbatimi.</p> <p>Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, nga të cilat janë 10 masa në proces zbatimi;</p> <p>Për rekomandimin e lënë në lidhje me marrjen e masa disiplinore, të lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkia Berat, nga ku rezultoi asnjë masë e dhënë për 13 punonjës dhe një masë administrative të cilat janë pa realizuar.</p>
30	Në katër raste, nga auditimi i procedurave të prokurimit	108-160	Lartë	Autoriteti Kontraktor, Personi

	<p>me objekt: 1-“Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat”; 2-“Ndriçimi i qytetit Berat”, 3-“Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat” dhe 4-“Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik” konstatohet se, në mënyrë të gabuar, është caktuar i njëjti zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e preventivit të punimeve(fondit limit), specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit), po ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, çka përbën “konflikt interesi” në kuptimin e LPP-së si dhe cënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit.</p>			<p>përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.</p>
31	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (librit të masave), sipas kontratës “Ujësjetësi i Fshatit Duhanas, Fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, rezulton se ka pasaktësi në lidhje me raportimin e sasisë së tubacioneve, sipas diametrave përkatës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për linjat në zonën Otlak dhe Orizaj, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1. “Furnizim vendosje i tubave (përfshirë të gjitha mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin”, sasi të e raportuara në librin e masave dhe situacion përfundimtar, nuk është raportuar në mënyrë të saktë. Është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 50, Ø 63, Ø 75, Ø 110 dhe më pak për diametër Ø 140. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën 35,241 lekë. Po ashtu, për linjën në zonën Duhanas, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1 është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 75 dhe Ø 110. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën 56,435 lekë. - Në zonën Otlak-Orizaj, pas vendosjes së tubave për lidhjet e shtëpive, nuk është bërë rehabilitimi i shtresave asfaltike, në sasinë 76 m². Vlera 449,920 lekë (76 m² x 5,920 lekë/m²), është certifikuar më tepër. Mos rehabilitimi i rrugëve sipas specifikimeve, përveç vështirësisë që krijohen për përdoruesit e tyre, bën që dëmtimi i shtresave të rritet në mënyrë të vazhdueshme, duke çuar në degradimin e plotë të shtresave rrugore. - Në zonën Lapardha 1, rehabilitimi i sipërfaqes pas vendosjes së tubacioneve për lidhjen e shtëpive sipas zërit B.6.5 “Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare të rrugëve të asfaltuara”, është ndërtuar vetëm me binder dhe jo asfaltobeton. Për këtë zonë është certifikuar sasia 173.6 m², nga e cila sasia rreth 160 m², rezulton jo me shtresë asfaltike, por binder. Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, manuali nr. 3, çmimi për shtresë asfaltobeton me trashësi 6 cm është 2,049 lekë/m². Vlera 327,840 lekë (160 m² x 2,049 lekë/m²), është certifikuar në 	108-160	Lartë	<ul style="list-style-type: none"> -Bashkia Berat të marrë masa për ndalimin nga pagesa e garancisë së punimeve të vlerës 91,676 lekë, për përfitim të padrejtë nga ana e Kontraktorit BOE “R. & 2...” SHPK, si llogaritje të gabuara për dimensionet e tubacioneve. -Bashkia Berat të kërkojë nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori marrjen e masave për rehabilitimin e shtresave rrugore të dëmtuara nga ndërhyrjet për vendosjen e tubacionit dhe të pa rehabilituara brenda periudhës së garancisë së riparimit të defekteve. Në rast të mos zbatimit sipas specifikimeve teknike, të zbritet vlera 777,760 lekë nga garancia e punimeve dhe të zbatohen sanksionet përkatëse, sipas dëmit të vlerësuar.

	kundërshtim me specififikimet teknike. Mos realizimi i shtresave sipas përcaktimeve, rezulton me dëmtim të shpejtë të tyre, duke rritur shpenzimet për rehabilitimin e mëtejshëm të tyre.			
32	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Sallë Konferencash Berat", për të cilën është marrë vendimi Nr.204, datë 25/03/2022, me zhvillues D. J., në adresën lagjja "Donika Kastrioti" Berat, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 203,900 lekë.	160-178	Lartë	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës 203,900 lekë që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
33	Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 është shpenzuar vlerën 13,199,926 lekë, nga e cila vlera 8,199,565 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 6 raste, ndërsa vlera 5,000,361 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi (dënim me gjobë IMT, dëmshpërblim dëmi). Për sa trajtuar më sipër vlera 13,199,926 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Berat . Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, pika 60. Gjithashtu Bashkia Berat ka zbatuar vendimin gjyqësor nr. 283, datë 22.04.2022, për shlyerjen e detyrimeve ndaj përfituesve të PAK, si detyrime të prapambetura si rezultat e moszbatimit të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, dhe dëmin e shkaktuar nga moslikujdimi në kohë, në vlerën 6,377,140 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financiare për Buxhetin e Shtetit .	47-79	Lartë	Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
34	Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 5 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. Ligjit nr. 162/2020, datë	47-79	Lartë	Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020,

	<p>23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 94, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”. Pjesë e këtij buxheti janë parashikuar edhe fondet për projektet artistike të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”. Nga Bashkia Berat për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 2 subjekte është likuiduar shuma 1,631,150 lekë. Vlera 1,631,150 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.</p>			<p>“Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.</p>
35	<p>Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Berat konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën 205,801,565 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën 60,045,082 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Berat janë në vlerën 265,846,647 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat</p>			<p>Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale 265,846,647 lekë</p>
36	<p>Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikim Urban Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizinit Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Berat). Konkretisht deri më datën 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 48,995,273 lekë nga të cilat deri më datë 31.12.2022, është likuiduar vlera 13,525,010 lekë si dhe kanë mbetur për likuidimin e kësaj takse 1,229 persona në vlerën 35,470,263 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat. Gjithashtu Bashkia Berat nuk ka të evedentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat jetë drejtuar ASHK Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>	47-79	Lartë	<p>-Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 35,470,263 lekë ndaj 1,229 personave. -Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Berat vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>
37	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me licensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe</p>	47-79	Lartë	<p>Drejtorja e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në</p>

	<p>derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejinin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve, konstatohet se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 20 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 20 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, nga të cilat 8 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 8 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 1 subjekt i cili nuk ushtron aktivitet në tregtim me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre si dhe nuk janë licensuar me leje tregtim karburanti 8 subjete të cilat ushtrojnë aktivitet dhe kanë pa paguar detyrimin fiskal në vlerën 6,700,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat. Gjithashtu në dy raste janë nënshkruar aktmarrëveshje me subjektet për pagimin me këste të detyrimeve.</p>			<p>bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisen me licensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën 6,700,000 lekë, për 8 subjekte.</p>
38	<p>Kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore: Bashkia Berat ka aktive 11 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore të cilat i përkasin Njësisë Administrative Velabisht që prej vitit 2008. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Velabisht. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën 37,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat.</p> <p>b. Kontratat për dhënien me qira të ndërtesave: Për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total janë nënshkruar 15 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve apo efiteozë të cilat administrohen nga Bashkia Berat. Bashkia Berat posedon titull pronësie (Vërtetim hipotekor) vetëm për 4 objekte për të cilat janë nënshkruar 3 kontrata qiraje ndërsa për 11 objekte për të cilat janë nënshkruar 11 kontrata qiraje nuk posedon titull pronësie, ndërkohë që këto objekte janë dhënë me qira. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka lidhur kontrata të reja me subjektet po ka vazhduar me</p>	47-79	Lartë	<p>-Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve me të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 172,195 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve të cilët kanë marrë me qira tokë bujqësore dhe ndërtesa me qira.</p> <p>- Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë sa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e</p>

	<p>kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit i cili administron 14 kontrata konstatohet se, 1 subjekt nuk ka shlyer detyrimet e kontratës në vlerën 135,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat.</p> <p>c. Ligjshmëria e lidhjes së kontratave të qirasë të ndërtesave/objekteve:</p> <p>Nga auditimi i ligjshmërisë së 14 kontratave të sipërpërmendura për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën e konkurimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në 14 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore; -Në 14 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen; -Në 14 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë; -Në 14 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR; -Në 14 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore; -Në 14 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin. <p>d. Mbi monitorimin e kontratave:</p> <p>Duke u bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Berat nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 14 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.</p>			<p>tyre.</p> <p>- Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.</p>
39	<p>Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Berat, Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se për vitin 2022 por edhe para kësaj periudhe, në territorin e Bashkisë Berat kanë ushtruar aktivitetet subjektet të cilat kanë lidhur kontrata për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor deri më datë 31.12.2022, ku detyrimi i tyre i pa likuiduar është në vlerën 126,595,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Berat. Gjithashtu në Bashkinë Berat 7 subjektet që ushtrojnë aktivitetet shfrytëzimi konkretisht nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.</p>	47-79	Lartë	<p>-Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë masat e duhura dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 92,473,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj 5 subjekteve debitorë të cilët ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit minerar dhe inerteve. Gjithashtu për 2 subjektet e tjerë të cilët kanë detyrimin në vlerën prej 34,112,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor nuk mund të japim një rekomandim deri në shprehjen me vendim të</p>

				Gjykatës në lidhje me këto procese. - Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veternar të masa të menjëhershme ku t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.
40	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Berat, gjatë periudhës 01.01.2022 -3 1.12.2022, ka marrë 14 vendime për "Dënim me gjobë", nga të cilat 6 janë likuaduar, ndërsa 8 vendime janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 1 vit, 1,350,000 lekë. Vendimet për gjobë janë dhënë në vitin 2022 dhe në vitin 2023 është vijuar me kërkesë për urdhër ekzekutimi.	178-184	Lartë	IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 1,350,000 lekë.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një **opinion të modifikuar/kualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2022 të Bashkisë Berat, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2, fq. 141, "**Opinion i kualifikuar**" jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë, ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të konsoliduara të vitin 2021, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar . Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 19,529,598 lekë, si dhe anomali të mëposhtme:

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 155,473,178 lekë, e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” është përfshirë vlera 62,019,852 lekë e trashëguar nga ish-Komunat e pa analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.

-Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 88,163,131 lekë kosto historike e cila përbëhet nga 68 projekte të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

-Në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” e cila paraqitet në vlerën 33,763,064 lekë dhe llogarinë 211 “Pyje placione” e cila në vlerën 1,515,800 lekë më datë 31.12.2022, nuk posedon titull pronësie si dhe në këtë llogari nuk janë pasqyruar asetet e transferuara të ish-komunave.

-Në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është pasqyruar vlera 97,337,675 lekë, e cila i përket asetëve të transferuara në Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë.

-Në llogarinë 215 “Mjete transporti” është pasqyruar vlera kosto historike 4,922,000 lekë e cila i përket 3 automjeteve të dëmtuara, vler e cila duhet të kontabilizohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

-Në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” nuk është kontabilizuar vlera vlerë 572,787,000 lekë e cila i përket kapitalit të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 217,685,991 lekë dhe përfaqëson detyrime për vendimet gjyqësore, shërbime dhe investime.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 88,495,745 lekë, nga të cilat 63,016,632 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Berat nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga Bashkia Berat të kuadrit

rregullator në fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë konstatuar anomali materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni kundërt për fushën e zhvillimit të procedurave.

Baza për dhënien e opinionit të kundërt²

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Berat nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 434,784,105 lekë.

-Në 7 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe konkretisht për procedurat me objekt: “Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat”, 2 procedurat me objekt “Blerje asfalti”, “Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë dhe drejtorive vartëse”, “Përmiresimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara”, “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat” dhe “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik”.

-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.

1-Në 3 praktika u konstatua mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

2-Në 4 praktika u konstatua mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cënon zhvillimin e ndërtimeve të reja.

3-Në 4 raste u konstatua mospasqyrimi i mënyrës së aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimit dhe mungesa e saj ndikon në cënimin e pasurive të tjera me anë të të cilës kufizohet pasuria.

4-Në 2 raste u konstatua mospasqyrimi i saktë dhe me të gjithë elementët e ndërtimit të gjendjes ekzistuese, ndikon në zhvillimin e parcelës e në treguesit e zhvillimit.

5-Në 3 raste u konstatua mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

6-Në 1 rast u konstatua se aplikimi i lejes së ndërtimit ishte jo në përputhshmëri me kategorinë e lejes.

7- Në 1 rast u konstatua mosrealizimi i pozicionimit të njollës së ndërtimit në përputhje me planvendosjen e miratuar.

8-Në 1 rast u konstatua mosrealizimi i nënshkrimit të kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale.

9-Në 1 rast u konstatua mosllogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Është konstatuar dëm ekonomik në shumën totale 1,073,336 lekë, nga të cilat shuma prej 869,436 lekë nga zbatimi i kontratave të punimeve dhe në shumën 203,900 lekë nga mos llogaritja e saktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

² Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, **Opinion i kundërt jepet nëse rastet kur mospërputhjet janë materiale dhe të përhapura, fq 105.**

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Berat:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Berat.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 208/1 Prot, datë 10.03.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 27.03.2023 deri në datë 05.05.2023, në subjektin Bashkia Berat u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. M., *Përgjegjës Grupi,*
2. M. H., *Anëtar,*
3. M. B., *Anëtare,*
4. O. F., *Anëtare,*
5. A. T., *Anëtar.*

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrishtu.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivi i auditimit.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Berat kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Berat është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Berat dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Berat.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Berat.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Berat, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

³Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Berat është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Berat. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e

- të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
 - Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
 - Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH^{-së}”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
 - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{-së} e ndryshuar;
 - Rregullore mbi organizimin e funksionimit e Bashkisë Berat, etj.
 - Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Berat grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metoda e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Berat me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁴.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{-ja} aplikon⁵.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënive mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në

⁴ ISSAI 1315

⁵ *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Zona Gjeografike: Bashkia Berat kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Berat (Ura Vajgurore), në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Qyteti shtrihet përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia numëron 60.031 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 98.875 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 379.98 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Beratit, pas ndarjes së re territoriale, është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, duke gërshtetur kështu karakteristika nga më të larmishmet.

Qyteti i Beratit, për shkak të historisë së tij mijërvjeçare si zonë e banuar, mbart vlera historike dhe arkitektonike të rralla, duke u përfshirë kështu në vitin 2008 dhe në listën qyteteve muze të mbrojtur nga U..... Qendra Historike e qytetit, ku bëjnë pjesë tre lagjet muze “Kala”, “Mangalem”, “Goricë” dhe Qendra Mesjetare, përfshijnë rreth 490 monumente kulture. Vlerat historike, por dhe bukuria natyrore e qytetit të shtrirë përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor, po tërheqin gjithmonë dhe më shumë turistë përgjatë të gjitha stinëve, duke nxitur shumë nga banorët të kthejnë shtëpitë e tyre karakteristike në bujtina për turistët dhe duke shtuar të ardhurat nga turizmi.

Bashkia e Beratit pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia administrative Berat (qyteteti), njësia administrative Velabisht, Otlak, Sinjë, Roshnik.

Misioni i Bashkisë Berat është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësisë të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

a) *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;*

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se ‘*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*’. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Berat nuk disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

b) *Politikat menaxheriale dhe stili i punës;*

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*’. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*”. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se “*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të*

diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave'. Grupit të auditimit i është paraqitur Urdhri nr.258, datë 26.04.2022 "Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekipeve të menaxhimit të programeve" urdhërohet ngritja e grupit të menaxhimit strategjik për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025. Por grupit të auditimit nuk i është paraqitur urdhri i titullarit në të cilin përcaktohet ngritja e grupit të menaxhimit strategjik, si organ i rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar të njësisë publike dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit për MFK. Nga kjo rezulton se për vitin 2022 titullari i Bashkisë Berat nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 'Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike', lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se 'GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit.Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'. Për sa më sipër, për vitin 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

GMS, nuk ka asnjë dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe menjanimin e riskut.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se "Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së finances" Me Urdhrin nr. 655, datë 29.09.2020, Titullari ka caktuar kordinatorin e riskut për Bashkinë Berat, znj. R. Sh., me detyrë Drejtores të menaxhimit financiar dhe të ardhurave (nëpunës zbatues). Për sa më sipër, nëpunësi autorizues i Bashkisë Berat është caktuar z. E. D. nëpërmjet shkresës nr.4038, date 02.08.2019. Në këtë rast, përgjegjësinë e kordinatorit të MFK dhe të riskut, e ka nëpunësi autorizues dhe është ai që duhet të delegojë disa prej detyrave. Për më tepër, nuk mund të delegohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë, por sikurse përcakton ligji, disa prej tyre. Në urdhrin e caktimit të kordinatorit të riskut, nuk përcaktohen se cilat nga detyrat janë deleguar.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Bashkia Berat e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me shkresën nr. 737, datë 07.02. 2018 "Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Berat dhe institucioneve në varësi". Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.

Bashkia Berat disponon disa përshkrime pune, por këto nuk kanë datë se kur janë bërë, gjithashtu edhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" në të cilin përcaktohet se "Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i

pozicionit/pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës”.

Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

Titullari i Bashkisë Berat, nëpërmjet shkresës nr.14727/1 prot, date 13.08.2019, ka njoftuar Drejtorinë e Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar mbi miratimin e z. E. D., si Nëpunës Autorizues i Bashkisë Berat.

Kompetencat e nëpunësit zbatues aktualisht kryhen nga znj. R. Sh., Drejtore e menaxhimit Financiar dhe të ardhurave në Bashki, ku nëpërmjet shkresës nr.4501, date 28.09.2020, është autorizuar për të drejtë firme të dytë për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për institucionin, nga Kryetari i Bashkisë z. E. D.. Në këtë shkresë nuk përcaktohet se znj. R. Sh., miratohet si nëpunës zbatues, si dhe nuk është njoftuar Drejtoria e Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar. Gjithashtu, nëpunësi zbatues ka një sërë detyrash dhe përgjegjësish dhe jo vetëm firmën e dytë për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për institucionin.

ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma eshkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Berat nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojne të dhënat për trajnime jashtë institucionit).

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. NA për çdo vit nuk ka nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcaktonse “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.’ Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar’ ku përcaktohet se ‘Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë’.

Bashkia Berat nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Berat nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Berat ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut për vitin 2022, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por jo për të gjitha Drejtoritë janë evidentuar rrisqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrimë”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të

monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskt për veprimtarinë e bashkisë, në arrijten e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Berat, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*’. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

4. Informacioni dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Berat ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’ ku në nenin 4 përcaktohet se “*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*”. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se “*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër*”.

5. Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë’. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Berat mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Berat megjithëse ka plotësuar pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, nuk janë trajtuar të gjithë elementët dhe mangësitë.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual’. Për sa më sipër, për vitin 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Berat ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, date 28.02.2023, por deklarata e vetëvlerësimit është plotësuar duke mos iu referuar situatës aktuale të funksionimit të sistemeve të MFK.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi zj.R. Sh. me detyrë Drejtore e menaxhimit Financiar dhe të ardhurave dhe z. E. D. kryetar i Bashkisë.

Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezulton se strukturat drejtuese të Bashkisë Berat nuk e zbatojnë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim tij.

Titulli i gjetjes	Mos zbatimi i kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata	Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se: -Bashkia Berat nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së

brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullin III, pika 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

-Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

-Për vitin 2022 titullari i Bashkisë Berat nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.

-Për 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”.

-Bashkia Berat e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me shkresën nr. 737, datë 07.02. 2018 “*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Berat dhe institucioneve në varësi*”. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

- Bashkia Berat për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

- Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të riskut për vitin 2022, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut, nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

- Titullari i Bashkisë për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

-Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Berat, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Berat ka një faqe zyrtare

	<p>web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim nenin 8 të këtij ligji.</p> <p>-Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Berat mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.</p>
Kriteri	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27. - Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1. - Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’. - Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. - Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. - Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014 ‘Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura’, neni 24; neni 35. - Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 62. - Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 4; neni 8.
Ndikimi/Efekti	<p>Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve financiare publike, si edhe ndikim negativ në performancën e institucionit për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.</p>
Shkaku	<p>Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga titullari i institucionit, nëpunësi autorizues dhe personat e tjerë përgjegjës për MFK.</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>
Rekomandim	<ul style="list-style-type: none"> -Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre. -Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre. -Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

2.2. Mbi funksionimin e strukturës së sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2022

Për organizimin dhe funksionimin e sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Berat, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Berat;
- Planet Strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Disa prej dosjeve të auditimit (Qendra Kulturore Margarita Tutulani, Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Rinisë, Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Drejtoria e MZSH);
- Projektraportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

- Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditit të brendshëm:

Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik”, Bashkia Berat e ka të ngritur Njësinë e Auditit të Brendshëm.

Në vitin 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Bashkisë me vendim Nr.94, datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2022” dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 680, datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese të saj për vitin 2022” ku sektori auditit përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 auditues.

Drejtoria e Auditimit në Bashkinë Berat nuk është ngritur dhe organizuar sipas “Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Bashkisë Berat dhe Institucioneve të varësisë” në nivelin e Drejtorisë të Auditimit, në strukturën organizative të miratuar me VKB Berat nr. 680, datë 20.12.2021. Përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të NJAB paraqitet në strukturën organizative për shefin e sektorit dhe specialistët.

- Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm

Struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit paraqitet si më poshtë:

Nr	Auditues	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi	Trajnime
1	Xh. M.	P/Sektori	I Lartë	42	19	Nr.039, 2005	40 orë
2	O. H.	Audituese	I Lartë	14	6	Nr 1945, 2018	40 orë

Njësia e auditit të brendshëm sipas strukturës së miratuar përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në fakt kjo njësi nuk është e plotësuar sipas strukturës së miratuar, pasi për vitin 2022, përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, në kundërshtim me VKM nr.212, date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 2, ku përcaktohet se Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi 3 anëtarë, përfshirë drejtuesin e njësisë.

- Mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

-Planet Strategjike dhe Vjetore:

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar plani strategjik dhe plani për vitin 2022, me shkresën nr.5141, datë 15.10.2021, është miratuar plani vjetor i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2022.

Këto plane janë miratuar nga titullari i institucionit dhe dërguar brenda afateve të Manualit të Auditit të brendshëm, zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, por pa dhënë mendimin Komiteti i Auditimit, i cili nuk është ngritur.

-Komiteti i Auditit të Brendshëm:

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: *“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
- ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

-Konstatohet mungesa e dokumentimit dhe protokollimit të raportimeve periodike bordit (KAB) mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatet e aktivitetit të Auditit Brendshëm e cila përcaktohet në Standartet 2060 të auditimit.

-Kodi i Etikës

Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka hartuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Berat.

-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Numri i subjekteve që i nënshtrohen auditimit. Kapaciteti auditues i njesisë së auditimit të brendshëm të institucionit, në raport me detyrimet për auditim.

-Realizimi i Planeve Vjetore:

Për vitin 2022 janë parashikuar gjithsej 8 (tetë) auditime. Realizimi i auditimeve për vitin 2022 është në masën 100%, duke qënë se nga 8 auditime të planifikuara janë realizuar 8 auditime. Janë planifikuar dhe audituar 4 njësi me bilanc më vete dhe 4 njësi shpenzuese, drejtori dhe njësi administrative, si më poshtë:

Nr	Planifikuar dhe Audituar
1	Zbatimi rekomandimeve v 2021
2	Qendra Kulturore M.Tutulani
3	SHA F. K. T.
4	Drejtoria e MZSH
5	Ish Ndërmarrja Gjellbërimit
6	Inspektoriati Mbrojtjes Territorit
7	Prokurimi fondeve A. J.
8	Drejtoria Arsimit dhe Rinisë

Dëmi ekonomik i konstatuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm llogaritet në vlerën 345 mijë lekë, nga të cilat 152 mijë lekë në prokurime dhe investime, 97 mijë lekë në sistemin e pagave dhe shpërblimeve, 80 mijë lekë në sistemin e tatim taksave, dhe 16 mijë lekë në sistemin e kontabilitetit ku gjetjet më të mëdha janë konstatuar në sistemin e prokurimeve dhe investimeve. Janë rekomanduar dhe pranuar 52 rekomandime nga titullarët e subjekteve të audituara.

-Njësia e Auditit të Brendshëm megjithëse ka realizuar planin vjetor të auditimeve, konstatohet se nuk janë audituar drejtori që paraqesin risk në këtë Bashki si, Drejtoria e Integritimit Europian dhe Projekteve, Drejtoria e Tatim taksave dhe tarifave të bizneseve, Drejtoria e Planifikimit Urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve Drejtoria e shërbimit social dhe ndihmës ekonomike, Drejtoria e Turizmit dhe aktiviteteve, etj.

-Praktikat e përzgjedhura

- Qendra Kulturore Margarita Tutulani,
- Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Rinisë,
- Ndërmarrja e Gjellbërimit
- Drejtoria e MZSH

Nga auditimi i dosjeve konstatohet se mungon Memo e planifikimit të auditimit.

Llojet e auditimeve:

Për vitin 2022, në Planin Strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2022 është përcaktuar lloji i auditimit për subjektet e synuara për tu audituar. Janë planifikuar 8 auditime, nga të cilat auditim përputhshmërie 6 njësi, auditime tematike dhe të kombinuara 2 njësi. Plani mbi llojin e auditimit nga planifikimi në realizim nuk ka pësuar ndryshim.

- Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë përgjithësisht janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj. Raporti i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm është dërguar Drejtorisë së harmonizimit Aditit të Brendshëm me shkresën e Kryetarit të Bashkisë nr.760, datë 15.02.2023, brenda afatit kohor të përcaktuar.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me

urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

-Nuk janë audituar fushat me risk si edhe nuk është audituar ecuria dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH

-Mungon memo e planifikimit të auditimit në të gjitha dosjet e auditimit.

Në të gjitha dosjet e auditimit mungon Memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pra të kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe ;

- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe Formatin e përgjithshëm të riskut;

- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet përlllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet.Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.

- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.

- Eksperiencia dhe numri i audituesve;

- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;

- Kohëzgjatja(ose afatet kohore);

- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;

- Masat për sigurimin e cilësisë;

• Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Për pasojë nuk është bërë trajtimi si çështje më vehte vlerësimi dhe analizimi e komponentëve të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinionin i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi.

• Në të gjitha dosjet nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

• Në disa raste rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem.

• Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Memove rezulton se janë tejet të gjata dhe nuk janë një përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar, nuk paraqet konkluzionet dhe dhe rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituar, por vetëm gjetjet dhe rekomandimet e adresuara, si dhe i

mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

-Nuk janë audituar drejtoritë dhe sektorët me risk në bashki, si prokurime, investime, tatim taksa, etj.

-Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket numrit të punonjësve nuk është në përputhje me përcaktimet ligjore.

-Nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve, të teknologjisë së informacionit dhe prokurimeve, etj fusha me risk.

-Për vitin 2022, mbi 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Berat, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi z. Xh. M. me detyrë përgjegjës i sektorit të Auditit të Brendshëm dhe O. H. me detyrë audituese.

Titulli i Gjetjes	Struktura e Sektorit të Auditit e pa plotësuar
Situata	Njësia e auditit të brendshëm sipas strukturës së miratuar përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në fakt kjo njësi nuk është e plotësuar sipas strukturës së miratuar, pasi për vitin 2022, përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, duke vepruar në kundërshtim me legjislacioni ku përcaktohet se Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi 3 anëtarë, përfshirë drejtuesin e njësisë.
Kriteri	VKM nr.212, date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 2.
Ndikimi/Efekti	Emërim jo në përputhje me dispozitat ligjore i cili cënon veprimtarinë e kësaj strukture.
Shkaku	Veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Rëndësia	E mesme
Rekomandim	Titullari i institucionit dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditit të Brendshëm me specialistë sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim kryerjen e auditimeve pa cënuar veprimtarinë e kësaj strukture, marrjen e masave për kryerjen e auditimeve me risk, rritjen e numrit të auditimeve dhe evidentimin e problematikave, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në dobi të komunitetit, duke eliminuar në të ardhmen mangësitë e konstatuara.

Titulli i Gjetjes	Mungesë dokumentacioni, gjurmimi në dosjet e audituara si dhe cënim i cilësisë dhe selektim në planifikimin e auditimeve.
Situata	Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka hartuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Berat. Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk është hartuar “Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Njësia e Auditit të Brendshëm megjithëse ka realizuar planin vjetor të auditimeve, konstatohet se nuk janë audituar drejtoritë që paraqesin risk në

	<p>këtë Bashki si, Drejtoria e Integritimit European dhe Projekteve, Drejtoria e Tatim taksave dhe tarifave të bizneseve, Drejtoria e Planifikimit Urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve Drejtoria e shërbimit social dhe ndihmës ekonomike, Drejtoria e Turizmit dhe aktiviteteteve, etj.</p> <p>-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.</p> <p>-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.</p> <p>-Nuk janë audituar fushat me risk si edhe nuk është audituar ecuria dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH.</p> <p>-Mungon memo e planifikimit të auditimit në të gjitha dosjet e auditimit.</p> <p>Për vitin 2022, mbi 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Berat, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim.</p>
Kriteri	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
Ndikimi/Efekti	Kryerja e auditimeve pa risk dhe që nuk ndjekin procedurat auditues nuk sjellin përmirësim të punës së institucionit.
Shkaku	Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera dhe mosplanifikim i riskut të auditimeve.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim	<p>-Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e realizimit të tyre.</p> <p>-Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në drejtori që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.</p>

Me shkresën nr.1427/6, datë 30.06.2023, janë paraqitur observacionet nga z.Xh. M. me detyrë përgjegjës i sektorit të Auditit të Brendshëm, për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Observim nr 1, Ne faqen 2, ne fillim te reshtit ku behet fjalë – Bazuar ne Manualin e Auditimit të brendshëm, mungon planifikimi i nevojave të stafit për trajnim për vitin 2022 për 2 punonjes të NJAB.

Sqarojme se: Ne Planin Strategjik dhe Vjetor te Sektorit te Auditimit te brendshem të Bashkise Berat per Vitet 2022 -2024 dhe Vitin 2022 derguar Ministrise se Financave (Drejtore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm), Tirane derguar me shkresen nr 5141 prot, date 15.10.2021 midis formateve te tjera eshte derguar dhe formati Nr 4 “Planifikimi vjetor i nevojave per trajnim të N.J.A.B për Vitin 2022. Per trajnimet e vitit 2022 jane marre dhe certifikatat e trajnimit te cilat jane ne dosjet e personelit, tek Drejtoria e Burimeve Njerezore .

- Bashkangjitur, shkresa e dergimit te Planit Strategjik e miratuar nga Kryetari i Bashkise, dhe formati 4 ku përfshihet tematika per trajnim, pjesmaresit ne trajnim, periudha e trajnimit dhe kohezgjatja e trajnimit për 2 audituesit.

Observim nr 2, Ne lidhje “ N.J.A B nuk ka hartuar Karten e Auditimit të brendshëm në Sektorin Publik dhe Kodin e Etikes”

Sqarojme se: Miratimi i Kartes se Auditit te Brendshem Publik te Bashkisë Berat eshte berë me Urdher te Kryetarit të Bashkise Nr 321, date 10.06.2021, protokolluar me shkresen nr 3059, date 10.06.2021 si dhe Kodi i Etikes i Audituesve te Brendshem te Bashkise Berat eshte berë me Urdher te Kryetarit të Bashkise Nr. 165, date 26.02.2019, protokolluar me shkresen nr 1003, date 20.02.2019, si dhe Urdher te Kryetarit të Bashkise Nr. 322, date 10.06.2021 Per Miratimin e Rregullores se Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Veprimtarise se Sektorit te Auditit te Brendshem” te Bashkise Berat, ku perfshihet dhe kodi i etikes se audituesve i cili ka fuqi zbatuese dhe per vitin 2022.

-Bashkangjitur Urdheri per Miratimin e Kartes se Auditimit te Brendshem se bashku, me karten e auditimit te Brendshem si dhe Urdheri per Miratimin e Kodit te Etikes se Audituesve te Brendshem te Bashkise Berat dhe Urdheri “Per miratimin e Rregullores se Brendshme te Njesise se Auditimit”.

Observim nr. 3, Ne lidhje me konstatimin se nuk audituar fushat me risk të lartë sqarojmë se:Planifikimi ka qene mbi baze risku dhe se **jane audituar pothuajse cdo 1 deri 2 vite njesite që kanë risk më të lartë**, si Inspektoriati i Ndertimit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Bujqesise. Per vitin 2023, jane programuar per auditimne baze risku, Drejtoria e Integritimit Europian dhe Projekteve, Prokurimet Publike dhe Drejtoria e te Ardhurave, ndonese numri i audituesve per vitin 2022 ka qene vetem 2, nje pergj dhe nje auditues qe e keni konstatuar dhe ju.

Observim nr 4. Ne lidhje me “Dosjet koherente të auditimit të brendshëm te njesive publike nuk arkivohen ne arkivin e njësisë vendore”;

Sqarojme se: Per vitet e meparshme te gjitha dosjet jane arshivuar ne arkiven e Bashkise Berat sipas inventarizimit, krahas dosjeve te perherëshme qe mbahen ne sektorin e auditit te brendshem.

Per vitin 2022 dosjet e auditit jane bere gati per arshivim me numer fletash por nuk jane arshivuar pasi nuk ka kaluar afati 6 mujorit, ku ne baze te ligjit 9154, date 06.11.2003” Per Arkivat” dhe Udhezimit te Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave; II-D. Normat Tekniko Profesionale dhe Metodologjike te Shërbimit Arkivor në R.SH’, neni 25 percakton se .. *Brenda afatit 6 mujorit te pare te vitit pasardhes, sekretaria apo sekretari- arkivi mbyll dosjet e hapura sipas pasqyres emertuese te celjes së tyre duke verifikuar teresine e dokumentave dhe sakesine e afateve te ruajtjes”.*

Bashkalidhur neni 25 i Udhezimit te Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave.

Observim nr 5. Ne lidhje me: Në programet e auditimit nuk është përfshire si drejtim “ Vleresimi i komponenteve te menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshëm.

Sqarojme se: Ne programet e auditimit te perputhshmerise dhe financiar, janë trajtuar si pike e veçante analiza e 5 komponenteve te kontrollit te brendshem dhe jane analizuar kjo pike ne fund te projekt raporteve e raporteve te auditimit. **Jane analizuar risqet e fushave te vecanta ne baze te pyetsoreve dhe mjedisin e kontrollit e dokumentuar dhe ne fleten e inventarit kemi percaktuar riskun total te njesise se audituar.**

-Ne lidhje me moszbatimin e Urdherit nr 4, date 10.01.2020- te Ministrit te Financave sqarojme se;

Ështe vepruar sipas urdherit te mesiperme duke konstatuar gjetjen, situaten, kriteri, ndikimin, rendesinë, si dhe kemi dhene rekomandimin perkates për cdo gjetje.

Observim nr 6. Ne lidhje me: **Nuk eshte audituar ecuria dhe zbatimi I rekomandimeve te lena nga KLSH-ja** (trajtuar paragrafin e parafundit te faqes 21), si dhe **Nuk jane kryer auditime te zbatimit te rekomandimeve** (paragrafi 1, faqe 23)

Sqarojme se: Ne te gjitha programet e auditimit pika e pare ka qene zbatimi i rekomandimeve te lena nga KLSH-ja dhe auditimi i brendshem.

Si auditim tematik ka qene Zbatimi i Rekomandimeve te lena nga auditimi i brendshem ne vitin 2022, per te gjitha auditimet e nje viti me pare sipas Urdherit nr 100 te M.Financave “Për miratimin e manualit te auditit te brendshem” me ndryshime.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit: 1. Në lidhje me planifikimin e nevojave të stafit për trajnim për vitin 2022 për 2 punonjës të NJAB, ku duhen përcaktuar temat e interesuara dhe mundësitë e tyre për ndjekje, merret në konsideratë observacioni pas apraqitjes së dokumentacionit dhe nuk do të trajtohet ne Raportin e Auditimit.

2. Në lidhje “ NJA B nuk ka hartuar Karten e Auditimit të brendshëm në Sektorin Publik dhe Kodin e Etikës” sqarojmë se Miratimi i kartës dhe Rregullores është prej vitit 2019 dhe nuk pasqyron ndryshimet në strukturë. Ky observacion nuk merret ne konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin e Auditimit.

3. Ne lidhje me konstatimin se nuk janë audituar fushat me risk të lartë dhe se per vitin 2023, jane programuar per auditimne baze risku, ndonese numri i audituesve per vitin 2022 ka qene vetem 2, nje pergj dhe nje auditues sqarojmë se observacioni nuk merret në konsideratë dhe gjetja do të trajohet në raportin e Auditimit, pasi KLSH ka audituar vitin 2022 dhe jo vitin 2023 ku ju keni planifikuar të kryeni auditime me risk. Lloji i auditimit është pasqyruar edhe në tabelën më lart ku flet qartë për përzgjedhjen e auditimeve pa risk. Po kështu nuk përbën argument ligjor fakti i mosplotësimit të struktures së sektorit të auditimit.

4. Ne lidhje me “Dosjet koherente të auditimit të brendshëm te njesive publike nuk arkivohen ne arkivin e njesisë vendore”, sqarojmë se afati 6-mujor ka përfunduar dhe dosjet duhen arkivuar dhe legjislacioni përcakton brenda afatit 6-mujor. Ky observacion nuk merret në konsideratë pasi dosjet nuk ishin të inventarizuara.

5. Në lidhje me pretendimin se në programet e auditimit nuk është përfshire si drejtim Vleresimi i komponenteve te menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshëm.

Sqarojmë se nuk merret në konsideratë observacioni sepse nuk është trajtuar si pike në program dhe është një tjetër trajtim pyetësori dhe trajtimi i riskut total.

-Në lidhje me moszbatimin e Urdherit nr 4, date 10.01.2020 te Ministrit te Financave sqarojme se nga grupi i auditimit nuk është trajtuar se mungon gjetja, rekomandimi, kriteri, por është trajtuar se mungon memo e planifikimit, ky observacion nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin e Auditimit.

6. Në lidhje me pretendimin se pika e pare e çdo programi auditimi është zbatimi i rekomandimeve, sqarojmë se grupi i auditimit ka trajtuar se nuk është audituar ecuria e zbatimit të rekomandimeve, ky pretendim nuk qëndron.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
- PBA dhe buxheti vjetor;
- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat”;
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Dokumente të bankës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së për vitet 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes konkretisht, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj., duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se janë kryer konsultime me grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, Ujësjetës Kanalizime Berat Sh.a etj., gjë e cila vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me shkresën nr. 3497 prot., datë 02.07.2021, dhe Urdhrin nr. 383 prot., datë 02.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë z. E. D. është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) i përbërë nga 16 anëtarë si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024.

Titulli i gjetjes: Nga Bashkia Berat projektvendimi dhe relacioni për buxhetin e vitit 2022 është dërguar jashtë afateve pranë Këshillit Bashkiak.

Situata: Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është në vlerën 1,211,327 mijë lekë i miratuar me VKB nr. 94, datë 28.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA-ve 2022-2024”, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet që: “Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas prcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji”.

Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Financës znj. R. Sh. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. sipas shkresës me nr. 6785 prot., datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, neni 41, pika 1 dhe 3.

Ndikimi/Efekti: Dërgimi i projektvendimit dhe relacionit për miratimin e buxhetit jashtë afateve ligjore ndikon në vendimarrjen e gabuar, konkretisht ky dokumentacion është shqyrtuar brenda një periudhe 1 ditore.

Shkaku: Mos respektimi i afateve për miratimin e buxhetit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa që projektvendimi dhe realicioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Gjithashtu VKB nr. 94, datë 28.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”, është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 906/2 prot., datë 07.01.2022. Në këtë VKB janë miratuar “Të ardhura nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022” në vlerën 597,614 mijë lekë, “Të ardhura të pritshme nga rimbursimi për financim të përkohshëm të projekteve të huaja” në vlerën 30,203 mijë lekë, “Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme” në vlerën 308,280 mijë lekë dhe “Transferta e pakushtëzuar sektoriale/specifike (për funksionet e transferuara në vitin 2016)” në vlerën 275,230 mijë lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 1,211,327 mijë lekë po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 1,211,327 mijë lekë.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetin për vitin 2022 paraqitet sipas tabelave në vijim:

Llogaria	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Në mijë lekë
					Projekt Buxhet 2022
600	Paga	418,153	460,295	460,295	474,212
601	Sigurime Shoqërore	69,379	76,109	76,109	78,413
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	299,784	327,254	293,096	335,580
603	Subvencione	33,000	27,000	27,000	33,000
604	Transferta Korente të Brendshme	2,315	3,100	3,100	3,270
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0

606	Transferta për Buxhete Familjarë & Individë	10,771	0	7,159	28,700
I	Shpenzime Korrente	833,403	893,759	866,759	953,175
230	Kapitale të Patrupëzuara	18,958	5,000	5,000	12,773
231	Kapitale të Trupëzuara	136,947	170,457	170,457	245,377
	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	155,905	175,457	175,457	258,151
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	155,905	175,457	175,457	258,151
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	0	0	0	0
	I+II +III Totali i Shpenzimeve	989,309	1,069,216	1,042,216	1,211,327

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

PBA 2022-2024 (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet respektive konkretisht, VKB nr. 23, datë 29.03.2021, dhe VKB nr. 60, datë 29.03.2021, dhe VKB nr. 60, datë 03.08.2021.

Në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurat faktike	1,113,711	1,225,952
Të vitit korrent	992,892	1,091,753
Të trashëguara nga viti paraardhës	120,819	134,199
Shpenzimet faktike	989,309	1,015,388

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Përgjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2022 me VKB nr. 94, datë 28.12.2022). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:

-Me VKB nr. 17, datë 02.03.2022, “Për miratimin e shtesës së buxhetit të të ardhurave me fondet e pa përdorura dhe të trashëguara nga viti 2021”, ku janë planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në shumën 134,199 mijë lekë konkretisht:

a. Të ardhurat vendore (kryesit të ardhurat e muajit dhjetor të vitit 2021) në shumën 58,426 mijë lekë.

b. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme në shumën 8,270 mijë lekë.

c. Transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 64,033 mijë lekë.

d. Transferta specifike për mbrojtjen civile në shumën 3,500 mijë lekë.

Gjithashtu Bashkia Berat ka trashëguar nga viti 2021 të ardhura jashtë limit (sponsorizime) në shumën 10,644 mijë lekë lekë të cilat janë me destinacion të përcaktuar në kontratën e sponsorizimit.

-Me VKB nr. 50, datë 27.07.2022, “Për rialokim fondesh mes programeve buxhetore dhe kategorive të shpenzimeve”.

-Me VKB nr. 62, datë 30.09.2022, “Për rialokim fondesh mes programeve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale”.

-Me VKB nr. 76, datë 18.10.2022, “Për shtesë të buxhetit” në shumën 375 mijë lekë. Buxhetit të vitit 2022 i shtohet planit të të ardhurave të veta të vitit 2022 vlera 375 mijë lekë në artikullin 7113099 “Të ardhura nga shitje mallrash (skrap)”. Kjo shtesë shkon për shpenzimet operative të njësisë shpenzuese aparatit të Bashkisë Berat.

-Me VKB nr. 87, datë 30.11.2022, “Për shtesë të buxhetit” në shumën 2,351 mijë lekë. Ky fond rishpërndahet në fondin e buxhetit të vitit 2022, në njësinë shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat për llogarinë 600 “Pagat” dhe 601 “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” për të mbuluar efektin e rritjes së pagave sipas VKM nr. 465, datë 06.07.2022, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar”.

-Me VKB nr. 96, datë 22.12.2022, "Për shtesë të buxhetit" në shumën 26,237 mijë lekë. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, dërguar nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 22369/3 prot., datë 05.12.2022, Bashkisë Berat është akorduar shtesë fondi në transfertën e pakushtëzuar shuma 26,237 mijë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke i dhënë përparësi detyrimit më të vjetër.

-Lista e investimeve të reja të parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 sipas VKB përkatëse paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2022 paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Lista analitike e detyrimeve të prapambetura për investime më 31.12.2022 dhe planifikimi për likuidim në planin e këtij buxheti paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) (nga të ardhur e grant i pakushtëzuar e specifik)	551,292	552,625	(1,333)
2	Shpenzime (602; 604; 609) (nga ardhura e grant i pakushtëzuar e specifik)	525,807	400,551	125,256
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëz)	297,389	258,151	39,238
4	Investime nga FZSHH			-
Total i planit fillestar		1,374,489	1,211,327	163,161
Shtesat nga Pushteti Qendror		766,828	-	766,828
5	Investime grant i kushtëzuar	272,000	-	272,000
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)	10,436	-	10,436
7	Shpenzime (602; 604; 609)	484,392	-	484,392
	Grant i kushtëzuar (230-231)			
Gjithsej		2,141,316	1,211,327	929,989
Investime Bashkia (nga të ardhura nga sponsorizimet kap.06)		9,640		9,640

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Plani buxhetor vjetor 2022 është më i lartë se plani vjetor 2022 në PBA, në shumën 929,989 mijë lekë për arsye se:

-Në planin përfundimtar të vitit 2022 janë pasqyruar shpenzimet e financuara me fondet nga pushteti qendror, Investime nga grant i kushtëzuar, shpenzime për paga dhe operative, në shumën 766,828 mijë lekë. Në fazat e përgatitjes së PBA fondet e kushtëzuara nuk janë të njohura/akorduar dhe nuk janë të llogaritura/të përfshira në planin buxhetor.

-Në planin përfundimtar të vitit 2022 janë pasqyruar shtesat e ndryshimet e bëra në buxhet gjatë vitit 2022, me burim financimi fondet e veta, në total shtesë 163,161 mijë lekë. (Sipas VKB-ve të përmenduar në paragrafet e mëparshëm).

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Berat dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

-Tabela mbi ndryshimin e buxhetit paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Berat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë Berat me Njësitë Vartëse:

Emërtimi i shpenzimeve	Artikulli	Plani	Fakti
Paga	600	471,854,059	431,844,448
Sigurime shoqërore	601	79,438,380	73,153,714
Shpenzime operative	602	442,886,780	334,910,309
Subvencione	603	33,000,000	33,000,000
Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë	604	4,134,000	2,560,697
Transferta në buxhete familjare	606	40,845,147	18,399,962

Lekë

Fondi rezerve	609	5,000,000	
Investime	230+231	309,821,648	134,010,711
Shuma nga plani i bashkisë (kap.01+05+06)		1,386,980,014	1,027,879,841
Paga	600	8,939,000	8,827,122
Sigurime shoqërore	601	1,497,000	1,472,411
Shpenzime operative	602	7,714,050	5,570,940
Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë	604	6,608,690	6,607,930
Transferta në buxhete familjare	606	470,069,560	465,637,972
Investime	230+231	271,999,603	253,653,682
Shuma nga plani i buxhetit qendror (kap.01)		766,827,903	741,770,057
Shuma totale Bashkia		2,153,807,917	1,769,649,898

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë Berat me Njësitë Vartëse:

Në mijë lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Berat, për vitin 2022													
Burimi i financimit të shpenzimit													
Nr.	Llog	Plani	Fakti	Realizimi %	Nga të ardhurat e veta (kp.05)		% e realizimit të buxhetit nga të ardhurat e veta	Nga Sponzorizimet (kap.06)	Nga Granti Qeveritar (kap.01)				
					Plan	Fakt			Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet	
1	600	480,793	440,671	92%	105,592	70,640	67%	0	164	196,647	8,827	0	0
2	601	80,935	74,626	92%	19,786	14,408	73%	0	26	32,400	1,472	0	0
3	602	450,600	340,481	76%	307,416	233,598	76%	59	62	39,085	5,570	0	0
4	603	33,000	33,000	100%	23,000	23,000	100%	0	10	0	0	0	0
5	604	10,742	9,168	85%	4,134	2,560	62%	0	0	0	6,607	0	0
6	606	510,914	484,037	95%	31,558	12,617	40%	0	3	2,468	465,637	0	0
7	609	5,000	0	0%	5,000	0	0%	0	0	0	0	0	0
8	230-23	581,821	387,664	67%	190,131	45,373	24%	12,432	70	5,424	0	253,653	0
Totali		2,153,807	1,769,649	82%	686,618	402,198	59%	12,491	337	276,026	488,116	253,653	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

-Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë Berat pa Njësitë e Vartëse dhe realizimi në % paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta.

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar konkretisht, totali i buxhetit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 2,153,808 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,769,650 mijë lekë ose në masën 82% me një mosrealizim në vlerën 384,158 mijë lekë.

-Për Artikullin 600 "Paga" është planifikuar në vlerën 480,793 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 440,671 mijë lekë ose në masën 92%. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë e vendeve vakant në strukturë si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë. Konkretisht numri i punonjësve në strukturën e Bashkisë Berat për vitin 2022 është 776 punonjës dhe numri faktik mesatar është 733 pra ka 43 vende vakante ku struktura është realizuar në masën 94%.

-Për Artikullin 601 "Sigurime shoqërore" është planifikuar në vlerën 80,935 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 74,626 mijë lekë ose në masën 92%.

-Për Artikullin 602 "Mallra dhe shërbime të tjera" është planifikuar në vlerën 450,600 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 340,481 mijë lekë ose në masën 76%.

-Për Artikullin 603 “Subvencione” është planifikuar në vlerën 33,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 33,000 mijë lekë ose në masën 100%.

Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për F.. “T.” Sh.a, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë. Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga F..“T.” Sh.a për financimin e shpenzimeve të domosdoshme.

-Për Artikullin 604 “Transferta korrente të brendshme” është planifikuar në vlerën 10,742 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 9,168 mijë lekë ose në masën 85%. Këto shpenzime përfaqësojnë detyrimet kontraktuale apo ligjore ndaj agjentëve për arkëtimin e taksave dhe tarifave si psh Ujësjetësi për tarifën e arketuara nga familjet, Drejtoria Rajonale e Tatimeve për Tatimin e thjeshtuar dhe Tatimit mbi të ardhurat personale.

-Për Artikullin 606 “Transferta për buxhetet, familjet dhe individët” është planifikuar në vlerën 510,914 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 484,037 mijë lekë ose në masën 95%. Transfertat për përfituesit e ndihmës ekonomike, paafëtisë, bursat për nxënësit e arsimit parashkollor dhe të mesëm, ndihmat për rastet e fatkeqësive.

-Për Artikullin 609 “Fondi rezervë dhe i kontigjencës” është planifikuar në vlerën 581,821 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 387,664 mijë lekë ose në masën 67%.

Kriteri: Ligji nr. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, bënë që pritshmëritë sidomos në investime të mos përputhen me planifikimin, plotësimin e nevojave reale të planifikuara dhe ulje të performancës të njësisë vendore.

Shkaku: Planifikim i pa studiuar mire i buxhetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë: Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i emergjencës paraqitet në shumën 81,655,880 lekë.

Fondi Rezervë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë. Në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar fond rezervë në shumën 2,500 mijë lekë. Fondi Rezervë nuk është përdorur në periudhën janar-dhjetor 2022.

Fondi i Kontingjencës: Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara . Fondi i Kontingjencës i programuar në shumën 2,500 mijë lekë nuk është përdorur.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në buxhetin e bashkisë janë parashikuar nga të ardhurat e veta fonde për emergjencën në shumën 2,500 mijë lekë. Si dhe janë parashikuar fonde për mbrojtjen civile nga të ardhurat e bashkisë në shumën 14,500 mijë lekë, të cilat u shtuan edhe me të ardhurën e trashëguar nga viti 2021 në shumën 3,500 mijë lekë.

Në periudhën janar-dhjetor 2022 është përdorur fondi i emergjencës civile (prog. 01110, art.606) në shumën 80,653 lekë për mbështetje financiare për dëmtimin e banesës nga tërmeti i datës 26.11.2019, një përfitues, sipas VKB nr. 3, datë 31.01.2022.

Në periudhën janar-dhjetor 2022 është përdorur fondi i mbrojtjes civile (prog.03280, art. 606) në shumën 38,998 lekë për mbështetje financiare për dëmtimin e banesës nga zjarri i datë 03.06.2022, një përfitues, sipas VKB nr. 58 datë 30.09.2022.

Në muajin prill 2022, nga buxheti qendror janë akorduar fonde të kushtëzuara si transfertë specifike në shumën 17,093,685 lekë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit nr 45/2019. Ky fond është përdorur në përputhje me VKM nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”. Fondi i përdorur në total 6,607,930 lekë si më poshtë:

-Shuma 1,000,000 lekë për dhënie ndihmë financiare familjes së 2 personave që humbën jetën dhe banesa e të cilëve u dogj nga zjarri në dt.08.03.2021. Përdorimi i këtij fondi është miratuar me VKB nr. 46, datë 27.07.2022.

-Shuma 1,664,730 lekë për dhënie ndihmë financiare familjes së 2 personave që humbën jetën dhe banesa e të cilëve u dogj nga zjarri në dt.10.08.2022. Përdorimi i këtij fondi është miratuar me VKB nr. 64, datë 18.10.2022.

-shuma 3,943,200 leke për blerje materiale te ndryshme speciale speciale dhe veshje pune për grupin e ngarkuar për ndërhyrjet në rastet e emergjencave. Përdorimi i këtij fondi është miratuar me VKB nr. 70, datë 18.10.2022.

Subvencione të planifikuara për vitin 2022 janë 33,000 mijë lekë, zënë 2 % të plan buxhetit vjetor, dhe janë realizuar në masën 100 %.

Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për sh.a.“F.. T.”, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë. Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga sha F.. T. për financimin e shpenzimeve të domosdoshme, (paga, sigurime, energji, ujë,).

Lekë

Sponsorizime7207011	Trashëguar nga viti 2021	Derdhur ne vitin 2022	Shuma totale	Përdorur në vitin 2022	Mbeten për t'u trashëguar në vitin 2023
A. B., sponsorizim për rikonstruksionin e Shatervanit	205,000		205,000		205,000
E.	59,823		59,823	59,320	503
Sponsorizim F. Projekti "Siguria publike në nivel vendor"	562,000		562,000		562,000
A. J. "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi"	9,817,500		9,817,500	9,640,000	177,500
R. B., "Ndërtim i këndit të lojërave për fëmijë dhe krijimi i hapësirave rekreative"		2,792,160	2,792,160	2,792,160	
S. t. Ch., "Kënd sportiv dhe rekreativ në shkollën Velabisht, Berat"		583,330	583,330		583,330
A. Gj., "Ndërtimi i këndit të lojërave në parkun Dëshmorët e Kombit"		581,064	581,064		581,064
Shuma Sponsorizime	10,644,323	3,956,554	14,600,877	12,491,480	2,109,397

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Kredi të marra: Nga Bashkia Berat është marrë kredi Financuar nga C. P.. Marrëveshja e Nën-huasë është lidhur më datë 13.02.2008, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Berat për Projektin “Ndërtimi i banesave me qëllim social” dhe likuidimi ka filluar në datën 19 Dhjetor 2014. Afati i shlyerjes së kredisë: 12/2014-07/2026. Shuma totale e kredisë është 587,707 euro. Janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara të gjitha këstet deri më 31.12.2022 në shumën totale 473,194.90 euro dhe stoku i mbetur më 31.12.2022, është 114,512.10 euro.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.,).

Vlera e raportuar nga Bashkia Berat në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022, është 209,536,764 lekë (36,018,325 lekë nga të ardhurat e veta + 173,518,439 lekë financuar nga Buxheti i Shtetit, Ministria e Infrastrukturës), ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë pa njësitë vartëse është 206,843,030 lekë (33,324,591 lekë nga të ardhurat e veta + 173,518,439 lekë financuar nga Buxheti i Shtetit, Ministria e Infrastrukturës). Duke përfshirë edhe detyrimet e njësisve vartëse, vlera totale e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Berat është 209,536,764 lekë, nga e cila vlera prej 2,693,734 lekë i përket njësisve vartëse, ndërsa vlera prej 206,843,030 lekë, bashkisë pa njësitë vartëse.

Detyrimet e prapambetura viti 2022:

Titulli i gjejtes: Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura, viti 2022.

Situata: Bashkia Berat në datën 01.01.2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 95,527,220 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 77,527,220 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 60,876,887 lekë, ose 78 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 16,650,333 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 1,367,992 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 36,018,325 lekë.

Përsa trajtuar më sipër më datë 01.01.2022, Bashkia Berat ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, të cilat janë detyrime për investime nga Ministria e Infrastrukturës në vlerën 75,056,351 lekë, është krijuar gjatë vitit 2022 detyrim me vlerë 138,662,088 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në vlerën 173,518,439 lekë.

Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2022, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur me 59,508,895 lekë, ose në masën prej 41.5%.

Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 32,415,751 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 1,067,850 lekë detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 576,800 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 1,706,384 lekë, detyrime të tjera në vlerën 251,540 lekë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti: Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura sipas raporteve të monitorimit

-Detyrimet e prapambetura të periudhës janar-prill 2022 janë raportuar në MFE me shkresën nr. 2858 prot., datë 02.06.2022.

-Detyrimet e prapambetura të periudhës maj - gusht 2022 janë raportuar në MFE me shkresën nr. 3313/1 prot., datë 30.09.2022.

-Detyrimet e prapambetura të periudhës vjetore 2022 janë raportuar në MFE me shkresën pa numër protokolli datë 01.03.2023. Korespondenca është dërguar nëpërmjet emaileve brenda afatit. Në këshillin bashkiak detyrimet e prapambetura janë raportuar në raporet 4-mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, përkatësisht në periudhën maj 2022, shtator 2022, shkurt 2023.

-Analiza e detyrimeve të prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Lista analitike për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022, për Bashkinë pa njësitë e varësisë paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Lista analitike për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022, për Bashkinë së bashku me njësitë e varësisë paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet nga të ardhurat e veta paraqiten në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet nga granti paraqiten në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Lista analitike e detyrimeve për vendimet gjyqësore:

Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page punonjësit e larguar nga puna dhe lista analitike për vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna paraqiten në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Efekte negative ne buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 është shpenzuar vlerën 13,199,926 lekë, nga e cila vlera 8,199,565 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 6 raste, ndërsa vlera 5,000,361 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi (dënim me gjobë IMT, dëmshpërblim dëmi). Për sa trajtuar më sipër **vlera 13,199,926 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Berat**. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Gjithashtu Bashkia Berat ka zbatuar vendimin gjyqësor nr. 283, datë 22.04.2022, për shlyerjen e detyrimeve ndaj përfituesve të P., si detyrime të prapambetura si rezultat e moszbatimit të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, dhe dëmin e shkaktuar nga moslikujdimi në kohë, **në vlerën 6,377,140 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financia për Buxhetin e Shtetit**. Fondet janë akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kriteri: Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet.

Shkaku: Mos zbatimi i kriterëve ligjore në procesin e largimeve nga puna të punonjësve, si dhe shkelje e kuadrin rregullator në fuqi, gjë e cila sjellë hapjen e proceseve gjyqësore.

Rëndësia: Elartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Lista analitike e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likujdimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për të gjitha çështjet paraqiten në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për Bashkinë Berat, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 1,374,488,534 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta më 31.12.2022 (pa përfshirë detyrimet e FZHR), ka vlerën 36,018,325 lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 2.62 %.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit objektet e investimeve si më poshtë:

1. “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë Njësia Administrative Velabisht”. Kontrata e lidhur me nr. 2134, datë 29.06.2020, me subjektin E. A. shpk në vlerën 154,992 mijë lekë. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë 40,000 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet

e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 121,414 mijë lekë Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 33,577 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar në vitin 2023.

2. “Supervizim "Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë Njësia Administrative Velabisht" Kontrata e lidhur me nr 3077/3, datë 06.07.2020, me subjektin G. C. E. shpk në vlerën 2,461 mijë lekë. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë 200 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 1,441 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 1,020 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar në vitin 2023.

2. “Ujësjetlesi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otllak, Orizaj”. Kontrata e lidhur me nr. 519/1, datë 14.06.2021 me subjektin R. Shpk në vlerën 438,068 mijë lekë, me financim të shtrirë deri në vitin 2024. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë 80,000 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 299,349 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 138,720 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar pjesërisht në vitin 2023, si edhe planifikuar për në vitin 2024.

3. “Supervizim, Ujësjetlesi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otllak, Orizaj”. Kontrata e lidhur me nr. 189/10, datë 24.02.2021, me subjektin 4... & I. në vlerën 4,828 mijë lekë, me financim të shtrirë deri në vitin 2024. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë 813 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 1,786 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 3,041 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar pjesërisht në vitin 2023, si edhe planifikuar për në vitin 2024.

4. “Studim Projektim KUZ Lagjja Uznovë Rajoni III dhe Fshati Duhanas”. Kontrata e lidhur me nr. 241/12, datë 09.02.2021, me subjektin K. P. shpk në vlerën 18,708 mijë lekë, me financim të shtrirë deri në vitin 2023. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë 5,000 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 9,000 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 9,708 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar në vitin 2023.

5. “Përmirësimi i banesave komunitete të varfëra e të pafavorizuara (kontrata 2021-2022)”. Kontrata e lidhur me nr. 4785/3, datë 28.09.2021, me subjektin Z. shpk në vlerën 32,131 mijë lekë, me financim të shtrirë në periudhën 2021-2022. Ky investim financohet nga buxheti i shtetit për vlerën 25,705 mijë lekë dhe nga buxheti i bashkisë me fondet e veta në vlerën 6,426 mijë lekë. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë 15,143 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është vlera e plotë prej 25,705 mijë lekë .

6. “Përmirësimi i banesave komunitete të varfëra e të pafavorizuara (kontrata 2022-2023)”. Kontrata e lidhur me nr. 4844, datë 27.09.2022 me subjektin Z. shpk në vlerën 45,806 mijë lekë, me financim të shtrirë në periudhën 2022-2023. Ky investim financohet nga buxheti i shtetit për vlerën 32,066 mijë lekë dhe nga buxheti i bashkisë me fondet e veta në vlerën 13,743 mijë lekë. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë 19,775 mijë lekë dhe po kaq është vlera e likujduar. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 19,775 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende

për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 12,291 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar në vitin 2023.

7. "Ndërtim shkolla "Babë Dudë Karbunara, Berat". Kontrata e lidhur me nr. 5013, datë 06.10.2022 me subjektin B. shpk ka vlerën 433,517 mijë lekë, me financim të shtrirë në periudhën 2022-2023. Ky investim financohet nga buxheti i shtetit për vlerën 346,814 mijë lekë dhe nga buxheti i bashkisë me fondet e veta në vlerën 86,703 mijë lekë. Në vitin 2022 fondet e çelura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë 110,685 mijë lekë dhe janë realizuar/likujduar 92,339 mijë lekë, sipas vlerës së punimeve të kryera të paraqitura me situacion pjesor punimesh. Vlera progresive e likujduar nga fondet e buxhetit të shtetit deri në datën 31.12.2022 për këtë objekt është 92,339 mijë lekë . Vlera e palikujduar ende për arsye të shtrirjes në kohë të kontratës është 346,813 mijë lekë, fonde të cilat janë akorduar në vitin 2023.

8. "Fondi për zhvillimin e turizmit, projekti "Festivali i verërave". Shuma e akorduar nga Ministria e Turizmit për këtë projekt është 384 mijë lekë, dhe po kaq është vlera e likujduar . Në lidhje me Investime të kryera nga FZSHS, për të cilën Bashkia Berat është pjesëmarrës si në financim me buxhet dhe zbatimin e procedurave rezulton se nuk ka patur asnjë financim të tillë sipas të dhënave të vëna në dispozicion.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë.
2. Znj. R. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësisë të Varësisë është miratuar me VKB nr. 87, datë 18.12.2022, ndryshuar me VKB nr. 69, datë 18.10.2022, ndërsa struktura organizative është miratuar me Vendimin nr. 680, datë 20.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë ndryshuar me vendimet respektive nr. 268, datë 28.04.2022, nr. 310, datë 20.05.2022, nr. 502, datë 09.09.2022, nr. 574, datë 04.10.2022, dhe nr. 660, datë 07.11.2022, ku pjesë e saj përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave.

Kjo drejtori sipas strukturës së miratuar ka në përbërje të saj 20 punonjës konkretisht: 1 drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, 1 përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave të Biznesit ku pjesë e këtij sektori janë 3 specialist të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit, 2 specialist për inspektimin, kontrollin tatimor në terren, 2 specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit, 1 specialist për vlerësimin e taksave dhe tarifave për ambulantët, institucionet dhe parkimet si dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare ku pjesë e këtij sektori janë 2 specialist për taksat dhe tarifatat në lagje, 4 specialist për taksat dhe tarifatat në Njësitë Administrative Otlak, Velabisht, Sinjë, Roshnik, 1 punonjës për grumbullimin e të ardhurave nga tregu industrial dhe 3 punonjës për grumbullimin e të ardhurave për parkimet dhe tregjet.

Titulli i gjetjes: Magësitë e konstatuara në plotsimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Situata: Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimin i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DTT Bashkia Berat, pasi evidentohet një numër i lartë detyrimesh të paarkëtuara (debitor), për biznesin e madh dhe atë të vogël, institucione shtetërore në vlerën 97,326,756 lekë si dhe abonentë familjarë në vlerën 145,381,248 lekë. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara.

Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat, janë evidentuar mangësi në plotësimin e saj me specialist respektivisht: Përgjegjës Sektori i Taksave dhe Tarifave të Biznesit, Specialist i Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave të Biznesit, Specialist për Taksat dhe Tarifave në Njësinë Administrive Sinjë dhe Punonjës për parkimi dhe tregjet çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimit fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “ç”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” i ndryshuar, nenet 88-104, dhe Rregullorja e Brendshme e miratuar me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës me natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Berat.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë për, menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtuese të Bashkia Berat.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për plotësimin e stafit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave me specialist të fushës dhe përshtatjen e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ku t’i referohet kërkesave reale të institucionit.

Me VKB nr. 93, datë 28.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit” i ndryshuar me VKB nr. 41, datë 06.07.2022, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Berat për vitin 2022. Referuar planit vjetor të miratuar, aktrakordimeve me Degën e Thesarit Berat si dhe të dhënave të nxjerra nga sistemi TAIS (Tax Administration Information System), parashikimi dhe realizimi i të ardhurave të Bashkisë Berat për vitin 2022 paraqitet në mënyrë analitike e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Për vitin 2022 planifikimin i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 628,192 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 454,534 mijë lekë ose në masën 72.3%, pra ka një mosrealizim të të ardhurave në vlerën 173,658 mijë lekë.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat si më poshtë:

1. “Taksë fjetje në hotel” është planifikuar në vlerën 2,981 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,500 mijë lekë ose realizuar në masën 184%.

2. “Të ardhurat nga qiratë” është planifikuar në vlerën 14,013 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 31,374 mijë lekë ose realizuar në masën 223.8%.
3. “Të ardhurat nga konviktet” është planifikuar në vlerën 2,867 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,214 mijë lekë ose realizuar në masën 112.1%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

1. “Të ardhura nga zënia e hapsirave publike” është planifikuar në vlerën 16,893 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,706 mijë lekë ose realizuar në masën 63%.
2. “Taksë mbi tokën bujqësore” është planifikuar në vlerën 18,564 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,985 mijë lekë ose realizuar në masën 75.3%.
3. “Tarifë e pastrimit” është planifikuar në vlerën 104,370 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 85,714 mijë lekë ose realizuar në masën 82.1%.
4. “Tarifë e ndriçimit publik” është planifikuar në vlerën 47,461 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 38,009 mijë lekë ose realizuar në masën 80%.
5. “Tarifë gjelbërimi publik” është planifikuar në vlerën 40,148 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 31,376 mijë lekë ose realizuar në masën 78.1%.
6. “Tarifë për licensë/certifikatë për transport rrugor” është planifikuar në vlerën 9,523 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,084 mijë lekë ose realizuar në masën 21.8%.
7. “Tarifë urbanistike” është planifikuar në vlerën 89,118 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 76,161 mijë lekë ose realizuar në masën 54.4%.
8. “Të tjera të ardhura nga pronësia” është planifikuar në vlerën 26,256 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,086 mijë lekë ose realizuar në masën 7.9%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2022 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Berat që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkakuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200,

Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifave vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Për të ardhurat të cilat vijnë nga detyrimet prapambetura nga taksave dhe tarifave të cilat janë të paplanifikuara, shpërndahen sipas zërave por nuk ka një ndarje të ardhurave nga detyrimet e prapambetura dhe ato aktuale duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre duke ndikuar në nivelin e realizimit të plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Berat.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakorimet me ta:**

Titulli i gjetjes: Mangësi të konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

Situata: Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Berat në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Berat në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Berat dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Berat. Gjithashtu Bashkia Berat duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës Kanalizime Sh.a Berat. Është e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me agjentin tatimor por ka një shumë të madhe debitorësh e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Konstatohet se sipas Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat mos arkëtimet nga ana e Drejtorisë Rajonale Vendore (ASHK Berat) janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës për të cilat nga Bashkia Berat është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentacionin mbi kryerjen e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër Bashkia Berat duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

000/Lekë			
Nr.	Emërtimi	Plani 2022	Realizimi 2022
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit(Agjenti DRT Berat)	4,000	960
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Berat)	6,000	19,478
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	3,000	3,567
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	29,300	33,674
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	40	12
6	Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Berat	85,580	80,216
Totali		127,920	137,907

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

(Shënim: Në planifikimin total të ardhurat e mbledhura nga Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Berat janë të evidentura/shpërndara sipas zërave të tarifave).

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e situatë çon në mungesë të ardhurash për Bashkisë Berat.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Berat dhe Agjentëve Tatimorë si dhe mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me insitucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Titulli i gjetjes: Nga Bashkia Berat nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet.

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore). Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori,

detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë dhe subjektet fizik/juridik paraqiten si më poshtë:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Ndërmjet Bashkisë Berat dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat është lidhur kontrata që prej vitit 2013 (parashikuar edhe në paketën fiskale të vitit 2022) për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

-Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.

Paketa fiskale e Bashkisë Berat publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.,.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimit të tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat detyrimet e abonentëve familjarë për taksat dhe tarifat vendore, si më poshtë:

Lekë

PËRMBLEDHJA					
Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2021	Viti 2022	Totali progresiv	Numri i familjeve debitore
1	Taksa e truallit	2,270,887	770,023	3,040,910	6,838
2	Taksa e ndërtesës	19,341,691	4,583,788	23,925,480	6,448
3	Taksa e tokës bujqësore	53,571,874	13,104,211	66,676,085	8,252
4	Tarifa e pastrimit	22,445,620	6,687,363	29,132,983	6,394
5	Tarifa e ndricimit	6,895,050	2,272,800	9,167,850	3,102
6	Tarifa e gjelberimit	3,172,285	1,517,610	4,689,895	6,387
7	Tarifa arsimit	1,912,705	1,309,100	3,221,805	5,408
8	Tarifa vaditje + kullim	3,845,000	1,681,240	5,526,240	3,151
Totali		113,455,113	31,926,135	145,381,248	

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentën familjarë në vlerën **145,381,248 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat** si më poshtë:

1. Vlera **3,040,910 lekë** për **6,838 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së truallit**;
2. Vlera **23,925,480 lekë** për **6,448 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së ndërtesës**;
3. Vlera **66,676,085 lekë** për **8,077 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së tokës bujqësore**.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Kadastrës (sot ASHK) si rezulton fondi i tokës, struktura dhe ndaja sipas kategorive paraqitet si më poshtë:

Lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Tokë bujqësore gjithsej Ha në 1/8/1991	Numri familjeve që kanë marrë AMTP	Sipërfaqja e tokës ndarë në fakt ligji nr. 7501	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr. 7501/në hektar							Totali i kategorive	Sipërfaqe e tokës së pandarë
					I	II	III	IV	V	VI	VII		
1	Uznovë	630	1,260	630							630	630	
2	Ullishte	404	389	404							404	404	
3	Otlak	3,106	2,395	2,686			469	146	777	489	805	2,686	420
4	Velabisht	4,890	2,664	3,680				400	485	1,180	1,615	3,680	1,210
5	Sinjë	3,468	1,552	2,492				168	1,065	983	276	2,492	976
6	Roshnik	2,325	1,221	1,642						1,050	592	1,642	319
Shuma		14,823	9,481	11,534			469	714	2,327	3,702	4,322	11,534	2,925
Çmimi sipas VKB							2,800	2,300	1,900	1,600	1,400		

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër konstatohet se me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.199, "Për tokën", janë trajtuar 9,481 familje dhe 11,534 ha. Të dhënat mbi detyrimet e taksës së tokës bujqësore paraqiten si më poshtë:

Lekë

Detyrimet e Taksës së tokës bujqësore		
Periudha	Numri i familjeve	Vlera e detyrimeve
Deri më datën 31.12.2021		8,252
Për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022		8,077
Totali/Progresiv		8,077
		66,676,085

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

- Vlera **29,132,983 lekë** për **6,394 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së pastrimit**;
- Vlera **9,167,850 lekë** për **3,102 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së ndriçimit**;
- Vlera **4,689,895 lekë** për **6,387 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së gjelbërimit**;
- Vlera **3,221,805 lekë** për **5,408 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së arsimit**;
- Vlera **5,526,240 lekë** për **3,151 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat nga mos arkëtimi i **taksës së vaditjes dhe kullimit**;

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore bëhet me programin TAIS ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuar për çdo zë tatimor që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Berat aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitor. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe. **Vlera e përlogaritur e kamatëvonesave është 23,138,643 lekë** deri më datën 31.12.2022, nga Bashkia Berat paraqitet si më poshtë:

Lekë

Viti	Biznesi i madh	Biznesi i vogë	Të tjera	Totali
Kamatëvonesa të përlogaritura deri më datë 31.12.2021	11,295,626	6,795,156	1,935,988	20,026,770
Kamatëvonesa të përlogaritura për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022	2,076,170	943,452	92,251	3,111,873
Totali	13,371,796	7,738,608	2,028,239	23,138,643

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Berat, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet	1	Biznesi i Madh	2022	444	1	4	441
Qytet	2	Biznesi i Vogël	2022	1,282	150	79	1,353
Total 1+2				1,726	151	83	1,794
Njësitë administrative	3	Biznesi i Madh	2022	89	0	0	89
Njësitë administrative	4	Biznesi i Vogël	2022	398	39	20	417
Total 3+4				487	39	20	506

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

➤ Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore:

Deri më 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **97,326,756 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat**, si më poshtë:

Lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2021	2022	Totali progresiv
1	Subjektet fizik biznesi i vogël Berat	19,790,227	7,831,047	27,621,274
2	Subjektet juridik biznesi i madh Berat	41,083,341	12,473,990	53,557,331
3	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Otlak	1,870,505	583,019	2,453,524
4	Subjektet fizik biznesi i madh Njësia Administraive Otlak	3,897,953	2,165,920	6,063,873
5	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Velabisht	910,884	337,044	1,247,928
6	Subjektet fizik biznesi i madh Njësia Administraive Velabisht	330,096	78,950	409,046
7	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Sinje	149,783	99,822	249,605
8	Subjektet fizik biznesi i madh Njësia Administraive Sinje	923,580	392,000	1,315,580
9	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Roshnik	398,807	201,132	599,939
10	Subjektet fizik biznesi i madh Njësia Administraive Roshnik	540,600	198,750	739,350
11	Institucione	890,960	234,000	1,124,960
12	OJF	523,600	411,400	935,000
13	Ambulant	1,009,346		1,009,346
Totali		72,319,682	25,007,074	97,326,756

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Konstatohet se struktura tatimore e Bashkisë Berat për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 181 “Mos pagimi i taksës dhe tatimeve”.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2022 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Berat.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 265,846,647 lekë**, e cila përbëhet nga:

- 3,040,910 lekë detyrime për taksën e truallit për 6,838 familje;
- 23,925,480 lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 6,448 familje;
- 66,676,085 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 8,077 familje;
- 29,132,983 lekë detyrime për taksën e pastrimit për 6,394 familje;
- 9,167,850 lekë detyrime për taksën e ndriçimit për 3,102 familje;
- 4,689,895 lekë detyrime për taksën e gjelbërimit për 6,387 familje;
- 3,221,805 lekë detyrime për taksën e arsimit për 5,408 familje;
- 5,526,240 lekë detyrime për taksën e vaditjes dhe kullimit për 3,151 familje;
- 23,138,643 lekë kamatëvonesa e ndarë kjo 13,371,796 lekë biznesi i madh, 7,738,608 lekë biznesi i vogël dhe 2,028,239 lekë të tjera.
- 97,326,756 lekë detyrime nga biznesi i vogël dhe i madh.
 - a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.
 - b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
 - c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
 - d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
 - e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Berat, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
 - f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli i gjetjes: Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikim Urban Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Berat).

Konkretisht deri më datën 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 48,995,273 lekë nga të cilat deri më datë 31.12.2022, është likuduar vlera 13,525,010 lekë si dhe kanë mbetur për likuidimin e kësaj takse 1,229 persona në vlerën **35,470,263 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat**, e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Berat nuk ka të evedentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat jetë drejtuar ASHK Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen

veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Kriteri: Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën 35,470,263 lekë.

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, Bashkia Berat dhe ASHK Rajonale Berat, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **35,470,263 lekë** ndaj **1,229** personave.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Berat vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli i gjetjes: Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me licencë të bashkisë dhe papaguar tarifatat përkatëse.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me licencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve, konstatohet se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 20 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Nga 20 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, nga të cilat 8 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 8 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 1 subjekt i cili nuk ushtron aktivitetet në tregtim me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre si dhe nuk janë licensuar me leje tregtim karburanti 8 subjete të cilat ushtrojnë aktivitetet dhe kanë pa paguar detyrimin fiskal në vlerën **6,700,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat**. Gjithashtu në dy raste janë nënshkruar aktmarrëveshje me subjektet për pagimin me këste të detyrimeve.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e

lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën 6,700,000 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitetit pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisjen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **6,700,000 lekë**, për 8 subjekte.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Berat:**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e aseteve si dhe mangësi në dokumentacionit në fazën e para nënshkrimit të kontratave për marrjen e ndërtesave me qira.

Situata: a. Kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore:

Bashkia Berat ka aktive 11 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore të cilat i përkasin Njësisë Administrative Velabisht që prej vitit 2008. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Velabisht. Megjithatë njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën **37,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat**. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Njësia Administrative	Numri i kontratave	Sipërfaqja në m ²	Deri më datë 31.12.2021	Nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022	Totali progresiv
Njësia administrative Velabisht	11	77,117	33,955	3,240	37,195
Totali	11	77,117	33,955	3,240	37,195

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Sipërfaqja në m ²	Deri më 31.12.2021	Nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022	Totali Progresiv
1	B. T.	21.01.2008	11,065 m ²	-	-	-
2	S. H.	21.03.2012	4,372 m ²	-	-	-
3	V. P.	20.03.2012	2,100 m ²	-	-	-
4	L. B.	23.03.2012	1,000 m ²	-	-	-
5	A. Z.	21.03.2012	2,880 m ²	-	-	-
6	N. K.	23.03.2012	4,250 m ²	-	-	-
7	M. A.	13.12.2012	11,050 m ²	-	-	-
8	I. Rr.	13.12.2012	5,400 m ²	33,995	3,240	37,195
9	A. B.	10.09.2013	10,000 m ²	-	-	-
10	M. M.	10.09.2013	15,000 m ²	-	-	-
11	D. G.	10.02.2013	10,000 m ²	-	-	-
Totali			77,117 m²	33,995	3,240	37,195

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

b. Kontratat për dhënie me qira të ndërtesave:

Për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total janë nënshkruar 15 kontrata për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve apo efiteozë të cilat administrohen nga Bashkia Berat. Bashkia Berat posedon titull pronësie (Vërtetim hipotekor) vetëm për 4 objekte për të cilat janë nënshkruar 3 kontrata qiraje ndërsa për 11 objekte për të cilat janë nënshkruar 11 kontrata qiraje nuk posedon titull pronësie, ndërkohë që këto objekte janë dhënë me qira. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Emri i pronës adresë	Zona kadastrale	Numri pasurie	Pronësia
1	P. Sh.	Trualli i Kioskes Lagja Uznove	8504	150/45	VKM 834, datë 21.11.2012 “ Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat”.
2	R. B.	Truall per bankomatën Lagja Deshmoret e Kombat	8501	13/508	VKM 834, datë 21.11.2012
3	A. P.	Zyre te Stadiumi Tomorri,Lagja 30Vjetori	8502	18/211	VKM 834, datë 21.11.2012
4	R. E.	Zyre te Stadiumi Tomorri,Lagja 30Vjetori	8502	18/211	VKM 834, datë 21.11.2012
5	A. P.	Zyre te Stadiumi Tomorri,Lagja 30Vjetori	8502	18/211	VKM 834, datë 21.11.2012
6	M. B.	Zyre te Stadiumi Tomorri,Lagja 30Vjetori	8502	18/211	VKM 834, datë 21.11.2012
7	E. K.	Ish Parku i udhetareve ,Lagja 28 Nentori	8502	27/457	VKM 834, datë 21.11.2012
8	A. F.	Pallati i Kultures Lagja 22 Tetori	8502	11/20	VKM 834, datë 21.11.2012
9	B.. B.	Bashkia e vjeter Lagja 22 Tetori	8502	12/2	
10	Ujesjelles – Kanalizime sh.a	Ish Parku i udhetareve ,Lagja 28 Nentori	8502	27/456	VKM 834, datë 21.11.2012
11	Sh. K.	Kati perdhe Bashki Lagja 22 Tetori	8502	12/37	Vertetim hipotekor date 28.3.2013
12	B. T. shpk Kontrate Enfiteoze	Ish-Markata Lagja 28 Nentori	8502	8/153	Vertetim hipotekor date 4.2.2013
13	“G.” shpk Kontrate Enfiteoze	Ish-Konvikti i vajzave Lagja 22 Tetori	8502	12/37	Vertetim hipotekor date 31.5.2017
14	Sh. M.	Godina e pallatit te Kultures Lapardha ,Nj.Ad Otlak	2381	863/74	VKM nr.248, datë 27.03.2013

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37 ku përcaktohet se: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”. Pra referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura ky proces duhet të përfundonte në muajin nëntor të vitit 2022. Nga auditimi i dokumentacionit mbi likuidimin e tarifave për dhënie me qira të ndërtesave konstatohet se për 14 kontrata janë likuiduar detyrimet sipas çdo kontrate si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipti	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m ²	Vlera në vit	Vlera e likuiduar	Detyrimet e pa likuiduara 31.12.2022
1	P. Sh.	J.....	01.02.2022-1.02.2023	Datë 07.02.2022	16	57,000	57,000	0
2	R. B.	J.....	03.01.2019	Datë 03.01.2019	5	84,000	84,000	0
3	A. P.	K.....	07.12.2018- pa afat	Nr. 7182 prot.,datë 07.12.2018	86.4	Huapërdorje	0	0
4	R. E.	K.....	01.01.2022-01.01.2023	Datë 17.01.2022	42	100,800	100,800	0
5	A. P.	K.....	01.01.2022-01.01.2023	Nr. 217 prot.,datë 31.03.2022	16	Huapërdorje	0	0
6	M. B.	M.....	01.08.2021-01.08.2022	Datë 16.08.2021	90	108,000	0	135,000
7	E. K.	M.....	01.04.2022-01.04.2023	Datë 01.04.2022	58.3	174,900	174,900	0
8	A. F.	L.....	01.02.2022-01.02.2023	Datë 07.02.2022	44	79,200	79,200	0
9	B.. B.	L.....	30.09.2022-30.09.2023	Datë 13.09.2022	20	48,000	48,000	0
10	Ujesjelles – Kanalizime sh.a	J.....	12.09.2022-12.09.2023	Datë 13.09.2022	107	327,420	327,420	0

11	Sh. K.	M.....	26.09.2022-26.09.2023	Datë 02.09.2022	15.7	37,680	37,680	0
12	B. T. shpk Kontrate Enfiteoze	L.....	20.03.2013-20.03.2033	Nr. 237/140prot., datë 20.03.2013	1866	3,118,716	3,118,716	0
13	"G." shpk Kontrate Enfiteoze	J.....	17.07.2017-17.07.2037	Nr 854/335 prot., datë 17.07.2017	1470	Nuk është vendosur në efiçensë	Nuk është vendosur në efiçensë	0
14	Sh. M.	K.....	1.1.2022-1.1.2023	25.01.2022	32	57,600	57,600	0
Totali						4,193,316	4,085,316	135,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Lekë					
Nr.	Subjekti	Emri i pronës adresa	Zona kadastrale	Numri pasurie	Pronësia
1	V. G.	Godina e ITNG Lagja "Naftëtari"	2890	7/72	Vërtetim hipotekor me nr. 306, datë 04.09.2009

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Lekë									
Nr.	Subjekti	Nipti	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m ²	Vlera në vit	Vlera e likuiduar	Detyrimet e pa likuiduara	
1	V. G.	L.....	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 427/1 prot., datë 23.02.2022	44.6	53,520	53,520	-	
Totali						44.6	53,520	53,520	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka lidhur kontrata të reja me subjektet po ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit i cili administron 14 kontrata konstatohet se, 1 subjekt nuk ka shlyer detyrimet e kontratës në vlerën **135,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat.**

c. Ligjshmëria e lidhjes së kontratave të qirasë të ndërtesave/objekteve:

Nga auditimi i ligjshmërisë së 14 kontratave të sipërpërmendura për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën e konkurimit si më poshtë:

- Në 14 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Në 14 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Në 14 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Në 14 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- Në 14 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Në 14 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

d. Mbi monitorimin e kontratave:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Berat nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 14 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.

Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën" i ndryshuar, Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998, "Për

tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3, pika 7, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën 172,195 lekë. Parregullsi në procesin e dhënies së ndërtesave me qira.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve me të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **172,195 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve të cilët kanë marrë me qira tokë bujqësore dhe ndërtesa me qira.

Rekomandim: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë sa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

➤ **Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:**

Titulli i gjetjes: Mos arkëtim detyrimi nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet minerar.

Situata: Grupi i auditimit bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit pyjor/kullor lidhur me subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare të Bashkisë Berat dhe Njësive Administrative. Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN, konkretisht, në Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Bashkië Berat, Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se; për vitin 2022 por edhe para kësaj periudhe, në territorin e Bashkisë Berat kanë ushtruar aktivitetet subjektet si më poshtë:

1. Subjekti **“P. R. S.” SHPK** me Leje minerare shfrytëzimi nr.1359, dhe NIPT K....., datë 08.06.2009, me vendodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **13,915,000 lekë** për periudhën 2017, 2018, dhe 9 mujorin e vitit 2019. Në lidhje me këtë situatë Bashkia Berat ka paditur këtë të fundit në Gjykatën e Shkallës së Parë me çështje nr. 1570/387/91, datë 21.12.2017. (Detyrim i përllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

2. Subjekti **“B... S.” SHPK** me leje minerare shfrytëzimi nr. 1379, datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **20,207,000 lekë** për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019. Në lidhje me këtë situatë Bashkia Berat ka paditur këtë të fundit dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë me Vendimi nr. 904, datë 03.07.2018. (Detyrim i përllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

3. Subjekti “**B.**” SHPK me leje minerale shfrytëzimi nr. 1394, datë 18.06.2009, me vendodhje Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **8,470,000 lekë** për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

4. Subjekti “**T. E.**” SHPK me leje minerale shfrytëzimi nr. 1101/1, datë 10.10.2017, me vendodhje Roshnik, Berat me sipërfaqe 7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **19,250,000 lekë** për periudhën 2017-2022 dhe 3 mujorin e vitit 2023. Subjekti “T. E.” SHPK me shkresën me nr. 1956/1 prot., datë 11.03.2019, nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullozor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me Vendim Këshillit Bashkiak nr. 69, datë 07.05.2019, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullozor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror por nuk ka ardhur miratimi nga MTM.

5. Subjekti “**E.**” SHPK me leje minerale shfrytëzimi nr. 1597, datë 17.11.2012, me vendodhje Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **23,613,000 lekë** për periudhën 2017-2021, dhe 11 mujorin e vitit 2022. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

6. Subjekti “**T... B.**” SHPK me leje minerare shfrytëzimi nr. 1694, datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **30,250,000 lekë** për periudhën 2017-2022 dhe 3 mujorin e vitit 2023. Subjekti “T... B.” SHPK me shkresën me nr. 3155/1 prot., datë 01.10.2021, nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullozor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 01.07.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullozor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për vitin 2021.

7. Subjekti “**K.**” SHPK me leje minerare shfrytëzimi nr. 1909, datë 19.05.2021, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 13.5 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **10,890,000 lekë** për periudhën 7 mujorin e vitit 2021, 2022 dhe 3 mujorin e viti 2023. Subjekti “K.” SHPK me shkresën me nr. 4799/1 prot., datë 22.07.2021, nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullozor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 18.10.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullozor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror por nuk ka ardhur miratimi nga MTM.

Detyrimi total nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullozor deri më datë 31.12.2022, është në vlerën **126,595,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Berat.** (*Sipas evicendës së parqitur në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.*)

Gjithashtu në Bashkinë Berat 7 subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.

Kriteri: Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, për shfrytëzimin e grupit të rërave dhe zhavorre Bituminoze neni 15, pika 5, Neni 24, pika 10,

Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën 126,595,000 lekë.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë masat e duhura dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **92,473,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj 5 subjekteve debitorë të cilët ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit minerar dhe inerteve. Gjithashtu për 2 subjektet e tjerë të cilët kanë detyrimin në vlerën prej **34,112,000 lekë** dhe janë në proces gjyqësor nuk mund të japim një rekomandim deri në shprehjen me vendim të Gjykatës në lidhje me këto procese.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar të masa të menjëhershme ku t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Konkluzioni mbi situatën debitorë:

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve (abonent familjarë, biznesi i vogël dhe i madh, të tretë etj.) që kanë ndaj Bashkisë Berat konstatohet se, deri më datë 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën **235,954,836 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor është në vlerën **198,829,269 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Berat janë në vlerën **434,784,105 lekë**, konkretisht si më poshtë:

Lekë

Lloji i taksës dhe tarifës	Deri më 31.12.2021	01.01.2022-31.12.2022	Progresive
Detyrimet nga abonentët familjarë	113,455,113	31,926,135	145,381,248
Kamatëvonesa	20,026,770	3,111,873	23,138,643
Biznesi i madh dhe biznesi i vogël	72,319,682	25,007,074	97,326,756
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	30,119,316	5,350,947	35,470,263
Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre	-	6,700,000	6,700,000
Dhënia e tokave bujqësore me qira	33,955	3,240	37,195
Dhënia e ndërtesave me qira	-	135,000	135,000
Detyrime nga kontratatave për shfrytëzimin e fondit pyjor /kullor	-	126,595,000	126,595,000
Totali	235,954,836	198,829,269	434,784,105

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat.
2. z. S. T. me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave.

3. z. E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve.
4. znj. Znj. E. B. me detyrë Specialist i Politikave për Menaxhimin e Mbetjeve.
5. z. A. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimet Veterinar.
6. znj. K. S. me detyrë Specialist Finance.
7. znj. M. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Strehimit.
8. z. N. Q. me detyrë Specialist Pyjesh.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Berat janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 1427/6 prot., datë 30.06.2023, administruar në KLSH me praktikën nr. 208/7, datë 04.07.2023, nga z. S. T. me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave që planifikon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave është bërë mbi baza reale mbi bazën e të dhënave që ne disponojmë.

Theksojmë se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave planifikon dhe administron taksat dhe tarifave që e ngarkojnë me këtë detyrë kjo e përcaktuar në VKB nr. 93, datë 28.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit” i ndryshuar. Çdo taksë dhe tarifë që drejtoria e taksave dhe tarifave planifikon është e bazuar mbi realizim e viteve të mëparëshme dhe të dhënat faktike që disponon. Planifikimi i taksave dhe tarifave që planifikojmë është i bazuar mbi database mbi numrin subjekteve biznes/familjare si dhe mbi dokumentacionin për çdo rast.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka detyra funksionale në rregulloren e brendshme për rakordimin me drejtorinë rajonale për tarifave që nuk i administron vetë.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk planifikon dhe nuk menaxhon të ardhurat totale të Bashkisë por vetëm taksat dhe tarifave të përmendura më lartë. Thënë kjo dhe masat për mbledhjen e këtyre taksave nga agjentët nuk janë ndërrmarë pasi nuk janë funksion i drejtorisë.

-Përsa i përket detyrimeve për biznesin shprehur dhe në Projekt Raportin, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Berat është duke marrë masat të më tejshme ligjore për mbledhjen e detyrimeve të papaguara dhe uljen e borxhit të akumuluar për debitorët e bizneseve në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore.

Gjithashtu për sa i përket Projekt Raportit, për pjesën e të ardhurave që janë shprehur, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në nuk ngarkohet me përgjegjesi kjo e shprehur në VKB nr. 93, datë 28.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit” i ndryshuar si dhe në Rregulloren e Brendëshme të Bashkisë Berat me nr. 721 prot., datë 07.02.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. S. T. sqarojmë se:

Parregullsia e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë me planifikimin në total të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore pra në disa raste ka mosrealizim të planit dhe në disa tejkallim gjë e cila tregon se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk është kryer një planifikim i sakt. Kjo situatë nuk ka të bëjë me cilën drejtori ndjek taksat sipas paketës fiskale të miratuar nga VKB, prandaj për mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave

vendore janë ngarkuar me përgjegjësi edhe punonjësit e drejtorive të tjera për mos realizimin e tyre. Në total planifikimi është kryer nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore. Gjithashtu nuk është bërë një ndarje ndërmjet mbledhjes së detyrime nga debitorët para datës 31.12.2021, më qëllim evidentimin e saktë të realizimit të planit për vitin 2022.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Berat janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 1427/6 prot., datë 30.06.2023, administruar në KLSH me praktikën nr. 208/7, datë 04.07.2023, nga z. A. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar, znj. K. S. me detyrë Specialiste Finance dhe z. N. Q. Specialist Pyjesh, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar është njësi mbështetëse në varësi të Bashkisë Berat e cila aktivitetin e saj e ushtron referuar Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Grupi i Audituesve Shtetëror të KLSH të përbërë nga z. M. H. si dhe përgjegjës i grupit të auditimit z. E. M.,

Nga konkluzionet e nxjerra nga audituesit referojnë se:

-Subjekti “B.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1394, datë 18.06.2009, dhe NIPT K.....

-Subjekti “T... B.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1694, datë 27.03.2014, dhe NIPT K.....

-Subjekti “B... S.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1379, datë 03.07.2009, dhe nr. 1188, datë 10.06.2008, dhe NIPT K.....

-Subjekti “P. R. S.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1359, datë 08.06.2009, dhe NIPT K.....

-Subjekti “E.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1597, datë 17.11.2012.

-Subjekti “T. E.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1101, datë 06.12.2009, dhe nr. 1722, datë 19.06.2014, dhe NIPT J.....

-Subjekti “K.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1909, datë 19.05.2021.

Të gjitha subjektet kanë filluar aktivitetin e tyre para se të dal VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin e Pronave Pyjore dhe Kullosore”, me daljen e VKM nr. 433, Ish-Drejtorja e Shërbimit Pyjor Berat dhe Ministria Turizmit Dhe Mjedisit në Bashkin Berat Drejtoria e Bujqësisë Administrimi Pyjeve Ujërave dhe Shërbimi Veterinar nuk kanë sjellë asnjë dokument përkatës në lidhjet me subjektet që prodhojnë gurë dhe materjale inerte, kjo përveç Subjektit K.shpk që ka lejen minerale nr. 1909, datë 19.05.2021. Ish Drejtoria e Shërbimit Pyjor Berat në Drejtoria e Bujqësisë Administrimi Pyjeve Ujërave dhe Shërbimi Veterinar ka dërguar kontratat për shfrytëzimin e materialit drusor, Drejtoria e Bujqësisë Administrimi Pyjeve Ujërave dhe Shërbimi Veterinar bëri rilidhjen e kontratave sipas Vendimit nr. 438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore”, paragrafi VII pika 30.

Për prodhimin e gurit dhe materialit inertesh Ministria Turizmit dhe Mjedisit nuk ka nxjerrë ndonjë VKM ose Vendim, si nxori Vendimin nr. 438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore, Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017, të Ministrisë së Mjedisit “Për kërkesat

teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”, Udhëzimit nr. 2, datë 20.07.2016, “Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotjen e kositje bari”, VKM nr. 391, datë 21.06.2016, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.11.2010, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” nuk të jep të drejtën për lidhjen e kontratave të pyjeve dhe kullotave në pronësi dhe administrim nga Bashkia Berat ajo përcakton vetëm tarifën të cilat vendosen kur lidhet një kontratë qiraje. VKM nr. 1064, është i vitit 2010 ndërsa ndryshimi i Ligjit të Pyjeve i cili heq të drejtën e dheniës së gurorëve me qira, është i vitit 2012.

Sipas Ligjit nr. 15/2012, “Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor” në nenin 17 të këtij ligji:

Pika 1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.

Në bazë të këtij ndryshimi strukturat e pyjeve nuk kanë të drejtë të lidhin kontrata me subjektet që kanë aplikuar në Ministrinë përkatëse për heqjen nga fondi pyjor dhe kulloror pjesën e sipërfaqes të marrë në përdorim ose shfrytëzim të paraqitur në lejen mjedisore.

Për sa më sipër në tabelën e paraqitur në materialin tuaj;

1. Subjekti “B.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1394, datë 18.06.2009, është paraqitur pranë drejtorisë tonë me një dokument me nr. 8122 prot., më datë 15.12.2015, nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, të cilit këtij subjekt i është revokuar leja minerare me nr. 1368, datë 18.06.2009, për gëlqerore pllakore. (Kopje të kësaj shkresë është dërguar tek ju në observimin e vitit 2019) dhe në raportin e lejes minerarë të rinovuara dhe të printuara nga AKBN nuk rezulton ky subjekt me leje minerare.

2. Subjekti “T. E.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1101, datë 06.12.2009, dhe nr. 1722, datë 19.06.2014, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7 ha me anë të shkresës nr. 1956/1 prot., datë 11.03.2019, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor/kulloror, Struktura përgjegjëse për pyjet pranë Drejtoria e Bujqësisë, Administrimi i Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimi Veterinar, Bashkia Bera, ka zhvilluar procedurë ligjore dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 69, datë 07.05.2019, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/ kulloror publik për veprimtari minerare. Nga ana jonë gjithashtu është njoftuar subjekti “T. E.” shpk se nuk mund të ushtroj aktivitet minerar deri në daljen e VKM-së përkatëse.

3. Subjekti “T... B.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1694, datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 ha, me shkresën nr. 3155/1 prot., datë

01.10.2021, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor/kullosor, Struktura përgjegjëse për pyjet pranë Drejtoria e Bujqësisë, administrimi i Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimi veterinar, Bashkia Berat, ka zhvilluar procedure ligjore dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 01.07.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor publik për veprimtari minerare. Nga ana jonë gjithashtu është njoftuar subjekti “T... B.” shpk, se nuk mund të ushtroj aktivitet minerar deri në daljen e VKM-së përkatëse.

4. Subjekti “K.” SHPK me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1909, datë 19.05.2021, me vendndodhje në Sinjë Berat, me sipërfaqe 13.5 ha me shkresën nr. 4799/1 prot., datë 22.07.2021, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor/kullosor, Struktura përgjegjëse për pyjet pranë Drejtoria e Bujqësisë, administrimi i Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimi veterinar, Bashkia Berat, ka zhvilluar procedure ligjore dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 18.10.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor publik për veprimtari minerare. Nga ana jonë gjithashtu është njoftuar subjekti “K.” shpk se nuk mund të ushtroj aktivitet minerar deri në daljen e VKM-së përkatëse.

5. Subjekti “B...S.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1379, datë 03.07.2009, me vendndodhje Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7 ha është paditur nga ana e Bashkisë Berat në Gjykatën e shkallës së parë me Vendim nr. 904, datë 03.07.2018, dhe vazhdon të jetë në proces, për këtë arsye deri në përfundim të procesit nuk mund të ushtrohen kompetencat ligjore nga ana jonë.

6. Subjekti “P. R. S.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1359, datë 08.06.2009, me sipërfaqe 11.5 ha dhe me vendndodhje Roshnik, Berat është paditur nga ana e Bashkisë Berat në Gjykatën e shkallës së parë me Vendim nr. 1570/387/91, datë 21.12.2017, dhe vazhdon të jetë në proces, për këtë arsye deri në përfundim të procesit nuk mund të ushtrohen kompetencat ligjore nga ana jonë.

7. Subjekti “E.” shpk me Leje minerale shfrytëzimi nr. 1597, datë 17.11.2012, vendndodhje në Roshnik Berat, me sipërfaqe 9.2 ha, ka si detyrim të prapambetur 23,613,000 lekë shumë për të cilën do i dërgohet njoftim për shlyerje të detyrimit.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. A. Sh., znj. K. S. dhe z. N. Q. sqarojmë se:

Tarifimi i aktivitetit minerar apo karrirave në territorin e Bashkisë Berat nuk fillon me daljen e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, ky aktivitet nga viti 2006 tarifohej në zbatim të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. Tarifimi i aktivitetit mierare edhe për karrirat e para viteve 1990 është detyrim ligjor për pronarët ku shtrihen sipërfaqet e sipërcituara.

Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësisive të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Ligji i fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për NJQV është ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i cili në nenin 37 përcakton se: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për

detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021.

Në lidhje me komentet e bëra nga z. A. Sh., znj. K. S. dhe z. N. Q. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

*Nga Bashkia Berat nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **75.90 ha** me vlerë ekonomike **2,914,260 lekë/vit.***

Në përllogaritjen e vlerës së sipërcituar, grupi i auditimit i është referuar pikës 2, të VKM –së nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ku sanksionohet: “Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullor publik, zbatohen tarifatat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës,…”.

Lidhjen nr. 2, pika 6 “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)” kohëzgjatje 6-10 vjet, për përdorim territori është: 440,000 lekë/ha/vit.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin 2022, (përfshijnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 të Aparatit të Bashkisë Berat, Agjencisë së Shërbimeve Publike, Qendrës Lira, Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Bujqësisë Administrimit të Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar) janë të nënshkruara nga z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. R. Sh. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Berat me shkresën nr. 2196 prot., datë 24.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë z. E. D. Kryetar i Bashkisë brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar me shkresën me nr. 355 prot., datë 24.04.2023.

Rakordimi i pasqyrave financiare me Thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël janë kryer me regjistra ose në programin E..

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2022, deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Berat për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2022.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të Bashkisë Berat (pasqyrat financiare të konsoliduara), Formatin nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitet dhe pasivitet, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqitet e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	301,168,981	230,426,278	70,742,703
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	5,147,959	6,031,400	(883,441)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		306,316,940	236,457,678	69,859,262

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 301,168,921 lekë përbëhet nga: gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në shumën 226,870,834 lekë (fondi i trashëguar 212,673,235 lekë nga: transfertat e pakushtëzuar 5,623,554 lekë, transfertat specifike në vlerën 69,056,981 lekë, transfertat për projekte specifike në vlerën 25,121,160 lekë, të ardhurat e veta në vlerën 110,762,143 lekë dhe sponsorizime në vlerën 2,109,398 lekë. Në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor është edhe vlera e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në shumën -14,197,589 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 88,495,745 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
31	Materiale	38,271,761	32,980,439	5,291,322
32	Inventar i imët	99,403,488	90,582,676	8,820,812
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	85,455	0	85,455
36	Kafshë në rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje të pambritura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		137,760,704	123,563,115	14,197,589

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 137,760,704 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 38,271,761 lekë, llogaria 32 “Inventar i imët” 99,403,488 lekë dhe llogaria 35 “Mallra” në vlerën 85,455 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 14,197,589 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në shumën -14,197,589 lekë.

-Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 38,271,761 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

		Lekë
Lëvizjet e llogarisë	Vlera	
Çelje e vitit 2022		32,980,439
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022		137,146,134
Dalje ng amagazina gjatë vitit 2022		131,854,812
Gjendja në 31.12.2022		38,271,761

-Llogaria 32 “Objekte inventari”, ka vlerën 99,403,488 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

		Lekë
Lëvizjet e llogarisë	Vlera	
Çelje e vitit 2022		90,582,676
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022		13,391,193
Dalje ng amagazina gjatë vitit 2022		4,570,381
Gjendja në 31.12.2022		99,403,488

-Llogaria 35 “Mallra”, ka vlerën 85,455 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

		Lekë
Lëvizjet e llogarisë	Vlera	
Çelje e vitit 2022		0
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022		1,545,999
Dalje ng amagazina gjatë vitit 2022		1,460,544
Gjendja në 31.12.2022		85,455

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

					Lekë
Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021	
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	411,883,431	370,046,383	41,837,048	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	57,860,696	76,634,691	(18,773,995)	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	469,744,127	446,681,074	23,063,053	
	Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	209,536,764	170,583,571	38,953,193	
	Totali	209,536,764	170,583,571	38,953,193	

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 370,046,383 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 411,883,431 lekë me një rritje në vlerën 41,837,048 lekë. Në mënyrë analitike të dhënat paraqiten si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2022		370,046,383
Shtesa (K)		173,220,769
Pakësime (D)		131,383,721
Gjendja debitore në 31.12.2022		411,883,431

Vlera e mësipërme e pasqyruar në bilanc prej 411,883,431 lekë përbëhet nga:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Nr.		
1	Detyrime të biznesit për taksa dhe tarifa vendore ambulante, institucione	120,465,398
2	Detyrime të familjeve për taksa dhe tarifa vendore	145,381,249
3	Debitore të tjera të tregut dhe hapësirave publike	13,464,280
4	Debitorë të ndryshëm	132,572,504
Totali		411,883,431

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”			Lekë
Nr.		Llogaria kontabël	Shuma
1	Debitore biznesi Bashkia dhe Njësitë Administrative	468	120,465,396
2	Debitore taksa e tarifa familjare Rajoni 1	468	9,519,430
3	Debitore taksa e tarifa familjare Rajoni 2 dhe 3	468	10,537,004
4	Debitore sipas akt kontrollit Velabisht	468	1,199,254
5	Debitore taksa e tarifa familje Njësia Administraive Velabisht	468	41,098,215
6	Debitore sipas akt kontrollit Otlak	468	7,229,248
7	Debitore taksa e tarifa familje Njësia Administraive Otlak	468	48,755,553
8	Debitore 88 subjekte në Njësia Administraive Otlak KLSH, Otlak	468	1,267,000
9	Debitore taksa e tarifa familje Njësia Administraive Roshnik	468	8,043,976
10	Debitore taksa e tarifa familje Njësia Administraive Sinje	468	27,427,072
11	Debitore të tregut industrial	468	77,220
12	Debitore për hapësirat publike	468	3,691,560
13	Debitore nga veterineret	468	80,000
14	Debitore qira	468	135,000
15	Debitore banesave sociale	468	231,452
16	Debitore MZSH	468	1,775,000
17	Debitore të KLSH	468	78,037,937
18	Debitore IMT	468	47,485,000
19	Debitore Policisë Bashkiake	468	310,500
20	Debitore të tjerë	468	14,128
Totali Bashkia (qendra)		468	407,379,944
Totali Agjencia e Shërbimeve Publike		468	1,752,066
Totali Drejtoria e Arsimit		468	1,832,778
Totali Qendra “Lira”		468	918,643
Grand Totali		468	411,883,431

Nga të dhënat e Drejtoria Taksave dhe Tarifave të cilat janë paraqitur pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave ka pasqyruar vlerën e detyrimeve nga taksat dhe tarifave vendore si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Nr.		
1	Debitore biznesi Bashkia dhe Njesite Administrative	120,465,396
2	Debitore taksa e tarifa familjare Rajoni 1	9,519,430
3	Debitore taksa e tarifa familjare Rajoni 2 dhe 3	10,537,004
4	Debitore sipas akt kontr Velabisht	1,199,254
5	Debitore taksa e tarifa familje Nj. A. Velabisht	41,098,215
6	Debitore sipas akt kontrollit Otlak	7,229,248
7	Debitore taksa e tarifa familje Nj. A. Otlak	48,755,553

8	Debitore 88 subjekte ne k.Otllak KLSH, Otllak	1,267,000
9	Debitore taksa e tarifa familje Nj.A. Roshnik	8,043,976
10	Debitore taksa e tarifa familje Nj.A. Sinje	27,427,072
11	Debitore te tregut industrial	77,220
12	Debitore per Hapesirat Publike	3,691,560
Totali		279,310,927

Në mënyrë analitike paraqiten debitorët me vlera më të larta dhe faza në të cilën ndodhen si më poshtë:

Lekë			
Nr.	Lista e debitorëve me vlera më të larta		
1	K. B.	20,193,814	Urdhër zhdëmtim nr. 409, datë 07.06.2016, për vlerën e trualiit, punime pa leje ndërtimore
2	B. T. shpk	8,972,640	Urdhër zhdëmtim nr. 406, datë 07.06.2017 për mosaplikim i qirasë.
3	I. C.	8,539,922	
4	G... shpk & B.. shpk	6,482,720	Njoftim nr. 2341 prot., datë 26.05.2020, për punime të pakryera
5	S. shpk & B. shpk	5,992,146	Urdhër zhdëmtim nr. 400, datë 07.06.2016, "Rikonstruks i shëtitores Osumi"

Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi në bilanc i vlerës 155,473,178 lekë e cila është detyrim i debitorëve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Berat si dhe nuk është kryer analiza për vlerën 62,019,852 lekë trashëguar nga ish-komunat të cilat i përkasin llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm".

Situata: 1. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifave vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat më datën 31.12.2022 (vlerë e cila e konstatuar përgjatë auditimit), konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifave vendore janë në vlerën 411,883,674 lekë (prej 279,310,927 lekë ose 67.8 % të debitorëve e zënë debitorët e taksave) ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 434,784,105 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 155,473,178 lekë.

2. Gjithashtu konstatohet se, për llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" nga analiza e kësaj llogarie vlera prej 62,019,852 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish-Komunat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish-Komunat kaluan në administrim nga Bashkia Berat, me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për gjetjen e origjinës dhe arkëtimin e kësaj vlere.

Kriteri: Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Ndikimi/Efekti: Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Mbajtja e kontabilitetit pa u mbështetur në dokumenta justifikues.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të sistemojë llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifave vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 62,019,852 lekë trashëguar nga ish-Komunat.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 57,860,696 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 55,818,284 lekë shpenzimet korrente dhe 2,042,412 lekë shpenzimeve kapitale sipas pasqyrës së evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

II. AKTIVET AFAT GJATA

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 88,163,131 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,962,472 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 49,996,760 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 52,128,843 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në *Aneksin nr. 2, pika 4, “Studime-Projektme(kosto historike), bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Titulli i gjetjes: Mos sistemim i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke paraqitur në këtë llogari në mënyrë jo të drejtë edhe vlerën e projekteve prej 88,163,131 lekë kosto historike, investimet e të cilave kanë përfunduar.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” konstatohet se vlera prej 88,163,131 lekë kosto historike e kësaj llogarie përbëhet nga 68 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

Kriteri: VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrushme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime” dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Ndikimi/Efekti: Aktivi i bilancit për llogarinë 202 “Studime dhe projekte” nuk pasqyron vlerën e saktë të kësaj llogarie, për rrjedhojë ulje e vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për këto dy llogari.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 88,163,131 lekë kosto historike dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

-Llogaria 203 “Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjajshme” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 384,000 lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 384,000 lekë. Analiza e detajuar e

llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

2. Aktivitet Afatgjatë Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 33,763,064 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 33,763,064 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 1,146,200 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 369,600, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,515,800 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Berat.

Situata: Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 680 prot., datë 20.12.2021, i ndryshuar të Kryetarit të Bashkisë dhe VKB nr. 36, datë 22.05.2020, “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësisve administrative për vitin 2020”, i ndryshuar me VKB nr. 34, datë 18.05.2020/31.01.2022, VKB nr. 30, datë 18.05.2022, VKB nr. 99, datë 22.12.2022, me numër 160 punonjës për muajin Janar deri në muajin Maj 2022, 162 punonjës në muajin Qershor deri në muajin Shtator 2022, 163 punonjës Shtator deri në Nëntor 2022, 169 punonjës muaji Dhjetor 2022. Nga auditimi konstatohet se, në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël veprime këto në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 3, datë 18.07.2002, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”.

Bashkisë Berat, me VKM nr. 834, datë 21.11.2012, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Berat, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me në total 2948 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se me VKB nr. 24, datë 01.06.2012, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme

shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 2895 (dymijë e tetëqind e nëntëdhjet e pesë) dhe përbëhet me 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë ndryshuar me;

-VKM nr. 238/2015, Bashkisë Berat i janë transferuar 8 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 915/2015, Bashkisë Berat i janë transferuar 5 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 1049/2015, Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 366/2016, Bashkisë Berat i janë transferuar 2 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 104/2016, Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 291/2020, Bashkisë Berat i janë transferuar 1 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 266/2021, Bashkisë Berat i janë transferuar 3 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

-VKM nr. 569/2021, Berat i janë transferuar 3 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.

Ish-Komunës Sinjë sot Njësia Administrative Sinjë e Bashkisë Berat, me VKM nr. 920, datë 02.07.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Sinjë, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 285 prona nga të cilat 220 prona në pronësi dhe 63 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se me VKB nr. 9, datë 31.01.2018, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Sinjë, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 341 (treqind e dyzet e një) dhe me shkresë nr. 820, datë 12.02.2018, është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish-Komunës Otlak sot Njësia Administrative Otlak e Bashkisë Berat, me VKM nr. 248 datë 27.03.2013, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Otlak, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 1478 prona nga të cilat 1165 prona në pronësi dhe 313 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se me VKB nr. 67, datë 07.05.2019, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njesisë Administrative Otlak, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 1585 (njëmijë e tetëqindë e tetëdhjet e pesë), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresë nr. 603/1, datë 10.05.2019. Me shkresë nr. 1998/1 prot., datë 12.05.2019, është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish-Komunës Velabisht sot Njësia Administrative Velabisht e Bashkisë Berat, me VKM nr. 1410, datë 22.10.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Velabisht, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 2540 prona nga të cilat 2465 prona në pronësi dhe 75 prona në përdorim. Nga dokumentacioni i vënë në

dispozicion konstatohet se me VKB nr. 124, datë 25.10.2018, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Velabisht, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 2570 (dymijë e pesqindë e shtatëdhjet), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat, me shkresë nr. 2565/1 prot., datë 29.10.2018. Me shkresë nr. 812/1 prot., datë 14.05.2019, është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Ish-Komunës Roshnik sot Njësia Administrative Roshnik e Bashkisë Berat, me VKM nr. 879, datë 12.12.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Roshnik, të Qarkut Berat”, i është miratuar lista inventarit me 640 prona në pronësi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se me VKB nr. 26, datë 26.07.2016, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Roshnik, në Bashkinë Berat. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 640 (gjashtëqind e dyzetë), listë e cila nuk i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative (Sinjë, Otlak, Roshnik dhe Velabisht) nuk janë kryer veprime për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Berat; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Berat, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës, nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të Ligjit nr. 33-2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30 dhe pika 35, gërma “a” si dhe Ligji nr. 20/2020, “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV, neni 37.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2019	Nr. Praktikave te Certifikuara 2020-2021	Prona te pa Rregjistruara
1	Bashkia Berat	2757	49	2	2706
2	Njësia Administrative Sinjë	285			285
3	Njësia Administrative Otlak	1478			1478
4	Njësia Administrative Velabisht	2540			2540
5	Njësia Administrative Roshnik	640			640
	Totali	7700	49	2	7659

Burimi: Bashkia Berat

Në mënyrë të detajuar pronat të cilat janë regjistruar gjatë periudhës objekt auditimi në ASHK, si vijon:

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	Qendra Kulturore	8502	12/280	BR-K-6	00008750	514.8	565.5	7750;16/7/20	Çertifikat	514.8	309.5

2	Truall për nd banesash për të pastrehët	8502	24/227	BR-M-8	00001221	3930.3	0	5104;09/06/2021	Çertifikat	3930.3	0
---	---	------	--------	--------	----------	--------	---	-----------------	------------	--------	---

Burimi: Bashkia Berat

Nga auditimi konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 2 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 7659 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 49 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) NJSH, ndërsa 2 objekte janë transferuar me VKM e sipërcituara dhe janë të pajisura me certifikat pronësie.

Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve, Emergjencave civile dhe Pronave, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Berat në Drejtorinë rajoneve të ASHK Berat, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 51 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Berat. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16.

Kriteri: Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre asetëve, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”. Dhe Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku: Mungesa e sektorit të menaxhimit të asetëve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Berat.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marren masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 51 prona të certifikuar në

ASHK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiare.

-Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 1,340,858,057 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 297,012,057 lekë, dhe amortizim vjetor në vlerën 490,251,391 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,556,419,246 lekë.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 1,203,065,696 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 23,375,117 lekë, pakësim në vlerën 1,500,520 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 385,619,336 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,160,327,686 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes: Aktive të transferuara nga Bashkia Berat në Shoqërinë Ujësjiellës Berat-Kuçovë por të pasqyruara ende në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se deri më datën 31.12.2022, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 97,337,675 lekë në total në Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë Sh.a dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Berat. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Berat për Ujësjiellës Berat-Kuçovë Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike) sipas inventarit fizik	Gjendja 01.01.2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2022	Vepra të cilat duhet të transferohen tek Ujësjiellës Kanalizime Berat dhe Agjencia e Shërbimeve Publike
KUZ Kodra e Sulmit	4,195,037			4,195,037	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
KUZ Veterik	11,911,810			11,911,810	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
KUZ Morave Rom	2,506,889			2,506,889	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
Ujësjiellësi Roshnik	64,269,939			64,269,939	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
Ujësjiellësi i Paftalit		9,466,265		9,466,265	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
ndertim linje furnizimime uje uznove bilc		4,987,735		4,987,735	Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçove sha
Totali	82,883,675	14,454,000		97,337,675	

Kriteri: Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrat financiare për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” përmbajnë në gjendjen e tyre kontabël vlera të aktiveve që në fakt janë transferuar nga Bashkia Berat në Shoqërisë Ujësjiellës Berat-Kuçovë dhe janë në administrim të kësaj të fundit, duke mos pasqyruar me vërtetësi vlerën e saktë të aktiveve të institucionit për këto llogari.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pasi nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet e mësipërme nga dy institucionet. Mos pasqyrim në librat e kontabilitetit të lëvizjes së aktiveve (pakësimet nga transferimet).

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për sistemin e vlerën 97,337,675 lekë në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e cila i përket aktiveve të transferuara nga Bashkia Berat drejt Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 39,695,493 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 5,477,746 lekë, pakësim në vlerën 6,718,232 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 94,256,619 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 38,527,694 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 149,854,543 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 36,663,677 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 129,766,965 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 153,771,512 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes: Kontabilizim jo i saktë i llogarisë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare.
Situata: Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 283,538,478 lekë kosto historike. Në këtë vlerë është përfshirë edhe tre mjete konkretisht Kamion me targe TR...., F. B., Ekskavator N.. me vlerë kosto historike 4,922,000 lekë të cilat nuk është në gjendje pune. Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 4,922,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Kriteri: Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1.

Ndikimi/Efekti: Paraqitje jo e saktë e llogarisë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare.

Shkaku: Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 4,922,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 3 automjeteve të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 73,909,946 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 23,375,117 lekë, pakësim në vlerën 1,500,520 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 94,933,098 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,564,326 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi i aksioneve të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA në llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare”.

Situata: Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, me NUIS “J.....” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 797,785,000 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhri nr. MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti:

Shkaku: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2021, të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 572,787,000 lekë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 1,706,661,171 lekë, ku është kontabilizuar vlera për 61 kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2022. (Të dhënat përkatëse analitike të kësaj llogarie, paraqiten në Aktkonstatimin e mbajtur me nr. 5, datë 05.05.2023)

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Berat më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të

muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,758,296	21,101,803	(16,343,507)
42	Detyrime ndaj personelit	31,526,547	29,561,722	1,964,825
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	2,734,219	2,222,057	512,162
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	9,395,141	8,828,466	566,675
436	Sigurime shëndetësore	1,297,266	1,210,323	86,943
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	5,147,959	6,031,400	(883,441)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	88,495,745	85,583,155	2,912,590
467	Kreditorë të ndryshëm	217,685,991	184,293,887	33,392,104
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	49,075,157	43,862,821	5,212,336
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		410,116,321	382,695,634	27,420,687

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 31.12.2022, është në vlerën 4,758,296 lekë paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Berat. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	21,101,803
Shtesa (K)	414,238,546
Pakësime (D)	430,582,053
Gjendja debitore në 31.12.2022	4,758,296

Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 4,758,296 lekë përbëhet nga:

Lekë			
Faturat e pa likuiduara deri më datë 31.12.2022			
Nr.	Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	Subjektet	Detyrimi
1	Kolaudim objekti Ujësjiellësi fshati Duhanas	M. K.	542,561
2	Pirografi	K. K.	6,000
3	Lavatrice Samsung	A. T.	90,000
4	Pjesë këmbimi B..	G. D.	198,300
5	Pjesë këmbimi autoshkalla Savjen	G. D.	35,000
6	Projekti “A. T...”: Ndërhyrje për rritjen e aksit cilesor në kalane e Beratit	L. K. SHPK	178,130
7	Pjesë këmbimi Eölkssägen	G. D.	52,600
8	Karburant bashkia	G. C. G...Shpk	402,984
9	Pjesë këmbimi Mitsubishi me targë 6.... MZSH	G. D.	22,900
10	Pjesë këmbimi B.. me targë AA...	G.D.	105,400
11	Rivitalizim i fshatit Roshnik	Rr. C.	40,000
12	Blerje tonera	B. T.	194,340
13	Supervizim punimesh Rivitalizim i mjediseve atraktive në fshatin Roshnik	3... S.	246,037
14	Blerje lodra për këndin e lojërave në lagjen “Dëshmorët e Kombit”	S. N.	117,008
15	Supervizim punimesh Kopshte dhe shtigje biçikletash Projekti “E Natura”	I. D. S.	130,285
16	Projekti Zgjatim i shtigjeve të biçikletave	B. K.	501,727
17	Pjesë këmbimi automjeti I..	G. D.	130,700
18	Karburant për MZSH	G. C. G... shpk	198,432
19	Fishekzjarre	A. W. SHPK	516,000
Totali Bashkia Qendra			3,708,404
20	Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, çerdhe dhe konvikt muaji Dhjetor 2022	S. T. SHPK	1,049,892
Totali Drejtoria e Arsimit			1,049,892
Grand Totali			4,758,296

Titulli i gjetjes: Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara. Marrja e angazhimeve për kryerjen e shpenzimeve përtej kufirit të fondeve buxhetore të disponuara realisht, në llogarinë e thesarit.

Situata: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 21,101,803 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 414,238,546 lekë dhe pakësim në vlerën 430,582,053 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,758,296 lekë. Shtesa e detyrime të Bashkisë Berat për llogarinë 401-408 gjatë vitit 2022 është në vlerën 4,758,296 lekë e cila përbëhet nga 20 shpenzime kryesisht kontrata supervizimi/mbikëqyrje, shërbime dhe blerje mallrash të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten më sipër. Angazhime të marra mbi bazën e planifikimit të pritshëm për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë por këto angazhime janë marrë pa u siguruar të ardhurat reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 217,685,991 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 279,603,637 lekë dhe pakësim në vlerën 246,211,533 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,685,991 lekë të cilat i përkasin kryesisht vendimeve gjyqësore, shërbimeve dhe blerjeve.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 50, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 70.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, denatyrin i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndo shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 217,685,991 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 31,526,547 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2022		29,561,722
Shtesa (K)		377,464,236
Pakësime (D)		375,499,411
Gjendja debitore në 31.12.2022		31,526,547

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Numër	Datë		
1	13.01.2023		4,033,173.00
2	13.01.2023		1,266,334.00
3	13.01.2023		42,112.00
4	13.01.2023		53,109.00
5	13.01.2023		97,532.00

6	13.01.2023	190,133.00
7	13.01.2023	314,950.00
8	13.01.2023	543,147.00
9	13.01.2023	345,862.00
10	13.01.2023	165,534.00
11	13.01.2023	1,253,990.00
12	13.01.2023	184,381.00
13	13.01.2023	50,350.00
14	13.01.2023	342,190.00
15	13.01.2023	41,989.00
16	13.01.2023	41,989.00
76	09.02.2023	139,060.00
Total		9,105,835.00
Pagat per Qendra streheza pa kaluar pasi fondet nuk jane akorduar nga ministria		60,874.00
Total Bashkia (qendra)		9,166,709.00
1	13.01.2023	128,623
2	13.01.2023	552,420
3	13.01.2023	171,841
4	13.01.2023	961,023
5	13.01.2023	2,345,653
6	13.01.2023	239,727
7	13.01.2023	206,086
8	13.01.2023	90,751
Totali Agjencia e Shërbimeve Publike		4,696,124
1	13.01.2023	11,335,346
2	13.01.2023	762,184
3	13.01.2023	400,801
4	13.01.2023	624,665
5	13.01.2023	227,684
6	13.01.2023	72,731
7	13.01.2023	611,361
8	13.01.2023	186,907
9	13.01.2023	43,094
Totali Drejtoria e Arsimit		14,264,773
2	12.01.2023	53,928
3	12.01.2023	579,631
4	12.01.2023	361,708
5	12.01.2023	36,310
6	12.01.2023	36,310
Totali Qendra Kulturore "M. Tutulani"		1,067,887
1	13.01.2023	160,787
2	13.01.2023	48,683
3	13.01.2023	79,135
4	13.01.2023	154,920
5	13.01.2023	661,514
6	13.01.2023	128,397
Totali Drejtoria e Bujqësisë		1,233,436
1	12.01.2023	1,097,618
Totali Qendra "Lira"		1,097,618
Grand total		31,526,547.00

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën 2,734,219 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2022	2,222,057
Shtesa (K)	33,104,280
Pakësime (D)	32,592,118
Gjendja debitore në 31.12.2022	2,734,219

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 kosntatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
17	13.01.2023	529,200
18	13.01.2023	129,114
19	13.01.2023	30,189
25	19.01.2023	774,109
44	25.01.2023	10,143
165	20.03.2023	3,795
Total Bashkia (Qendra)		1,476,550
10	13.01.2023	111,015
Totali Agjencia e Shërbimeve Publike		111,015
10	13.01.2023	45,273
11	13.01.2023	682,109
Totali Drejtoria e Arsimit		727,382
1	12.01.2023	57,728
7	16.01.2023	230,250
Totali Qendra Kulturore "M. Tutulani"		287,978
7	13.01.2023	51,769
Totali Drejtoria e Bujqësisë		51,769
2	12.01.2023	79,525
Total Qendra "Lira"		79,525
Total		2,734,219

-Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 9,395,141 lekë dhe 1,297,266 lekë.

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
17	13.01.2023	2,111,298
18	13.01.2023	561,166
19	13.01.2023	125,910
44	25.01.2023	57,959
Totali Bashkia (qendra)		2,856,333
10	13.01.2023	1,409,065
Totali Agjencia e Shërbimeve Publike		1,409,065
10	13.01.2023	411,079
11	13.01.2023	3,729,519
Totali Drejtoria e Arsimit		4,140,598
1	12.01.2023	310,560
Totali Qendra Kulturore "M. Tutulani"		310,560
7	13.01.2023	353,810
Totali Drejtoria e Bujqësisë		353,810
2	12.01.2023	324,775
Totali Qendra "Lira"		324,775
Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"		9,395,141
17	13.01.2023	292,307
18	13.01.2023	65,385
19	13.01.2023	17,472
44	25.01.2023	8,043
Totali Bashkia (qendra)		383,207
10	13.01.2023	202,078
Totali Agjencia e Shërbimeve Publike		202,078
10	13.01.2023	57,044
11	13.01.2023	517,561
Totali Drejtoria e Arsimit		574,605

1	12.01.2023	43,098
Totali Qendra Kulturore “M. Tutulani”		43,098
7	13.01.2023	49,208
Totali Drejtoria e Bujqësisë		49,208
2	12.01.2023	45,070
Totali Qendra “Lira”		45070
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”		1,297,266

-Llogaria 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë”, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 6,031,400 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 5,520,000 lekë dhe pakësim në vlerën 6,403,441 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,147,959 lekë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Berat në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 88,495,745 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masë 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Berat. Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në *Aneksin nr. 1, pika 4, “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Titulli i gjetjes: Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 85,583,155 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit Berat. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 20,346,860 lekë dhe pakësim në vlerën 17,434,270 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 88,495,745 lekë. Për 109 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia janë ngurtësuar fonde në vlerën 63,016,632 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Kriteri: Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 217,685,991 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari

ka pasur shtesa në vlerën 279,603,637 lekë dhe pakësim në vlerën 246,211,533 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,685,991 lekë. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” është vlerën 217,685,991 lekë dhe kjo vlerë kuadron me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 209,536,764 lekë (për detyrimet e prapambetura 60 ditore) kësaj vlere i shtohet edhe llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 8,149,227 lekë për detyrimet për shpenzime/shërbime të kryera në muajin dhjetor. *(Të dhënat përkatëse analitike të kësaj llogarie, paraqiten në Aktkonstatimin e mbajtur me nr. 5, datë 05.05.2023)*

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Berat në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 49,075,157 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

-Llogaria 470 “Të ardhura për t’u marrë”, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 326,183,562 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 69,362,256 lekë dhe pakësim në vlerën 32,737,544 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 362,808,274 lekë sipas pasqyrës së evidentuar në aktkonstatimin përkatës të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

II. Pasivet Afat Gjata

-Llogaria 16,17,18 “Huatë afatgjata”, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 21,253,117 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur pakësim në vlerën 6,815,715 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 14,437,402 lekë.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 210,473,334 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 153,338,052 lekë ose me zbritje në vlerën 57,135,282 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 139,375,937 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 127,601,471 lekë se me zbritje në vlerën 11,774,466 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,035,042,667 lekë ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,218,161,685 lekë ose me ritje në vlerën 183,119,018 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën e

evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 416,875,378 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 444,113,839 lekë ose me rritje në vlerën 27,238,461 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 68,623,671 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 74,090,097 lekë ose me rritje në vlerën 5,466,426 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Berat me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2021, ka qenë në vlerën 274,946,568 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 247,707,383 lekë ose me zbritje në vlerën 27,239,185 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Berat me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	247,707,383	274,946,568
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	363,269
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	5,176,687	7,561,481
6021	Materiale dhe shërbime speciale	29,340,746	60,791,302
6022	Shërbime nga të tretë	36,139,207	120,884,283
6023	Shpenzime transporti	25,762,883	9,011,330
6024	Shpenzime udhëtimi	171,260	932,578
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	11,580,266	47,168,505
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,228,262	1,734,775
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	138,308,072	26,499,045

Për vitin 2022 totali i te ardhurave në vlerë është 1,499,101,208 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,272,230,374 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 226,870,834 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerë 226,870,834 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me

vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Titulli i gjetjes: Përfitimi i shërbimeve pa procedurë prokurimi.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 5 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfitur nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i projektit	Urdhër Shpenzimi		Operatori Ekonomikë	Vlera
		Nr.	Datë		
a	Aktivitet Ç.....	76	19.05.2022	K.....	204,000
b	Aktivitet Ç.....	77	19.05.2022	K.....	245,650
c	Aktivitet Ç.....	78	19.05.2022	K.....	29,750
1	Vlera total Aktivitet C.....				479,400
a	Aktivitet G.....	215	19.12.2022	K.....	854,250
b	Aktivitet G.....	216	19.12.2022	K.....	297,500
2	Vlera total Aktivitet G.....				1,151,750
Totali					1,631,150

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 94, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”. Pjesë e këtij buxheti janë parashikuar edhe fondet për projektet artistike të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”. Nga Bashkia Berat për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 2 subjekte është likuiduar shuma 1,631,150 lekë. **Vlera 1,631,150 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.**

Kriteri: Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Ndikimi/Efekti: Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 1,631,150 lekë.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Gjendja e fondeve të

llogarisë **603 “Subvencione”** paraqiten në bilanc për vitin 2022 në vlerën 33,000,000 lekë e cila rakordon me aktrakordimin e Thesarit.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
603	IV. Subvencione	33,000,000	33,000,000
6030	Subvencione për diferencë çmimi	0	0
6031	Subvencione për të nxitur punësimin	0	0
6032	Subvencione për të mbuluar humbjet	0	0
6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale	0	0
6039	Subvencione të tjera	33,000,000	33,000,000

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 487,516,644 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 478,215,874 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
	V. TRANSFERIME KORENTE	487,516,644	446,603,199
604	1. Transferime korente të brendshme	9,300,770	2,375,406
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	9,300,770	2,375,406
6041	Transferime korente tek institucione të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse	0	0
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për Qeveritë e Huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	478,215,874	444,227,793
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucionet e tjera Pushtetit Vendor	478,215,874	444,083,667

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 680 prot., datë 20.12.2021, i ndryshuar të Kryetarit të Bashkisë dhe VKB nr. 36, datë 22.05.2020, “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njëjësive administrative për vitin 2020”, i ndryshuar me VKB nr. 34, datë 18.05.2020/31.01.2022, VKB nr. 30, datë 18.05.2022, VKB nr. 99, datë 22.12.2022, me numër 160 punonjës për muajin Janar deri ne muajin Maj 2022, 162 punonjës në muajin Qershor deri ne muajin Shtator 2022, 163 punonjës Shtator deri ne Nentor 2022, 169 punonjës muaji Dhjetor 2022. Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës Nëpunës Civil	Realizimi/Numër punonjës Nëpunës Civilë	Diferenca	Plani/Numër punonjës Kod Pune	Realizimi/Numër punonjës Kod Pune	Diferenca
2022	Janar	91	79	12	69	60	9
2022	Shkurt	91	79	12	69	61	8
2022	Mars	91	81	10	69	60	9
2022	Prill	91	81	10	69	62	7
2022	Maj	91	82	9	71	63	8
2022	Qershor	91	82	9	71	63	8
2022	Korrik	91	81	10	71	65	6
2022	Gusht	91	79	12	71	63	8
2022	Shtator	92	80	12	71	64	7
2022	Tetor	92	77	15	71	65	6
2022	Nëntor	92	80	12	71	64	7
2022	Dhjetor	93	82	11	76	73	13

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 88.2% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 82.6%. Në total realizimi i strukturës është në masën 85.4%.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

3. Z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues.
4. Znj. R. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Procesi i inventarizimit

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2022 Për vitin 2022 nga Bashkia Berat është realizuar procesi i inventarizimit për aparatit dhe njësitë shpenzuese si më poshtë:

-Aparati i Bashkisë Berat:

Me Urdhrin nr. 6475, datë 12.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Berat z. E. D. është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2022 i përbërë nga znj. A. Zh., z. B. A., znj. S. K., znj. M. M., znj. A. A. dhe komisioni i vlerësimit znj. R. Sh., z. K. I., z. J. D., z. A. B., znj. E. T., znj. J. P. dhe znj. V. K.. Me relacionin me nr. 6751, datë 28.12.2022 është realizuar procesi i inventarizimit relacion i miratuar nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë.

-Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”:

Me Urdhrin nr. 69, datë 01.12.2022, të Drejtorit të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani” z. A. Q. për ngritjen e komisionit të inventarit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2022 i përbërë nga znj. M. K., z. A. M., znj. A. Q., z. L. H. dhe znj. A. G.. Me shkresën nr. 150/3 prot., datë 31.12.2022, komisioni i sipërpërmendur ka mbajtur relacionin mbi rezultatet e inventarizimit fizik të aseteve, miratuar nga Drejtori i Qendrës z. A. Q.. Me shkresën nr. 150/4 prot., datë 31.12.2023, është paraqitur para Këshillit Bashkiak rezultatet e inventarit për vitin 2022.

-Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit:

Me Urdhrin nr. 48, datë 02.12.2022, të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit z. A. Sh. është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2022 i përbërë nga znj. M. M., z. Xh. Ç., znj. A. K., z. R. M., z. M. Ç. si komisioni i vlerësimit nga znj. Th. H., z. N. Q., znj. D. S., z. E. L. dhe z. L. K.. Me relacionin e datës 31.12.2022, është realizuar procesi i inventarizimit relacion i miratuar nga z. A. Sh. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit.

-Drejtorja e Arsimit:

1. Me Urdhrin nr. 5, datë 05.01.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aseteve në qytetin e Beratit i përbërë nga znj. P. D., znj. M. B. dhe znj. A. T..

2. Me Urdhrin nr. 6, datë 05.01.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. është ngritu komisioni për inventarizimin fizik të aseteve në Njësitë Administrative të Beratit i përbërë nga znj. A. Sh., znj. E. H. dhe z. M. H..
 3. Me Urdhrin nr. 85, datë 08.09.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për inventarizimin fizik të aseteve në qytetin e Beratit znj. P. D., znj. A. Q. dhe znj. A. T..
 4. Me Urdhrin nr. 123, datë 28.09.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për inventarizimin fizik të aseteve një njësitë administrative Berat i përbërë znj. A. Sh., znj. H. .B. dhe z. M. H..
 5. Me Urdhrin nr. 125, datë 05.10.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për inventarizimin fizik të aseteve në njësitë administrative znj. A. Sh., znj. B. M. dhe z. M. H..
 6. Me Urdhrin nr. 8, datë 05.01.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara nga dakja nga përdorimi i përbërë nga znj. B. L., z. A. M. dhe z. M. H..
 7. Me Urdhrin nr. 86, datë 08.09.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për zëvendësimin e anëtarit për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi i përbërë nga znj. E. M., z. A. M. dhe z. M. H..
 8. Me Urdhrin nr. 127, datë 05.10.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për zëvendësimin e anëtarit për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi i përbërë nga znj. E. M., znj. B. K. dhe z. M. H..
 9. Me Urdhrin nr. 7, datë 05.01.2022, të Drejtorit të Arsimit znj. K. H. për zëvendësimin e një prej anëtarëve të komisionit për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit i përbërë nga znj. M. M., z. A. G., z. K. H. K., z. A. B. dhe znj. A. T..
- Me procesverbalin e datës 23.02.2023, i mbajtur nga komisioni i asgjësimit të aktiveve i përbërë nga znj. M. M., z. A. G., z. H. K., znj. A. B. dhe znj. A. T. kanë mbajtur procesverbalin për asgjësimin e aktiveve të llogarisë 214 në vlerën 4,481,422 lekë, llogarisë 218 në vlerën 718,875 lekë dhe llogarisë 327 në vlerën 1,716,204 lekë. Bashkëlidhur ndodhen edhe fotografitë përkatëse të asgjësimit në vend depozitimin.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procesin e asgjësimit të aktiveve.

Situata: 1. Me Urdhrin nr. 20, datë 17.11.2022, të Drejtorit të Qendrës Lira znj. A. K. për ngritjen e komisionit të inventarit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2022 i përbërë nga znj. L. B., znj. F. C., znj. A. K., znj. M. M. dhe znj. Zh. D.. Nga komisioni i sipërmendur me shkresën nr. 286 prot., datë 28.12.2022, është mbajtur procesverbali mbi listën e aktiveve të identifikuara për vlerësim (bashkëlidhur procesverbalit ndodhet lista e aktiveve për vlerësim). Me Urdhrin nr. 22, datë 09.12.2022, të Drejtorit të Qendrës Lira znj. A. K. është ngritur komisioni për caktimin e anëtarëve të komisionit për nxjerrjen nga përdorimi të inventarëve për vitin 2022 i përbërë nga znj. M. T., z. J. Z., znj. K. K., znj. N. M. dhe znj. M. B.. Me shkresën nr. 74 prot., datë 20.02.2023, komisioni për asgjësimin e aktiveve ka mbajtur procesverbalin mbi asgjësimin e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 403,044 lekë ku citohet se: “Materialet e mëposhtëme: veshmbathje, bluza me mëngje të gjata, të shkurtra, kanatjere, të brendshme, tuta, corape, shapka, atlete, çarçaf, batanije, shtupa larje etj.,. Po kështu dhe materialet e guzhinës, pjata, tepsi alumini, garuzhde, lug, pironj, tenxhere, petrogaz etj., ju ndryshua forma duke u thyer dhe groposur. Materialet e tjera të lavanderisë legena, kulluese, litroshe, kosh rrobash, kosh plehrash, kosh robash, fshesa etj., iu ndryshua forma duke u thyer

dhe groposur. Skeleti i minibarit të xhamit, lyster me ngjyrë të zezë u gjykua nga komisioni se nuk mund të përdoret për ngrohje dhe nuk ka asnjë vlerë tjetër përdorimi, prandaj u copëtua u hodh në vend depozitimin e mbeturinave”. Nga sa më sipër konstatohet se nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. M. T., z. J. Z., znj. K. K., znj. N. M. dhe znj. M. B. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të asgjësimit të aktiveve. Me shkresën nr. 105 prot., datë 30.03.2023, është paraqitur para Këshillit Bashkiak rezultatet e inventarit për vitin 2022.

2. Me Urdhrin nr. 176, datë 25.11.2022, të Agjencisë së Shërbimeve Publike z. B. Ç. për ngritjen e komisionit të inventarit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2022 i përbërë nga znj. V. P., z. R. S., z. D. L., z. K. K. dhe z. Gj. L. si dhe komisioni i vlerësimit të aktiveve znj. K. S., z. F. D., z. Dh. F., z. E. V. dhe z. E. M..

Me shkresën nr. 820 prot., datë 15.12.2022, nga komisioni i vlerësimit ka mbajtur procesverbalin mbi propozimin për xjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit në vlerën 1,324,504 lekë. Me shkresën nr. 820/3 prot., datë 30.12.2022, komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i përbërë nga z. A. M., z. P. Xh. z. H. Ç., z. A. Sh. dhe z. Y. Zh. ka mbajtur procesverbalin për aktivet e propozuara nga komisioni i vlerësimit ku citohet se: “Materialet u morën nga magazina me anë të kamionit dhe u groposën me fardroma në vendin e caktuar nga fuhsa e Osunit. Kurse materialet e tjera u ngarkuan me kamion dhe u hodhën pranë venddepozitimit të mbetjeve e cila ndodhet vetëm 100 m larg lumit Osum dhe shumë pranë shkollës jo-publik “I. N.” ku u dogjën”. Nga sa më sipër konstatohet se nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Konkretisht nuk dokumentohet mënyra e dorëzimit të aktiveve në vend depozitim. **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. A. M., z. P. Xh., z. H. Ç., z. A. Sh. dhe z. Y. Zh. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit. Me shkresën pa data dhe pa numër protokollit është paraqitur para Këshillit Bashkiak rezultatet e inventarit për vitin 2022.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nëni 19, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 122.

Ndikimi: Ndikimi negativ në përmirësimin e cilësisë së performancës mjedisore. Mos plotësim me dokumentacion të plotë të procesit të asgjësimit.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet përkatëse të KB.

Në zbatim të drejtitimit 4, të programit të auditimit nr. 208/1 Prot, datë 10.03.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
- 2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.
- 3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Berat, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëveçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Berat, në disa rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, i ndryshuar.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Berat (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr. i procedurave	Vl. Fond limit në lekë	Vl. Kontrate në lekë
Gjithsej	18	636,887,307	605,729,973
E hapur	9	595;048;265	568,016,307
E hapur e thjeshtuar	9	41,839,042	37,713,666

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Berat

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2022-31.12.2022, Bashkia Berat ka realizuar **48** procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit në shumën **655,799,186** lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **621,554,054** lekë nga të cilat:

Për vitin 2022 janë realizuar 18 procedura me fond limit në shumën **636,887,307** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **605,729,973** lekë pa TVSH ose 95% e fondit limit.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 40 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **18,911,878** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **15,824,081** lekë. Nga këto, për vitin 2022 në njësinë e varësisë Drejtoria e shërbimeve Publike janë realizuar 2

procedura me fond limit në shumën **63,545,730** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **61,568,750** lekë.

(*Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar paraqitet aneksi nr. 1, pika 4, “Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”*).

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Më poshtë trajtohen disa nga procedurat e prokurimit të audituara në Bashkia Berat, e konkretisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindërtim i shkollës së mesme babë dudë karbunara Berat”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “tender i hapur” REF- REF-40117-08-29-2022 Urdhri nr. 26 / 4157 prot dt 23.08.2022	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Ark: L. B. N/ kryetar, Ark: E. S. specialist projektimi dhe regjistrin elektronik Ark. Rest.: A. S., Inxhinier: R. V. specialiste e sistemit G., Ing.Hidro: M. M., Ing.Gjeodet: A. Dh. Specialist kadastrë Ing.Gjeodet: D. Z. specialist topograf Ing.Elektrik: F. N. Ing.Elektrik: E. R.	2 Njësia e Prokurimit 1.F. A. specialiste prokurimesh juriste 2.A. Zh. specialiste prokurimesh ekonomiste 3.M. S. pergjegjese e sektorit te menaxhimit te pronave dhe strehimit ing ndertimi (specialist fushes)	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri Nr.27/4157/1 prot dt 23.08.2022. 1.L. B. N/Kryetar, arkitekt 2.E. M. specialiste prokurimesh ekonomiste 3. P. S. Drejtor i drejtorise juridikie (jurist)
4. Fondi Limit (pa tvsh) 364,405,618 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: “BOE B. ShPK & L. ShPK & A. ShPK” me vlerë 361,264,273 lekë pa tvsh.	6. Diferenca me fondin limit. 3,141,345 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data . 9/14/2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit. + buxheti bashkise	9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 OE b) S’kualifikuar 3 B/OE , c) Kualifikuar 1 B/OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; ska APP-s’ka/ka; ka KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.5013 prot dt 06.10.2022	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KPP: 1.njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit nr. 4157/4 dt 02.09.2022 2. njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit nr. 4157/5 dt 06.09.2022 3. njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit nr. 4157/6dt 07.09.2022	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngarkuar Drejtoria e planifikimit urban, lejeve dhe monitorimit te investimeve si dhe specialist te

jashtem per hartimin e projektit, preventivit, raportit teknik,specifikimeve teknike, grafik si me poshte:

Projekti Arkitektonik pergatitur nga grupi i punes si me poshte: Arkitekt L. B. Arkitekt Gj. D. Inxhinier V. Z. Ing.Hidro F. T. Ing.Gjeodet A. Dh. Ing.Elektrik F. N. Ing.Elektrik E. R..

Projekt Elektrik pergatitur nga grupi i punes si me poshte: Arkitekt L. B., arkitekt E. S., ark. Rest. A. S., inxhinier R. V., ing. Hidro M. M., Gjeodet D. Z., ing. Gjeodet A. Dh., Ing.Elektrik F. N., ing.Elektrik E. R. Ing.Elektrik A. C..

Relacion Teknik pergatitur nga grupi i punes si me poshte: Ing. F. N. Ing.E. R. Ing.A. C..

Relacion H... pergatitur nga grupi i punes si me poshte: Ark: L. B. Ark: E. S.Ark. Rest.: A. S. Inxhinier: R. V. Ing.Hidro: M. M. Ing.Gjeodet: A. Dh. Ing.Gjeodet: D. Z. Ing.Elektrik: F. N. Ing.Elektrik: E. R.

Relacion Teknik Relacion i mbrojtjes nga zjarri pergatitur nga grupi i punes si me poshte: Ark: L. B. Ark: Gj. D. Inxhinier: V. Z. Ing.Hidro: F. T. Ing.Gjeodet: A. Dh. Ing.Elektrik: F. N. Ing.Elektrik: E. R. Ing.Elektrik: A. C. Inxhinier: L. N.

Specifikime Teknike, Relacion, pergatitur nga grupi i punes si me poshte Ark: L. B. Ark: E. S. Ark. Rest.: A. S. Inxhinier: O. V. Ing.Hidro: M. M. Ing.Gjeodet: A. Dh. Ing.Gjeodet: D. Z. Ing.Elektrik: F. N. Ing.Elektrik: E. R..

RAPORTI TEKNIK pergatitur nga Ing. M. H.

Preventig dhe grafik punimesh punuar nga Arkitekt L. B..

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krihereve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat” me fond limit 364,405,618 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 361,264,273 lekë pa TVSh me në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE ku është shpallur fitues “BOE B. ShPK & L. ShPK & A. ShPK”, konstatohet se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i perbere nga F. A. specialiste prokurimesh juriste, A. Zh. specialiste prokurimesh ekonomiste specialisti i fushes M. S. me pozicion pune pergjegjese e sektorit te menaxhimit te pronave dhe strehimit, me profesion ing ndertimi të cilat janë evidentuar në procesverbalin nr. 4157 /3 prot date 29.08.2022, nga të cilat disa prej tyre nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik, konkretisht si më poshtë;

Kriteret e veçanta sipas procesverbalit dhe DST-ve

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P - 2 C** Ndërtime civile e industriale;
- **N.P - 12 A** Punime te inxhinierise se mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S.-1 A** Punime per prishjen e ndertimeve

- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 3 A** Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues)
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S - 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;
- **N.S - 9 C** Punime strukturore speciale
- **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 13 A** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- **NS - 18 A** Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

2.3.2/b Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kultures.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Duke qene se Berati eshte qytet muze, zona në të cilën do të kryhet investimi është zona e qendrës së qytetit ku zhvillohet pjesa më e madhe e jetës administrative, sociale e kulturore e qytetit dhe e gjithë bashkisë Berat, për të ndjekur dhe mbikëqyrur të gjithë elementet e trashëgimisë kulturore, operatori duhet të paraqes licencën profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga Ministria e Kultures.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (Nje)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndryshme të fasadës, sipas parashikimeve në projekt.
 - **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për zërat e punimeve të gjelberimit dhe të tjera, mbrojtja e ambjentit, transporti i materialeve, pastrimi përfundimtar i zones dhe rakordimin me ekspertin e VNM-se.
- b) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për këtë këtu operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratën e punës;
- diplomën dhe
- çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës e) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Me anë të këtij kriteri synohet mbrojtja e mjedisit, përmes vlerësimit hap pas hapi të ndikimeve në mjedis, të punimeve për realizimin e projektit objekt prokurimi.

VNM për këtë projekt është bere ne fazen e projektimit, por operatori ekonomik duhet te kete te punesuar nje ekspert per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i cili do te beje te mundur plotesimin dhe respektimin me korrektese te te gjithë kerkesave dhe rregullave te percaktuara ne VNM, per te minimizuar ndikimin ne mjedis nga zbatimi i punimeve per kete objekt, pasi objekti shtrihet ne qender te qytetit, buze pedonales, e cila do te jete aksesueshme gjate fazes se ndertimit te objektit. Eksperti i VNM-se do beje rakordimin e punimeve me ing.e mjedisit.

g. Operatori ekonomikë duhet të ketë të punësuar 1 (nje) Inxhinier Drejtues Teknik – Auditues energjistik I Certifikuar me titull: Auditues Energjistik ne Ndertesa dhe instalime industriale.

Per inxhinierin auditues energjistik duhet te kete keto dokumenta provues:

- Kontrata noteriale e punes (e vlefshme per te paktën periudhen e parashikuar te ndertimit),
- Certifikata per audituesin energjistik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” ku parashikohet se:

“2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës g) është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

- çdo herë, **përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”.**

“Përsa i përket fazës së zbatimit, prezenca e Audituesit të energjisë bëhet e panevojshme në rastet kur raporti paraprak i efikasitetit të energjisë është hartuar në fazën e projektimit. Nëse kjo nuk ka ndodhur atëherë bëhet e nevojshme prezenca e Audituesit të Energjisë në fazën e zbatimit”.

Për objektin konkret, në fazën e projektimit nuk është hartuar raporti paraprak i efikasitetit të energjisë dhe rrjedhimisht është i domosdoshëm Audituesi i Energjisë në fazën e zbatimit.

Gjithashtu, sikurse është cilesuar dhe në përmbajtjen e këtij kriteri, Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë

dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 14001-2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- **ISO 50001:2011** – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Energjise

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 14001:2015 ofron nne kuader praktik per shoqerite qe duan te menaxhojne rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtesisht ne strukturen e menaxhimit te biznesit per te kontrolluar impaktet qe aktivitetet, operacionet, produktet dhe sherbimet kane mbi mjedisin. AK gjykon se qdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 14001:2015 me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana tij (ne rastin konkret realizimi i punes objekt prokurimi) te identifikojte impaktin ne mjedis gjate aktivitetit te saj si dhe te permiresoje performancen mjedisore duke zbatuar nje qasje sistematike. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ushtrojne veprimtarine duke pasur ne konsiderate parimin e mbrojtjes se mjedisit.

ISO 50001-2011 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i menaxhimit të Energjisë, është e nevojshme pasi një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të energjise, pra, kur nevojat për energji janë gjithnjë në rritje, përdorimi efikas i energjisë në bazë të sistemit për menaxhimin e energjisë, AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove.

Standarti ISO 3834-2 certifikata e cilesise per saldim, kerkohet me qellim te percaktimit te kerkesave te arsyeshme te cilesise per realizuesit e punimeve te saldimit dhe ata qe merren me prodhimin e produkteve me metoden e shkrirjes me saldim. Standardi EN ISO 3834-2 ka te beje me burimin dhe cilesine e produktit qe mund te rrjedh nga burimi dhe operimet e nderlidhura. Nevoja per rregullat themelore ne ndermarrje, si dhe kerkesat per cilesi te saldimit.

Ka disa ndryshime me rekomandime të APP-së apo ndryshime të tjera si ishte dhe si është bërë për atë kriter i cili është ndryshuar.

I.1 Me shkresen njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit me nr. 4157/4 dt 02.09.2022 jane bere keto ndryshime Në lidhje me nje sqarim ne preventivin e ngarkuar ne sistem dhe grafikun e punimeve, Preventive dhe grafiku i sakte do te ngarkohen ne sistem:

2. Me shkresen njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit me nr. 4157/5 dt 06.09.2022 jane bere keto ndryshime.

I.2 Në lidhje me Në lidhje me ndryshimet e dokumnetave standarte të tenderit po i paraqesim me poshte:

1. Në pikën 2.3.3, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar

h. Operatori ekonomikë duhet të ketë të punësuar 1 (nje) Inxhinier Drejtues Teknik, Auditues energjitik i Certifikuar me titull: Auditues Energjitik ne Ndertesa dhe instalime industriale.

Per inxhinierin auditues energjistik duhet te kete keto dokumenta provues:

- Kontrata noteriale e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit),
- Certifikata per audituesin energjistik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

➤ **Ky kriter ndryshon si me poshte:**

Operatori ekonomikë duhet të ketë të kontraktuar 1 (nje) Inxhinier/ punonjes, Auditues energjistik i Certifikuar me titull: Auditues Energjistik ne Ndertesa dhe instalime industriale. *Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar.*

Per inxhinierin auditues energjistik duhet te kete keto dokumenta provues:

- Kontrata noteriale (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit),
- Certifikata per audituesin energjistik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

2. Në pikën 2.3.5, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*

OHSAS 18001-2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose ISO 45001-2018, *ose ekuivalentet e tyre.*

ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*

PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), *ose ekuivalent*

ISO 50001:2011 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Energjise

ISO 3834-2:2006 – Standard per Kerkesat e Cilesise per Saldimin e Materialeve Metalike

➤ **Ky kriter ndryshon si me poshte:**

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent,*

ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, *ose ekuivalentet,*

ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent,*

ISO 50001:2011 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Energjise,

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

3. Në pikën 2.3.2, gërma b, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kultures”.

➤ **Ky kriter ndryshon si me poshte:**

Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, N-Z/A/6 të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kultures. **Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar.**

Konkluzion i grupit të auditimit:

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, edhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK nuk janë kryer ndryshimet të kritereve dhe argumentimi i tyre, specififikimet teknike nuk rezultojnë të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish. Konkretisht është kërkuar

arkitekt, ndërkohë që projekti është i përfunduar, kërkohet inxhier mjedisi ndërkohë që ky investim është Rindërtim i shkollës në të njëjtin vend që ka qënë objekt ekzistues, auditues energjie që nuk ka lidhje me objektin e kontratës së prokuruar dhe preventivit të punimeve, certifikata të cilat përveç se nuk janë të argumentuara nuk lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, licencë nga Ministria e Kulturës kur nuk është objekt kulture. Këto kërkesa mund të ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Veprime e mosveprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E. D., zj. F. A., zj. A. Zh., zj. M. S. si hartuesit e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike z. L. B., z. E. S., z. A. S., zj. O. V., z. M. M., z. A. Dh., z. D. Z., z. F. N. dhe zj. E. R..

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se;

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Nenin 43, pika 5, në të cilën citohet se:

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritjet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës, caktimin e zyrtarëve të KVO dhe vlerësimin e ofertave.

Titulli i Gjetjes: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e specifikimeve teknike ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Situata: Referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat”, në të cilën me urdhrin nr.27/4157/1 prot dt 23.08.2022, të titullarit të AK z. E. D. është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje z.L. B. N/Kryetar, arkitekt, zj.E. M. specialiste prokurimesh ekonomiste dhe z.P. S. Drejtor i drejtorisë juridikie (jurist), konstatohet se një nga anëtarët e komisionit ka marrë pjesë edhe në “llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike”. Konkretisht z. L. B. si anëtar i hartimit të preventivit të kontratës dhe specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit) në të njëjtën kohë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. LPP nuk vendos kufizime për sa i përket anëtarëve të komisionit të “llogaritjes së fondit limit” por në rastin konkret i njëjti komision është përgjegjës edhe për hartimin e specifikimeve teknike të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, neni 78 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Në lidhje me këtë situatë, vlen të theksohet se, referuar nenit 75, pika 2 të VKM-së së sipërcituar, personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo situatë është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm për të cilin është lënë rekomandimi përkatës. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z.E. D..*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2/dh, në të cilin citohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73 pika 3, në të cilin citohet se:

Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

neni 75 pika 2, dhe Neni 78 pika 2, në të cilin citohet se:

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm,

bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Ndikimi: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në Njësinë e Prokurimit ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave përbën “konflikt interesi” në kuptimin e LPP-së si dhe çënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit.

Shkaku: Interpretim dhe zbatim i gabuar i LPP-së dhe akteve nënligjore nga ana e personit/punonjësit përgjegjës për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Personi përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4157/10, të datës 19.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	BOE B. ShPK NIPT J..... & L. ShPK K.... & A.... ShPK L.....	361,264,273	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	SH. – NIPT K....	362,245,507	S’kualifikuar; Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konform kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Për këtë arsye komisioni vendos skualifikimin e këtij operatori ekonomik, konkretisht mungojnë: 1.Ne piken 2.3.2/a operatori nuk ka kategorine N.S – 9 C Punime strukturore speciale. 2.Operatori nuk ploteson piken 2.3.2/b të kriterëve teknike pasi nuk ka paraqitur license profesionale të shoqërisë të leshuar nga Ministria e Kulturës. 3.Nuk ploteson piken 2.3.2/c të DST pasi nuk është paraqitur akt miratimi i lejes mjedisore. 4.Nuk ploteson shtojcën 3 sigurimin e ofertes 5.Nuk ploteson piken 2.3.1 përvojë për punë të ngjashme pasi operatori në vlerën e paraqitur për punë të ngjashme brenda 5 viteve është me e vogël se dyfishi i fondit. 6.Nuk ploteson piken 2.3.3/a të dst konkretisht: 7.Nuk ka vetedeklaruar Ing. Mekanik, Ing.Elektrik dhe Ing.Elektronik 8.Ing.Ndërtimi Ll. L. dhe A. K. nuk figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë. 9.Ne shtojcën 8 operatori ekonomik nuk ka vetedeklaruar stafin e kualifikuar dhe punonjësit për përdorimin e makinerive të renda. 10.Nuk ploteson piken 2.3.3/g pasi nuk ka vetedeklaruar një punonjës me certificate auditues energjie. 11.Ne shtojcën 8 deklaratatë e mjeteve operatori nuk ka vetedeklaruar 1 eskavator për demolim krehe gjatë min 20 m, 1 pince për demolim, 2 eskavator me goma, 5 depozita uji me kapacitet min 3000l.
3	F. – NIPT K.....	363,463,698	S’kualifikuar;

			<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga ky operator ekonomik ne sistem, komisioni i vlerësimit te ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konform kerkesave te dokumentave standarte te tenderit. Për këtë arsye komisioni vendos skualifikimin e këtij operatori ekonomik, konkretisht mungojne:</p> <p>Ne piken 2.3.2/a operatori nuk ka kategorine N.S – 9 C Punime strukturore special.</p> <p>Operatori nuk ploteson piken 2.3.2/b te kriterëve teknike pasi nuk ka paraqitur license profesionale te shoqerise te leshuar nga Ministria e Kultures.</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.2/c te DST pasi nuk ka paraqitur leje mjedisore me kodin III.2.B dhe akt miratimi i lejes mjedisore.</p> <p>Nuk ploteson shtojcën 3 sigurimin e ofertes</p> <p>Nuk ploteson piken 2.2.1 te kapacitetit ekonomik pasi operatori nuk ploteson xhiron vjetore per vitet financiare 2019,2020 dhe 2021.</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.1 pervoje per pune te ngjashme pasi operatori ne vleren e paraqitur per pune te ngjashme brenda 5 viteve eshte me e vogel se dyfishi i fondit.</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.3/g pasi nuk ka vetdeklaruar nje punonjes me certificate auditues energjie.</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.4 te DST pasi operastori nuk ka vetdekalaruar stafin e teknik dhe numrin e fuqise punetore.</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.3/a te dst kokretisht:</p> <p>Nuk ka vetedeklaruar 1 Arkitektin, 1 Ing.Ndertimi dhe 1 Ing.Elektronik</p> <p>Nuk ploteson piken 2.3.3/b te dst kokretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2 elektrikista 1 hidraulik 1 saldator 1 suvatues 2 hekurthyes 2 bojaxhi 1 buldozerist 4 eskavatorist 1 specialist te inxhinierise elektronike 2 instalues kondiciooneri 3 pergatites te konstruksioneve metalike dhe te ngjashme <p>Mungos ISO 3834-2: 2006</p> <p>Ne shtojcën 8 deklarata e mjeteve operatori nuk ka vetedeklaruar:</p> <p>1 eskavator per demolim krahgjate min 20 m</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 pinc per demolim - 1 eskavator me zinxhir - 1 fadrom me gome - 1 autovinc me gjatesi krahu min 20m - 1 vinc kulle - 1 sonde per shpim pilotash - 5 depozita uji me kap min 3000l - 1 tranxh per perpunim e hekurit - 2000 m2 rrjet plastike - 2000 m2 skeleri <p>dhe material te tjera ndihmese si kokore, prozhektor etj.</p>
--	--	--	---

4	G.. C. NIPT J.....	362,042,607	<p>S'kualifikuar;</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga ky operator ekonomik ne sistem, komisioni i vlerësimit te ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konform kerkesave te dokumentave standarte te tenderit. Për këtë arsye komisioni vendos skualifikimin e këtij operatori ekonomik, konkretisht mungojne:</p> <p>Operatori nuk ploteson piken 2.3.2/b te kriterëve teknike pasi nuk ka paraqitur license profesionale te shoqërisë te leshuar nga Ministria e Kultures.</p> <p>Nuk ploteson shtojcën 3 sigurimin e ofertes.</p> <p>Ne piken 2.3.3/a Ing.mekatronik E. M. nuk figuron en licensen e shoqërisë.</p> <p>Ne shtojcën 8 deklarata e mjeteve operatori nuk ka vetedeklaruar 3 depozita uji me kap min 3000l.</p>
---	---------------------------	-------------	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 29.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 29.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “BOE B. ShPK & L. ShPK & A. ShPK” për të cilën është lidhur kontrata Nr.5013 prot dt 06.10.2022 për vlerën 361,264,273 lekë pa TVSH dhe vlera 433,517,128 lekë me TVSH, dhe me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj/deri më 06.10.2023 / 365 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Ndrëçimi i qytetit Berat” me të dhënat si më poshtë;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “NDRICIMI I QYTETIT BERAT				
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur ” REF- REF-49735-11-14-2022 Urdhri nr. nr 41/5795/1 date 04.011.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit 1. Arkt L. B.	2 Njësia e Prokurimit 1. F. A. jurist 2. A. Zh. ekonomist 3. A. M. specialist fushe	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. nr 40/5795 date 04.011.2023 L. B. E. M. P. S.	
4. Fondi Limit (pa tvsh) 69, 362, 853lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: BOE “B. K. & H..SHPK”: 54, 488, 310 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 14, 874, 543 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 12/7/2022	8. Burimi Financimit kontrate granti nga zvicerianet + buxheti bashkise		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 OE b) S'kualifikuar 1 B/OE , c) Kualifikuar 3 B/OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj				
10.Ankimime AK-s'ka/ka; ska APP-s'ka/ka; ka KPP-s'ka/ka ska	11. Data e lidhjes të kontratës Nr 5795/13 Prot., datë 18.01.2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Njoftimi per ndryshimin e dok te tenderit Nr. 5795/4 prot, dt 25.11.2022	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Titulli i gjetjes: Nuk janë argumentuar specifikimet teknike të vendosura dhe nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit të kontratës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “Ndriçimi i qytetit Berat” me fond limit 69,362,853 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 54,488,310 lekë pa TVSh me në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE, janë kualifikuar 3 OE dhe është s’kualifikuar 1 OE, është shpallur fitues BOE “B. K. & H.. SHPK”, konstatohet se:

Nga titullari i AK z. E. D., është ngarkuar Drejtoria e planifikimit urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve për hartimin e projektit, preventivave, relacioneve teknike dhe specifikimeve teknike. Relacioni teknik dhe specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga arkitekti i Drejtorisë z. L. B.. Këto specifikime teknike nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, pasi, në bazë të këtyre specifikimeve të objektit të prokurimit duhet të bëhet dhe llogaritja e vlerës së kontratës. Me urdhrin e prokurimit nr. 5795/1prot, datë 04.11.2022, miratuar nga titullari i AK, përaktohen të dhënat e procedurës me objektin, fondin limit në vlerën 69,362,853 lekë pa TVSh, llojin e procedurës dhe Njësinë e Prokurimit. Në lidhje me përcaktimin e fondit limit konstatohet se Autoriteti Kontraktor nuk ka ndjekur procedurën e duhur sipas rregullave të prokurimit publik pasi nuk dokumentuar llogaritjen e vlerës së kontratës. Pra si përfundim rrjedhimisht arrihet në konkluzionin se:

-Nuk janë argumentuar specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit, të ngarkuara në sistemin elektronik të prokurimeve. -Nuk dokumentohet llogaritja e vlerës së kontratës. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi titullari i AK Z. E. D., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. F. A., zj. A. Zh. e z. A. M., si dhe hartuesi i specifikimeve teknike z. L. B..*

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me nenin 2, ku citohet se:

Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

me nenin 76, pika 2-3, pasi nuk dokumentohet dhe argumentohet mënyra mbi të cilën është hartuar fondi limit, ku citohet se:

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës dhe nuk janë argumentuar specifikimet teknike.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha specifikimeve teknike të vendosura.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i perber nga zj. F. A. specialiste prokurimesh juriste zj. A. Zh. specialiste prokurimesh ekonomiste z. A. M. specialist i ndricimit publik ASHP ing elektrik (specialist fushes) prane Agjensise se Sherbimeve publike të cilat janë evidentuar në procesverbalin Nr.5795/2 prot te datës 14.11.2022, të cilat në përgjithësi janë hartuar brenda kuadrit ligjor të Prokurimit Publik pasi nuk janë vërejtur problematika në vendosjen e tyre pasi janë bërë dhe ndryshimet përkatëse sipas sugjerimeve të APP-së;

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës, caktimin e zyrtarëve të KVO dhe vlerësimin e ofertave.

Titulli i Gjetjes: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e specifikimeve teknike ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Situata: Referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “*Ndriçimi i qytetit Berat*”, në të cilën me urdhrin nr. 40/5795 datë 04.011.2023, të titullarit të AK z. E. D. është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje z. L. B. N/Kryetar, arkitekt, zj.E. M. specialiste prokurimesh ekonomiste dhe z.P. S. Drejtor i drejtorisë juridike (jurist), konstatohet se një nga anëtarët e komisionit ka marrë pjesë edhe në “*llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike*”. Konkretisht z. L. B. si anëtar i hartimit të preventivit të kontratës dhe specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit) në të njëjtën kohë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. LPP nuk vendos kufizime për sa i përket anëtarëve të komisionit të “*llogaritjes së fondit limit*” por në rastin konkret i njëjti komision është përgjegjës edhe për hartimin e specifikimeve teknike të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, neni 78 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Në lidhje me këtë situatë, vlen të theksohet se, referuar nenit 75, pika 2 të VKM-së së sipërcituar, personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo situatë është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm për të cilin është lënë rekomandimi përkatës. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z.E. D.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2/dh, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73 pika 3, neni 75 pika 2, dhe Neni 78 pika 2.

Ndikimi: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në Njësinë e Prokurimit ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave përbën “*konflikt interesi*” në kuptimin e LPP-së si dhe çënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit.

Shkaku: Interpretim dhe zbatim i gabuar i LPP-së dhe akteve nënligjore nga ana e personit/punonjësit përgjegjës për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Personi përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 5795/7 prot, të datës 13.12.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	BOE B. NIPT K.... & H..SHPK Nipt K.....	54, 488, 310	Kualifikuar

2	M. U. – NIPT L....	-	S'kualifikuar; Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesemarrës nuk është i plotë dhe konform kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të tenderit. Nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër përveç QKB.
3	BOE L. K. NIPT K..... & S. G. K. Nipt K.....	57, 571, 996	Kualifikuar
4	BOE XH.. NIPT J.... & "G." Nipt K.....	63, 845, 580	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr 5795/11 prot më datë 06.01.2022 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 06.01.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE "B. K. & H.. SHPK" për të cilën është lidhur kontrata datë Nr 5795/13 Prot., datë 18.01.2023 për vlerën 54, 488, 310 lekë pa TVSH dhe vlera 65, 385, 972 lekë me TVSH, dhe me afat 8 (tete) muaj/deri më 18.09.2023 / 8 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

3. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje asfalti" me të dhënat si më poshtë;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "blerje asfalti".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "procedure e hapur Urdhri nr. 06 prot 293., datë 29.03.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 307 prot, datë 04.04.2022 2. A. Dh.	2 Njësia e Prokurimit 1. E. S. 2. V. P. 3. A. Dh.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 68 prot 380/2., datë 17.05.2022. 1. R. S. 2. F. D. 3. A. Zh.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 38,545,730 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: Sh. shpk 37,357,000 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 1.188.730 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 08.06.2022 ora 13.	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit, Agjencia e shërbimeve Publike		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, b. dhe sh. shpk OE b) S'kualifikuar B.N OE , c) Kualifikuar S. shpk OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: nga dt 05.07.2022 deri me dt 30.10.2022			
10.Ankimime AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 497/1 prot., datë 04.07.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit" :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike, njësi në varësi të Bashkisë Berat, z. B. Ç., është ngritur një komision me urdhrin nr. 54 dhe nr. 292 prot datë 28.03.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. Dh. F., z. P. Xh. e z. K. A..

Sipas procesverbalit të datës 28.03.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “*percaktimit të cmimit sipa manualit teknik*”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit vlerën prej 38.545.730 lekë pa tvsh.

Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike është perpiluar, nenshkruar nga specialisti i fushës z. A. Dh. dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga Njësia e Prokurimit e përbere nga z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje Asfalti*”, me fond limit në shumën 38,545,730 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 37,357,000 lekë pa tvsh u konstatua se: Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit e përbere nga z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh., të cilat janë hartuar me shkresën nr. 380 prot, datë 17.05.2022. Në kriteret e miratuara rezultojnë se disa prej tyre nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik, konkretisht si më poshtë;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.4.6 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 8 (tetë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe,
- minimalisht 1 (nje) eskavatorë,
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektikëtij prokurimi.

Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuar sipas legjislacionit në fusqi të rrezikshme (*Autobitumatriçe*) duhet të paraqesin certificate për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe faturatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë çdo kohë nga momenti i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruara si më sipër.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77, pika 4, ligji nr.162, datë 23.12.2021 në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne rastin konkret janë kërkuar:

- minimalisht 8 (tetë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe,
- minimalisht 1 (nje) eskavatorë,
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep”.

Në referim të:

- llojit të materialit,
- procesit teknik të furnizimit,
- sasise të kërkuar,
- afatit të kërkuar, si dhe mundësi teknike të vendosjes në veper.

Sa më sipër kemi të bëjmë me kritere minimale për plotësimin dhe realizimin e kontratës sipas përcaktimeve dhe qëllimit të saj.

Nr.	Emertimi i mallit	njesia	sasia	Korrik 2022	Shtator 2022	Tetor 2022
1	bitum m- 3 leng	kg	18772.5	7422.5	7000	4350
2	binder	ton	2250	750	750	750
3	asfaltobeton guri kave	ton	1433	500	433	500
5	stabilizant (tampon)	m3	275	100	100	75

Sa më sipër është marrë parasysh sasitë e kërkuara, si procesit teknik të furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk janë mallra që mund të magazinohen, si dhe nuk janë mallra që mund të rrinë në gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder, asfaltobeton), por menjëherë pas procesit të prodhimit ngakohen në mjete, dhe dërgohen në vendin e vendosjes në veper.

Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **...përzierja e prodhuar (binder, asfaltobeton) duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit. Sa më sipër llogaritja është mbështetur dhe me mundësi autoritetit kontraktor për vendosjen në veper, në sinkronizim me prodhim-furnizim të mallrave binder, asfaltobeton).**

2.4.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i

vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

1. ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose **ekuivalente të tij**.

2. ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose **ekuivalente të tij**.

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. *Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, nenin 79 të LPP, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë kërkuar këto certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sistemi i menaxhimit mjedisor. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) i përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallrat që plotësojnë kërkesat e sandarteve të cilësisë.*

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në perputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në perputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Argumentimi i kriterëve teknike në lidhje me pajisjet, makineritë, punonjësit dhe profilet e tyre të punës janë mirë argumentuar nga specialisti fushës pjesë e njësisë së prokurimit Ing.A.Dh.

Nga APP është me shkresën nr. 391, datë 20.05.2022, dërguar nëpërmjet komunikimit me email sugjeruar ndryshimi i kriterëve të kualifikimit të cilat janë ndryshuar si më poshtë:

2.4.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:

-1 (nje) Eskavatoristë/Makinistë/Manovratorë,

-6(gjashtë) Shoferë për kamiona (kategoria C minimale),

Për të cilët, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton kapacitetin të profesional stafin, personelin e nevojshëm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e funizimit me mallrat e kerkuara për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), etj janë vendosur për*

arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me furnizimin e mallrave që kerkohen të realizohen të cilat janë ndertimore, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.4.6 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 6 (gjashtë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektikëtij prokurimi.

Per mjetet e transportit per mallrat te klasifikuar sipas legjislacionit ne fusqi te rrezikshme (*Autobitumatriçe*) duhet te paraqesin certificate per transport mallrash te rrezikshem leshuar nga institucionet perkatese(e vlefshme).

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe faturatatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me **qëllim verifikimi** nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga moment i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar si më sipër. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentimi:ky kriter u vendos ne perputhje me neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne rastin konkret janë kërkuar :

-minimalisht **6 (gjashë)** kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,

- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe

- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep”.

Ne referim te:

- llojit te materialit,
- procesit teknik te furnizimit,
- sasise se kerkuar,
- afatit te kerkuar, si dhe mundesise teknike te vendosjes ne veper.

Preventivi i kërkesave për blerje mallrash jepet si më poshtë:

nr	Emertimi i mallit	njesia	sasia	qershor 2022	korrik 2022	shtator 2022
1	bitum m- 3 leng	kg	18772.5	7422.5	7000	4350
2	binder	ton	2250	750	750	750
3	asfaltobeton guri kave	ton	1433	500	433	500
5	stabilizant (tampon)	m3	275	100	100	75

Preventivi eshte marre parasysh nga sasite e kerkuara, si procesit teknik te furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk jane mallra qe mund te magazinohen, si dhe nuk jane mallra qe mund te rrine ne gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder, asfaltobeton), por menjehere pas procesit te prodhimit ngakohen ne mjet, dhe dergohen ne vendin e vendosjes ne veper.

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, kjo procedurë prokurimi është blerje mallrash, dhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK janë kryer ndryshimet të kriterëve dhe nuk rezultojnë të jenë të argumentuara teknikiisht dhe ligjërisht dhe në përputhje me objektin e kontratës. Kërkesa këto të cilat mund të ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Veprime e mosveprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E. D., z. B. Ç., dhe anëtarët e NjP z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh..

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, nenin 43, pika 5, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 457, të datës 17.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	SH.	37,357,000	Kualifikuar
2	B.	35, 410, 818	<p>S'kualifikuar;</p> <p>1. (B. sh.p.k me nipt: K.... dhe me vlere te ofruar 35,410,818 (tridhjetë e pese milione e e katerqinde e dhjetë mije e teteqinde e tetembedhjetë) leke pa tvsh.</p> <p>A. <i>Ne dokumentat standarte te tenderit te kapaciteti teknik thuhet se:</i> për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. <i>Furnizimet e ngjashme qe operatori ka paraqitur, sipsa objektit te prokurimit nuk e arrijne 40% e fondit limit te procedures.</i> Kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik jane te profilit pune dhe jo mall sipas kerkesave te dokumentave standarte te tenderit(procedure e prokurimit është blerje malli). Faturat e paraqitura me sektorin privat jane te profilit pune dhe furnizimet nuk kapin vleren e parashikuar si dhe nuk jane te perfshire te gjith zerat sipas preventivit te publikuar ne DST.</p> <p>B. Ne DST te kapacitetit teknik eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te kete ne dispozicion mjetet e nevojshme per ekzekutimin e kontrates.</p> <p><i>Ne mjetet e paraqitura ne vetedeklarim dhe dokumentaqcionit te paraqitur nga operatori ka mangesi perkatesisht te:</i> Autobitumatricja me targa AB... certifikata e mjetit bie ne kundershtrim me ligjin nr 8308, date 18.03.1998. “Per transportet rrugor”, neni 1, 3, 5 dhe KREU III.1, “Transporti i mallrave me qira dhe per te trete”, neni 41, 42, 43 dhe 44 si edhe KREU III.2 “ Transporti i mallrave per vete”, nenet 45, 46 dhe 47, behet qartesishte ndarja midis ketyre menyrave te transportit dhe percaktohet ndalimi i seciles nga menytrat e transportit pa pajisjen me licencen perkatese .</p> <p>Ne rastin konkrete nepermjet dokumentacionit te dorezuar vertetohet se certifikatat e mjeteve te mesiperme te cilat disponohen nga personat sipas lejeve te qarkullimit, eshte specifike dhe e leshuar vetem per transport per vete, per kryerjen e transportit te mallrave me kamjon vetem per llogari te vepritarise se tyre.Ne kete menyre kryerja e transportit te mallrave nga ana e subjektit B. shpk do te jete ne kushtet e kryerjes se transportit te mallrave me qira dhe per te trete pa licencen perkatese, transport i cili ne zbatim te nenit 41 te ligjit “Per transportet rrugor” eshte i ndaluar.</p> <p>- Mjeti me traga AA... te cilit i ka skaduar certifikata e transportit.</p> <p>-Mjeti me targa AB..... vertetimi per taksat dhe certifikata e transportit eshte paraqitur per nje mjet tjetër ne kundershtrim me ligjin nr. 8308, date 18.03.1998. “Per transportet rrugor”, neni</p>

			1, 3, 5 dhe KREU III.1, “Transporti i mallrave me qira dhe per te trete”, neni 41, 42, 43 dhe 44 si edhe KREU III.2 “ Transporti i mallrave per vete”, nenet 45, 46 dhe 47, behet qartesishte ndarja midis ketyre menyrave te transportit dhe percaktohet ndalimi i seciles nga menytrat e transportit pa pajisjen me licencen perkatese.
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 30.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE “Sh. SHPK”. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 30.06.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “Sh. SHPK” i cili plotëson dokumentacionin e kërkuar nga AK, me të cilin është lidhur kontrata datë 04.07.2022 për vlerën 37.357.000 lekë pa TVSH dhe vlera 44.828.400 lekë me TVSH, dhe me afat 04.07.2022 deri me dt 30.10 2022 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje asfalti” me të dhënat si më poshtë;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje asfalti”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e hapur” REF-41318-09-12-2022 Urdhri nr. 19 prot., 619 datë 07.09.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit A. Dh. 1.2 D. F., K. A., P. Xh. Urdhri nr. 135, datë 26.08.2022	2 Njësia e Prokurimit 1. E. S. 2. V. P. 3. A. Dh.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 632/2 prot., datë 12.09.2022. 1. R.S. 2. F. D. 3. A. Zh.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 24,999,990 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 24,211,750 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 788.240 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 03.10.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit. Agjencia e Sherbimeve Publike		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar A. OE, c) Kualifikuar Sh. sh.p.k OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj			
10.Ankimime AK- ka APP-s’ka; KPP-ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.32 prot., datë 17.01.2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga Drejtori i Agjencisë së Sherbimeve Publike, njësi në varësi të Bashkisë Berat, z. B. Ç., është ngritur një komision me urdhrin nr.135, datë 26.08.2022, “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit”, i përbërë nga Dh. F., K. A., P. Xh.

Sipas procesverbalit të datës 610/1 Prot. Date 07.09.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “maualit teknik vkm 626 date 15.07.2015”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përlllogaritur si fond limit ne referim mauali teknik vkm 626 date 15.07.2015 e cila rezulton të jetë 24, 999, 990 lekë pa tvsh.

Procesverbali per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike eshte perpiluar, nenshkruar nga specialisti i fushes z. A. Dh. dhe procesverbali per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim nga Njesia e Prokurimit e perbere nga z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh..

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje Asfalti*”, me fond limit në shumën 24,999,990 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 24,211,750 lekë pa tvsh u konstatua se: Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (E. S. (kryetar), V. P. (ekonomiste), dhe A. D. specialist i fushes), të cilat janë evidentuar në procesverbalin me nr. 632 prot, datë 12.09.2022. Në kriteret e miratuara rezultojnë se disa prej tyre nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik, konkretisht si më poshtë;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:

-1 (nje) Eskavatoristë/Makinistë/Manovratorë, ***Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërishit pasi këtu kemi të bëjmë me një kontratë blerje malli dhe nuk argumentohet përse kërkohen punonjësit manovratorë.***

-6(gjashë) Shoferë për kamiona (kategoria C minimale),

Për të cilët, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton kapacitetin te profesional stafin, personelin e nevojshëm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e funizimit me mallrat e kerkuara për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar ne raport me furnizimin e mallrave qe kerkohen te realizohen te cilat jane ndertimore, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.*

2.4.7 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 6 (gjashtë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektikëtij prokurimi.

Per mjetet e transportit per mallrat te klasifikuar sipas legjislacionit ne fusqi te rrezikshme (*Autobitumatriçe*) duhet te paraqesin certificate per transport mallrash te rrezikshem leshuar nga institucionet perkatese(e vlefshme).

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe faturatatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me **qëllim verifikimi** nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga moment i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar si më sipër. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne perputhje me neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne rastin konkret jane kerkuar :

- minimalisht **6 (gjashtë)** kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,
- minimalisht 1 (nje) autobitumatriçe
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep”.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Ne referim te:

- llojit te materialit,
- procesit teknik te furnizimit,
- sasise se kerkuar,

- afatit te kerkuar, si dhe mundesise teknike te vendosjes ne veper.

Sa mesiper kemi te bejme me kriteret minimale per plotesimin dhe realizimin e kontrates sipas percaktimeve dhe qellimit te saj.

Nr.	Emertimi i mallit	njesia	sasia	Tetor 2022	Nëntor 2022
1	Bitum M- 3 leng	kg	12500	6250	6250
2	Binder	ton	1570	785	785
3	Asfaltobeton guri kave	ton	841	420	421
5	Stabilizant (Tampon)	m3	105	50	55

Sa mesiper eshte marre parasysh sasite e kerkuara, si procesit teknik te furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk jane mallra qe mund te magazinohen, si dhe nuk jane mallra qe mund te rrine ne gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder, asfaltobeton), por menjehere pas procesit te prodhimit ngakohen ne mjet, dhe dergohen ne vendin e vendosjes ne veper.

Referuar vkm nr. 628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **...përzierja e prodhuar (binder, asfaltobeton) duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.** Sa mesiper llogaritja eshte mbeshtetur dhe me mundesine autoritetit kontraktor per vendosjen ne veper, ne sinkronizim me prodhim-furnizim te mallrave binder, asfaltobeton).

2.4.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

3. ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose **ekuivalente të tij.**

4. ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose **ekuivalente të tij.**

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. *Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, nenin 79 të LPP, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë kërkuar këto certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe sistemi i menaxhimit mjedisor . Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) i përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallrat që plotësojnë kërkesat e sandarteve te cilesis. Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.*

Argumentimi i kriterëve teknike ne lidhje me pajisjet, makineritë, punonjësit dhe profilet e tyre të punës janë mirë argumentuar nga specialisti fushës pjesë e njësisë së prokurimit Ing.A.Dh.

Nuk ka ndryshime.

Nga sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të bërë nga grupi i auditimit, arrihet në konkluzionin se, kjo procedurë prokurimi është blerje mallrash, dhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK janë kryer ndryshimet të kriterëve dhe nuk rezultojnë të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish dhe në përputhje me objektin e kontratës. Kërkesa këto të cilat mund të ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat *bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Veprime e mosveprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E. D., z. B. Ç., dhe anëtarët e NjP z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, nenin 43, pika 5, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 683, të datës 07.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	Sh.	24,244,750	Kualifikuar
2	Shoqëria A.	20,834,500	S’kualifikuar; (Paraqet keto mangësi në dokumentat e dorëzuara në SPE : a) <i>Ne dokumentat standarte të tenderit të kapaciteti ekonomik dhe financiar në piken 2.2.2 ku kërkohej që operatori ekonomik është i detyruar të paraqes bilancet vjetore në formën e kërkuar nëse është në kushtet e nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 Per audituesin ligjor.</i> Operatori ekonomik “A. ” ndodhet në kushtet e nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 ku thuhet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, pasi totali i aktiveve të tij e tejkalon shumën prej 50 milion lekesh dhe shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) i tij e tejkalon shumën prej 100 milion lekesh dhe në SPE nuk ka paraqitur akt

			<p><i>ekspertizene pasqyrave financjare nga eksperti kontabel i miratuar .</i></p> <p>b) Ne piken 2.4 te DST-se <i>eshte kerkuar fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, 3 muajt e fundit, për mallrat objekt prokurimi: Stabilizant, Asfaltobeton, Bitum dhe Binder</i>". Operatori ekonomik "A." nuk ka paraqitur flete e analizes per produktin Stabilizant, duke qene se ka lidhur kontrate qiraje me Shoqerine V. Ll. shpk per prodhimin e materialeve inerte, nuk ka nje fletë analize ose raport testimi nga laboratorit per produktet e kekruara sipsa percaktimit ne kriteret e DST-se.</p> <p>Per keto arsye KVO nuk e kualifikon oferten e operatorit A., dhe vazhdon me vleresimin ne SPE.</p>
--	--	--	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 13.01.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 1OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 13.01.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "Sh.", i cili plotëson dokumentacionin e kërkuar nga AK, me të cilin është lidhur kontrata datë 17.01.2023 për vlerën 24,211,750 lekë pa tvsh. lekë pa TVSH dhe vlera 29,054,100 lekë me TVSH, dhe me afat 2 muaj, nga dt 17.01.2023 deri me 17.03.2023 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (ka pasur ankim)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se është paraqitur 1 ankesë nga OE A., duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK. Titullari i AK, përkatësisht për këtë ankesë, ka marrë vendimin (urdhër) me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga K. S., A. M., E. A..

Me dt 12.12.2022 dhe 807 Prot Ak Agjencia e sherbimeve Publike ka marre Vendim në lidhje me refuzimin e ankeses së paraqitur nga shoqeria A. dhe Vendimi është komunikuar OE A. dhe Komisionit të Prokurimit Publik. KPP me vendimin nr. 1143/2022, datë 22.11.2022, ka vendosur të mos marrë në konsideratë ankesën e paraqitur nga OE "A.", duke lejuar AK të vijojë më tej me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Titulli i gjetjes: Shmangie nga kryerja e procedurave standarde të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar duke copëzuar fondet për shkurtimin e afateve të procedurës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit për vitin 2022 rezulton se janë kryer 2 procedura prokurimi ndara nga njëra tjetra, me të njëjtin kod CPV dhe objekt prokurimi, të cilat konsiderohen copëzime fondesh dhe shmangie nga kryerja e procedurave standarde të prokurimit. Procedura të cilat janë trajtuar sipas kriterëve midis kufijve të ulët dhe të lartë monetar, pra nëse do të kryheshin së bashku vlera e tyre shkon mbi kufirin e lartë monetar. Kryerja në mënyrë copëzuar të fondeve, ul afatet e pranimit të dokumentacionit, nuk u jep kohë OE të marrin informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e përgatitjes së dokumentacionit mbi kriteret e kërkuara, duke sjellë një konkurrencë jo të ndershme, pabarazi midis OE, përdodim fondesh jo në përputhje me parimet e efijencës, efikasitetit dhe efektivitetit,

nuk nxit pjesëmarrjen, trajtimin e barabartë, dhe mosdiskriminimin e OE. Konkretisht nga Agjencia e Shërbimeve Publike, me drejtor z. B. Ç., në rolin e titullarit të AK, por pa asnjë autorizim nga titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. D. janë kryer procedurat e prokurimit me objekt:

1. “Blerje asfalt”, me REF-41318-09-12-2022 me fond limit në shumën **24,999,990 lekë pa TVSh**, me afat për pranimin e ofertave 20 ditë, ku kanë marrë pjesë dy OE nga të cilët është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar e shpallur fitues OE “Sh. ShPK”, me vlerë kontrate në shumën 24,211,750 lekë.

2. “Blerje asfalt”, me REF-29817-05-18-2022, me fond limit në shumën **35,545,730 lekë pa TVSh**, me afat për pranimin e ofertave 20 ditë, ku kanë marrë pjesë dy OE nga të cilët është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar e shpallur fitues OE “Sh. ShPK”, me vlerë kontrate në shumën 37,357,000 lekë pa TVSh.

Pra shuma e të dy shpalljeve është në shumën **60,545,720 lekë pa TVSh**, vlerë e cila trajtohet me procedurën e kufirit të lartë monetar, për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave e cila është në vlerën e fondit limit 40,000,000 lekë pa TVSh. *Veprime e mosveprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E. D., z. B. Ç. Drejtor i, dhe anëtarët e NjP z. E. S. person përgjegjës për prokurimet.*

Kriteri: Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me nenin 2, i cili citon se;

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

me nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

me neni 33, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 11, pika 1/a), pika 5, e cila citon se:

“Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”

neni 12, pika 3, e cila citon se:

“Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlloraritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë”.

Ndikimi/Efekti: Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, të marrin masat që, gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë dhe drejtorive vartëse” me të dhënat si më poshtë;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti per nevojat e administrates se Bashkise dhe drejtorive vartese”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur” REF-30917-05-26-2022 Urdhri nr. 04/1451 prot., datë 17.03.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 139, datë 23.02.2022. 3.E. K. 4.D. Gj. 5.S. T. 6.E. B. 7.E. Q.	2 Njësia e Prokurimit 1. F. A. 2. A. Zh. 3. E. B.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 03/ 1451 /1 prot., datë 17.03.2022 1. L. B. 2. P. S. 3. E. M.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 22,458,332 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: G. C. G. Shpk 12 leke/liter.		6. Diferenca me fondin limit lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 13.06.2022	8. Burimi Financimit Te ardhurat e bashkise dhe drejtorive vartese		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, G. C. G. Shpk b) S’kualifikuar s’ka, c) Kualifikuar G. C. G. Shpk
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: deri ne mbarimin e sasise dhe vleres se kontrates nga data e nenshkrimit te saj			
10.Ankimime AK- s’ka APP- s’ka KPP- s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3417 prot., datë 30.06.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: s’ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Titulli i gjetjes: Nuk dokumentohet sasia e nevojave për karburant, nuk ka specialistë të fushës në Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë dhe drejtorive vartëse” me fond limit 22,458,332 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 22,458,332 lekë pa TVSh me marzh fitimi 12 lekë/litër me OE fitues “G. C. G. ShPK”, konstatohet se: Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 139 datë 23.02.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit”, i përbërë nga E. K., D. Gj., S. T., E. B., E. Q.. Sipas procesverbalit të datës 23.05.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “grupi i punes mori ne konsiderate Vendimin e Bordit te transparences per percaktimin e çmimit te naftes me date 15.04.2022, sipas aktit normativ nr.8 date 25.03.2022 per percaktimin e ketij

fondi limit”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, e cila rezulton të jetë 22,458,332 lekë pa tvsh. Llogaritja e fondit limit është bërë për sasinë 126,707 litra naftë me çmim 167.5 lekë/litër dhe për sasisë 7,308 litra benzinë me çmim 169 lekë/litër. Sasia e karburantit të vendosur mbi të cilën është përlogaritur fondi limit i kontratës së prokuruar nuk është dokumentuar dhe argumentuar.

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, E. K., D. Gj., S. T., E. Q. dhe specialist i fushes E. B.. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (E. B.-Specialist i fushes, F. A.-Jurist, A. Zh.-Ekonomist), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 26.05.2022, të cilat në përgjithësi janë të argumentuara.

Si konkluzion nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë dhe drejtorive vartëse”, rezulton se Autoriteti Kontraktor nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës së kontratës sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, pika 2-3, pasi nuk dokumentohet dhe argumentohet sasia e karburantit mbi të cilën është hartuar fondi limit.

-Nuk janë argumentuar specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit, veprime jo në përputhje me nenin VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2.

-Në Njësinë e Prokurimit i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kritereve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi titullari i AK Z. E. D., anëtarët e llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike z. E. K., zj. D. Gj., z. S. T., zj. E. B., z. E. Q. dhe zj. A. Zh. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.*

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74, pika 2, në të cilin citohet se;

Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

dhe neni 75, paragrafi i parë në të cilin citohet se;

“Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.

Ndikimi/Efekti: Nuk dokumentohet përlogaritja e vlerësimit të kontratës dhe përbërja e anëtarëve të NjP e KVO nuk ka specialistë të fushës për të gjykuar në lidhje me kriteret e vendosura dhe vlerësimin e ofertave.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrave të prokurimit të aplikojë mënyrën

dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara.

Rekomandim: Titullari i AK, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, në përbërje të Komisioneve të NjP dhe KVO, të ketë punonjës me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1451/14, të datës 21.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	G. C. G. ShPK	12 leke/liter	Kualifikuar
2			S'kualifikuar; zero (Vendos arsyet e s'kualifikimit sipas vlerësimit të KVO)

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 28.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 28.06.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “G. C. G. Shpk” për të cilën është lidhur kontrata datë 30.06.2022 për vlerën 12 leke/liter, dhe me afat deri në mbarimin e sasise dhe vleres së kontrates nga data e lidhjes së kontratës.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Përmiresimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara” me të dhënat si më poshtë;

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmiresimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “PROCEDUR E HAPUR” REF-39956-08-26-2022 Urdhri nr. 24, 3963 prot. Date 10.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.	2 Njësia e Prokurimit 1. F. A. 2.A. Zh. 3. M. S.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3963/1prot nr25 date 10.08.222 1. L. B. 2. P. S. 3. E. M.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 38,237,222 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: “Z. ShPK” me vlerë 38,173,802 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 63, 420 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 14.09.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + Buxheti i Bashkise Berat		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE , c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 120 ditë			
10.Ankimime AK-s'ka APP- ka; KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 4844 prot., datë 27.09.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Grafiku i punimeve është hartuar nga ing.M. S., **Preventivues:** Ing. V. K., Ing. R. V., Ing. M. S., **Specifikimet Teknike;** Ing. V. K., Ark. E. S., Ark. F. C., Top. A. J., Ing. A. Dh., **Projektimi:** Ing. V. K., Ing. M. S., Ing. V. K., Ing. A. Dh., Ark. E. S., Ark. F. C., Miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “*Ndriçimi i qytetit Berat*” me fond limit 38,237,222 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 38,173,802 lekë pa TVSh me në të cilën kanë marrë pjesë 1 OE i cili është shpallur fitues OE “Z. ShPK”, konstatohet se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej zj. F. A. specialist prokurimesh Jurist, zj. A. Zh. specialist prokurimesh Ekonomist, zj. M. S. Specialiste e fushes Inxhinier, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 29.08.2022, nga ku rezultoi se nuk janë të argumentuara kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë:

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Argumentim teknik i mjeteve dhe makinerive:

1.Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton Copë 3,

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit që janë rreth 255 m3 transport dherash deri në 10km dhe materialesh ndertimi rere, zhavor, cemento, hekur, tulle per kryerjen e punimeve te 4938 m2 suvatime 382 m3 mur guri ne lartesi te 280m3 beton per breza dhe kollona, tuba, rakorderi te ndryshme dhe si dhe largesia gjeografike e objekteve te cilat kane nje shtrirje gjithepershires ne territorin Bashkise Berat jane te domosdoshem 3 Kamionn vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton dhe 2 Kamioncina deri ne 3ton.

2.Kamion me Vinc Cope 1

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit si dhe largesia gjeografike e objekteve te cilat kane nje shtrirje gjithepershires ne territorin Bashkise Berat jane te domosdoshem Kamion me Vinc 1 Cope per transportimin dhe shkarkimin e materialeve te ndertimit si tjegulla, skela metalike, tulla etj.

5.Betoni copë 3

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit punime betoni rreth 300 m3 si dhe largesia gjeografike e objekteve te cilat kane nje shtrirje gjithepershires ne territorin Bashkise Berat jane te domosdoshem Motobetoni 2 Cope per pregatitjen e betonit per brezat dhe kollonat, soleta etj.

6.Autopompe betoni cope 1

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit si dhe shtrirjen gjeografike te objektit eshte e domosdoshme prania e 1 Autopompe betoni per realizimin e punimeve te betonit.

7.Vibrator betoni Copë 2

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit eshte e domosdoshme prania e 2 vibrator betoni per realizimin e punimeve te betonit.

8.Pompa Suvatimi Copë 2

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit eshte e domosdoshme prania e 2 Pompa Suvatimi per realizimin e punimeve te suvatimit.

9. Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit Cope 1

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit eshte e domosdoshme prania e 1 Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit per zerat e punimeve te hekurit.

10. Depozite uji 1000l cope 3

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit si dhe shtrirjen gjeografike te objektit, eshte e domosdoshme prania e 5 Depozite uji 1000l per furnizimin me uje ne kantier.

11. Pompa Uji Copë 2

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit, shtrirjen gjeografike te objektit si dhe veshtiresite e terrenit jane te domosdoshme te pakten 2 pompa uji.

12. Pajisje niveluese per nivelim shtresash cope 1

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit eshte e domosdoshme 1 paisje niveluese per nivelim shtresash betoni.

13. Gjenerator 2 cope, Saldatrice 1 cope

Duke u nisur nga grafiku i punimeve, volumet e zerave te preventivit jane te domosdoshme per furnizimin me energji elektrike si edhe per punimet e saldimit te konstruksioneve metalike.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

" Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se "Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik".

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 " Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" neni 4 parashikon shprehimisht se: "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim."

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Janë bërë disa ndryshime ne baze e rekomandive te APP-se si më poshtë:

Nuk shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

I.3 Në lidhje me nje sqarim ne preventivin e ngarkuar ne sistem per banesen e Z. R. M. ne lagjen Clirim, Rajoni nr. 1

SHTOJCA 2.

Nuk shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

I.4 Në lidhje me Në lidhje me ndryshimet e dokumnetave standarte të tenderit po I paraqesim me poshte:

5. Në pikën 2.3.4, gërma a, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqerisë, inxhinierët e mëposhtëm:*

- 2 (nje) *Inxhinier Ndërtimi*

- 1 (një) *Inxhinier Elektrik”.*

Ky kriter ndryshon si me poshte:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqerisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- 2 (nje) *Inxhinier Ndërtimi*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë - 1 (një) **Inxhinier Elektrik” me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi.***

6. Në pikën 2.3.4, gërma b, të kapacitetit teknik, ndër të tjera, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistët kualifikuar si më poshtë:*

- *manovrator 2(dy);*

- *Shofer 2 (dy);*

-Për manovratorët dhe shoferat të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për muajin Korrik 2022”.

Ky kriter ndryshon si me poshte:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistët kualifikuar si më poshtë:

- *manovrator 2(dy);*

- *Shofer 2 (dy);*

-Për manovratorët dhe shoferat të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale.

8. Në specifikimet teknike, ne rastet kur është përmendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, do të pranohen ose ekuivalente”.

Si konkluzion rezulton se nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjrisht të gjitha automjetet e kërkuara e konkretisht, nuk argumenohet kërkesa për Kamion me Vinc, Rimorkiator për transport mjetesh dhe për Saldatrice, dhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK janë kryer ndryshimet të kriterëve. Kërkesa këto të cilat mund të ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat *bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Për veprimet e mosveprimet e ngarkohen me përgjegjësi titullari i AK z. E. D., anëtarët e NjP zj. F. A., zj. A. Zh. e zj. M. S., komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, zj. V. K., z. E. S., z. F. C., z. A. J. e z. A. Dh..*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e

prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, nenin 43, pika 5, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Nuk janë argumentuar specififikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit, të ngarkuara në sistemin elektronik të prokurimeve, veprime jo në përputhje me nenin VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, ku citohet se:

Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specififikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specififikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3963/12, të datës 22.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	Z. ShPK	38,173,802	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 22.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 22.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “Z. ShPK” për të cilën është lidhur kontrata datë 27.09.2022 për vlerën 38,173,802 lekë pa TVSH dhe vlera 45,808,563 lekë me TVSH, dhe me afat 120 (njqind e njetzet) dit nga data e lidhjes së kontratës.

7. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat” me të dhënat si më poshtë;

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” REF- 46577-10-19-2022 Urdhri nr. 35 prot., datë 11.10.2022.	1.1. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit 1. L. B. 2. E. S. 3. R. V. 4. A. Dh. 5. D. Z.	2. Njësia e Prokurimit 1. F. A. (jurist) 2. A. Zh. (ekonomist) 3. E. N. (Inxhinire Planifikim Hapsinor dhe Aplikimet GIS)	3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 34 prot., datë 11.10.2022. 1. L. B. Kryetar (arkitekt) 2. P. S. anëtra (jurist) 3. E. M. anëtar (jurist)

4. Fondi Limit (pa Tvsh) 8,331,410 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: "R. C." SHPK 7,804,200 lekë pa Tvsh.	6. Diferenca me fondin limit 527,210 lekë pa Tvsh
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 31.10.2022.	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Berat	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S'kualifikuar 1 B/OE -OE "F." c) Kualifikuar 1 B/OE -OE "R. C." SHPK
7/2. Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj		
10. Ankimime AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 5114/12 prot., datë 01.12.2022.	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK s'ka

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Me shkresën nr. 5019 prot., datë 06.10.2022, z. L. B. me detyrë Nënkryetar i Bashkisë ka paraqitur pranë Drejtorisë Juridike projektin "Ndërtimi i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven, Berat".

Bashkëlidhur dokumentacionit të dosjes së procedurës së prokurimit ndodhet:

- Specifikimet teknike (projekt zbatimi).
- Preventivi i punimeve i hartuar së bashku me analizën e çmimeve nga z. L. B. (arkitekt) me detyrë Nënkryetar i Bashkisë dhe miratuar nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë.
- Relacion përshkrimor i mbajtur nga grupi i punës i përbërë nga z. L. B., z. E. S. znj. R. V., z. A. Dh. dhe z. D. Z. me detyrë respektive arkitekt, inxhinier dhe topograf.
- Projekti.
- Grafiku i punimeve.

Me Urdhrit nr. 35, datë 11.10.2022, z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor ka urdhërdhura Njësinë e Prokurimit të përbërë nga znj. F. A. jurist pranë Drejtorisë Juridike, znj. A. Zh. ekonomist pranë Drejtorisë Juridike dhe znj. E. N. inxhinier planifikimi hapsinor dhe aplikimeve G. pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve për kryerjen e prokurimit me objekt "Ndërtimi i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven, Berat" me fond limit në vlerën 8,331,410 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar".

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 35, datë 11.10.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 5144/2 prot., datë 19.10.2022, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. F. A., znj. A. Zh. dhe znj. E. N. është miratuar procesverbali me objekt argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim të miratuar nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat. Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Berat në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Në lidhje me kriteret e vendosura nga Njësia për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit janë konstatuar disa kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar të pa argumentuara dhe çënojnë pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar konkretisht:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat” me fond limit 8,331,410 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 7,804,200 lekë pa TVSh me ku kanë marrë pjesë 2 OE nga të cilët janë kualifikuar 1 OE dhe është s’kualifikuar 1 OE, është shpallur fitues OE “R. C. ShPK”, nga ku konstatohet se:

-Në lidhje me kriteret e vendosura nga Njësia për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit janë konstatuar kriteret jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar të pa argumentuara dhe cënojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar konkretisht:

Pika 2.3.4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencë ose punonjës me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt të vërtetuar me, diplomë, CV dhe të figurojnë në listëpagesa (për muajt Shtator 2022) si më poshtë:

-Inxhinier ndërtimi 1 (një)

-Inxhinier topograf 1 (një)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4, për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

-Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore referuar preventivit.

-Inxhinieri Topograf/Gjeodet është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi.

-Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 21 “Format e kontratës së punës”.

Pra në kushte të tilla kriteri për paraqitjen e kontratës së punës para noterit është kufizues, për arsye se duke u bazur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 21, është e vlefshme kontrata individuale e punës kur lidhet në formë të shkruar ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit jo në prani të noterit. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. F. A. jurist pranë Drejtorisë Juridike, znj. A. Zh. ekonomist pranë Drejtorisë Juridike dhe znj. E. N. inxhinier planifikimi hapsinor dhe aplikimeve GIS pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose entë kontraktor, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2, Kreu X, neni 40, pika 3, nenin 43, pika 5, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Vlerësimi i ofertave nga KVO:

Titulli i gjetjes: Në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialistë të fushës.

Situata: Me Urdhrin nr. 34, datë 11.10.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor z. E. D. është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. L. B. (arkitekt) me detyrë Nënkyetar i Bashkisë, z. P. S. (jurist) me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe z. E. M. (jurist) me detyrë specialist/jurist pranë Drejtorisë Juridike.

Konstatohet se specialisti i fushës z. L. B. ka formimin arkitekt, profil i cili nuk përputhet tërësisht me zërat e fushës së objektit të prokurimit “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave dhe segment rruge”. Në rastin konkret ka qenë i nevojshëm që specialisti i fushës të jetë inxhinier ndërtimi. Duke u bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja nr. 5, specialisti mund të jetë arkitekt por i cili ka përfunduar studimet para viteve 1985. Nga auditimi i dosjes personale të z. L. B. i ka përfunduar studimet pas vitit 1985. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor*

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 75, pika 1, ku përcaktohet se:

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Procedura e prokurimit paraqet një risk në fazën e vlerësimit të ofertave.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës, caktimin e zyrtarëve të KVO dhe vlerësimin e ofertave.

Titulli i Gjetjes: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e specifikimeve teknike ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Situata: Referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat”, në të cilën me urdhrin nr. 34 prot., datë 11.10.2022, të titullarit të AK z. E. D. është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje z.L. B. N/Kryetar, arkitekt, z.P. S. Drejtor i drejtorisë juridike (jurist) dhe z.E. M. (jurist) konstatohet se një nga anëtarët e komisionit ka marrë pjesë edhe në “*llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike*”. Konkretisht z. L. B. si anëtar i hartimit të preventivit të kontratës dhe specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit) në të njëjtën kohë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. LPP nuk vendos kufizime për sa i përket anëtarëve të komisionit të “*llogaritjes së fondit limit*” por në rastin konkret i njëjti komision është përgjegjës edhe për hartimin e specifikimeve teknike të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, neni 78 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Në lidhje me këtë situatë, vlen të theksohet se, referuar nenit 75, pika 2 të VKM-së së sipërcituar, personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo situatë është trajtuar edhe në auditimin e

mëparshëm për të cilin është lënë rekomandimi përkatës. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z.E. D.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2/dh, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73 pika 3, neni 75 pika 2, dhe Neni 78 pika 2.

Ndikimi: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në Njësinë e Prokurimit ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave përbën “konflikt interesi” në kuptimin e LPP-së si dhe cënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit.

Shkaku: Interpretim dhe zbatim i gabuar i LPP-së dhe akteve nënligjore nga ana e personit/punonjësit përgjegjës për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Personi përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë për të cilët referuar procesverbalit nr. 5114/7 prot., datë 08.11.2022, nga KVO është kryer në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) vlerësimi dhe klasifikimi përkatës si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSH	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	F.	6,984,800	<p>S’kualifikuar</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se dokumentacioni përmban mangësi, konkretisht mungojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Në pikën 2.3.5 të DT operatori ekonomik nuk plotëson 4 puntor lartësie kjo pasi Ing. Ndërtimit është paraqitur si drejtues teknik në licensë dhe punëtor lartësie. Punonjësi E. D. është paraqitur si karpentier dhe si punëtor lartësie. Për punonjësin K. M. paraqitur si punëtor lartësie nuk është paraqitur kontrata e punës. Për teknikun e ndërtimit të paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi kualifikimi ose ekuivalente sipas kërkesave në kriteret e veçanta për kualifikim.
2	R. C. SHPK	7,804,200	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës më datë 22.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë ekonomikë pjesëmarrës është s’kualifikuar OE “F.” dhe kualifikuar OE “R. C.” SHPK. Në përfundim, mbi bazën e raportit përmbledhës të KVO, Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat më datë 22.11.2022, ka shpallur fituese ofertën e OE “R. C.” SHPK i cili plotëson dokumentacionin e kërkuar nga AK, me të cilin është lidhur kontrata për realizimin e punimeve më datë 01.12.2022, në vlerën 9,365,040 lekë me Tvsh me afat realizimin e saj 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik” me të dhënat si më poshtë;

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik”		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedur e hapur” REF-25005-04-13-2022 Urdhri nr. 15, datë 12.04.2022.	1.1. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit 1. L. B. Projektimi: 1. E. S. 2. R.V. 3. A. Dh. 4. D. Z.	2. Njësia e Prokurimit Urdhri nr.15,1903 prot, datë 12.04.2022 1. F. A. (Jurist) 2. A. Zh. (Ekonomist) 3. A. Dh. (Inxhinier Gjeomatik)
3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 16, datë 12.04.2022. 1. L. B. Kryetar (Arkitekt) 2. P. S. anëtar (Jurist) 3. E. M. anëtar (Ekonomist)	4. Fondi Limit (pa tvsh) 12,815,000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: “R. C.” SHPK me vlerë 9,835,957.75 lekë pa Tvsh.
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 19.05.2022	8. Burimi Financimit Grante	6. Diferenca me fondin limit 2,979,042.25 lekë pa Tvsh
7/2. Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaji		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 5 OE b) S’kualifikuar 1 B/OE , c) Kualifikuar 4 B/OE
10. Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1903 prot., datë 30.06.2022	12. Përgjigje Ankesës nuk ka.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Me shkresën nr. 489/1 prot., datë 26.01.2022, z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat ka miratuar kërkesën për fillimin e procedurës së prokurimit për projektin “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik”.

Me shkresën nr. 489/2 prot., datë 11.04.2022, z. L. B. me detyrë Nënkyetar i Bashkisë ka paraqitur pranë Drejtorisë Juridike projektin “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik”.

Me shkresën nr. 1995 prot., datë 14.04.2022, nga znj. E. Dh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Integritimit European dhe Projekteve dhe znj. R. Sh. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave është hartuar relacioni mbi gjendjen e llogarisë bankare për zhvillimin e projektit.

Bashkëlidhur dokumentacionit të dosjes së procedurës së prokurimit ndodhet:

- Specifikimet teknike (projekt zbatimi).
- Preventivi i punimeve i hartuar së bashku me analizën e çmimeve nga z. L. B. (arkitekt) me detyrë Nënkyetar i Bashkisë dhe miratuar nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë.
- Relacion përshkrimor i mbajtur nga grupi i punës i përbërë nga z. L. B., z. E. S., znj. R. V., z. A. Dh. dhe z. D. Z. me detyrë respektive arkitekt dhe inxhinier.
- Projekti.
- Grafiku i punimeve.

Më datën 28.03.2022, janë konfirmuar fondet për zhvillimin e procedurës së prokurimit si pjesë e parafinancimit të kontratës së Grantit nr. 3, PZHRSH Bashkia Berat sipas kërkesës me nr. 1426 prot., datë 25.03.2022.

Me Urdhrin nr. 15, datë 12.04.2022, z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor ka urdhërdhura Njësinë e Prokurimit të përbërë nga znj. F. A. jurist pranë

Drejtoria Juridike, znj. A. Zh. ekonomist pranë Drejtoria Juridike dhe z. A. Dh. inxhnier gjeomatik pranë Drejtoria së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve për kryerjen e prokurimit me objekt “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik” me fond limit në vlerën 12,815,000 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”.

Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 15, datë 12.04.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1903/2 prot., datë 26.04.2022, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. F. A., znj. A. Zh. dhe z. A. Dh. është miratuar procesverbali me objekt argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim të miratuar nga z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat. Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Berat në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Ndryshime në DT (shtojca):

Më datën 12.05.2022, Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. A. Dh., znj. F. A. dhe znj. A. Zh. ka mbajtur procesverbalin me objekt mbi modifikimin dhe ndryshimeve të dokumentave të tenderit, ku kanë hartuar një shtojcë në DT si më poshtë:

Ishte	Bëhet
2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, minimalisht si më poshtë:	2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, minimalisht si më poshtë:
➤ Teknik ndërtimi 1 (një)	➤ Teknik ndërtimi 1 (një)
➤ Saldator 1 (një)	➤ Saldator 1 (një)
➤ Karpentier 1 (një)	➤ Karpentier 1 (një)
➤ Pllakashtrues 5 (pesë)	➤ Pllakashtrues 3 (tre)

Në lidhje me kriteret e vendosura nga Njësia për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit janë konstatuar disa kriterë jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar të pa argumentuara dhe çënojnë pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar konkretisht:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit me objekt “Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik” me fond limit 12,815,000 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 9,835,957 lekë pa TVSh me ku kanë marrë pjesë 5 OE nga të cilët janë kualifikuar 4 OE dhe është s’kualifikuar 1 OE, është shpallur fitues OE “R. C. ShPK”, nga ku konstatohet se:

Për pikën 2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës. Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP - 1 A (Punime gjurmimi në tokë).

NP - 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale).

NP - 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS-6 A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese).

NS- 8 A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri).

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike).

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

-Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventive, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik) konstatohet se për zbatimin e objektit të kontratës, nuk janë parashikuar ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik, ose punime që përfshijnë në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte (përkufizimi i kategorisë NP-12 sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008).

Për pikën 2.3.3. Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për këto punime. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

2. Inxhinier Gjeodet/Gjeomatik (Markshajder) /Topograf 1 (një)

3. Inxhinier Mjedisit 1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën Mars 2022. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune noteriale (e vlefshme) si dhe deklaratë nga administratori i shoqërisë që inxhinierët janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

-Ekspertizat profesionale e Inxhinierit të Mjedisit është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me kërkesën për inxhinier mjedisit, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit në fjalë.

Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga këta inxhinier. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në pikën “a”, të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që

përpara miratimit të tyre për zhvillim, për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore;

-Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 21 “Format e kontratës së punës”. Pra në kushte të tilla kriteri për paraqitjen e kontratës së punës para noterit është kufizues, për arsye se duke u bazur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 21, është e vlefshme kontrata individuale e punës kur lidhet në formë të shkruar ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit jo doemosdoshmërisht në prani të noterit.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. F. A. jurist pranë Drejtorisë Juridike, znj. A. Zh. ekonomist pranë Drejtorisë Juridike dhe z. A. Dh. inxhinier gjeomatik pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2, Kreu X, neni 40, pika 3, nenin 43, pika 5, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Vlerësimi i ofertave nga KVO:

Titulli i gjetjes: Në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialistë të fushës.

Situata: Me Urdhrin nr. 16, datë 12.04.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. L. B. arkitekt me detyrë Nënkryetar i Bashkisë, z. P. S. jurist me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe znj. E. M. ekonomist pranë Drejtorisë Juridike.

Konstatohet se specialisti i fushës z. L. B. ka formimin arkitekt, profil i cili nuk përputhet tërsisht me zërat e fushës së objektit të prokurimit “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave dhe segment rruge”. Në rastin konkret ka qenë i nevojshëm që specialisti i fushës të jetë inxhinier ndërtimi. Duke u bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja nr. 5, specialist fushe mund të jetë arkitekt por i cili ka përfunduar studimet para viteve 1985. Nga auditimi i dosjes personale të z. L. B. i ka përfunduar studimet pas vitit 1985. *Për veprimet dhe mosveprimet e*

mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 75, pika 1, ku përcaktohet se:

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Procedura e prokurimit paraqet një risk në fazën e vlerësimit të ofertave.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës, caktimin e zyrtarëve të KVO dhe vlerësimin e ofertave.

Titulli i Gjetjes: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e specifikimeve teknike ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Situata: Referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “*Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik*”, në të cilën me urdhrin nr. 16, datë 12.04.2022, të titullarit të AK z. E. D. është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje z.L. B. N/Kryetar, arkitekt, zj.E. M. specialiste prokurimesh ekonomiste dhe z.P.S. Drejtor i drejtorisë juridike (jurist), konstatohet se një nga anëtarët e komisionit ka marrë pjesë edhe në “*llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike*”. Konkretisht z. L. B. si anëtar i hartimit të preventivit të kontratës dhe specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit) në të njëjtën kohë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. LPP nuk vendos kufizime për sa i përket anëtarëve të komisionit të “*llogaritjes së fondit limit*” por në rastin konkret i njëjti komision është përgjegjës edhe për hartimin e specifikimeve teknike të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, neni 78 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Në lidhje me këtë situatë, vlen të theksohet se, referuar nenit 75, pika 2 të VKM-së së sipërcituar, personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo situatë është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm për të cilin është lënë rekomandimi përkatës. *Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z.E. D..*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2/dh, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73 pika 3, neni 75 pika 2, dhe Neni 78 pika 2.

Ndikimi: Caktimi i të njëjtit zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në Njësinë e Prokurimit ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave përbën “*konflikt interesi*” në kuptimin e LPP-së si dhe çënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit.

Shkaku: Interpretim dhe zbatim i gabuar i LPP-së dhe akteve nënligjore nga ana e personit/punonjësit përgjegjës për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Personi përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomikë për të cilët referuar procesverbalit nr. 1903/6 prot., datë 24.05.2022, nga KVO është kryer në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) vlerësimi dhe klasifikimi përkatës si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE "A." SHPK K... & "A." SHPK K.....	11,748,932	Kualifikuar
2	"A." SHPK me nipt J.....	12,617,881	Kualifikuar
3	"I." SHPK me nipt J....	10,546,910	kualifikuar
4	"R.C." SHPK me nipt L.....	9,835,957	kualifikuar
5	"F." SHPK me nipt K.....	12,198,281	Skualifikuar Te shtojca nr.8 vetedeklarimi nuk është plotësuar gjendje gjyqësore e OE. Në formularin e vetëdeklarimit shtojca 8 mbi disponimin e mjeteve të kërkuara në DST mungon mjeti Matrapik për thyerje betoni 1 copë.

Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës me shkresën nr. 1903/8 prot., datë 08.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij raporti përmbledhës, verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 4 OE. Në përfundim mbi bazën e raportit përmbledhës z. E. D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të AK më datë 30.05.2022, ka shpallur fituese ofertën e OE "R. C." SHPK me nipt L..... për të cilën është lidhur kontrata datë 30.06.2022, në vlerën 9,835,957 lekë pa Tvsh dhe vlera 11,803,149 lekë me Tvsh me afat 4 (katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Observacion:

Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresës nr. 1427/6, datë 30.06.2023, administruar nga KLSH me nr. 208/7, datë 04.07.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për Projektraportin e Auditimit në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga z. E. D.dhe z. P. S., z. B. Ç., z. E. S., zj. V. P. dhe z. A. Dh. është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

1.Në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i shpatullave dhe kollonave bashkë me segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven", pretendohet nga observuesit se kontrata e kërkuar për punonjësit sipas Kodit të Punës mund të jetë me shkresë të thjeshtë ose me akt noterial, komisioni i hartimit të kriterëve ka kërkuar që të jetë me akt noterial.

2.Në procedurën e prokurimit me objekt "Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik" pretendohet nga observuesit se nga observuesit se kontrata e kërkuar për punonjësit sipas Kodit të Punës mund të jetë me shkresë të thjeshtë ose me akt noterial, komisioni i hartimit të kriterëve ka kërkuar që të jetë me akt noterial. Gjithashtu pretendohet se kriteri për inxhinier mjedisi është i nevojshëm për identifikimin dhe vlerësimin e minimizimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.

3.Në procedurën e prokurimit me objekt "Rindërtimi i Shkollës Babë Dude Karbunara" pretendohet nga observuesit se kriteret e vendosura janë të argumentuara si Licenca nga Ministria e Kulturës, Arkitekt, Auditues Energjie si dhe Certifikatat ISO etj. Gjithashtu pretendohet se specifikimet teknike janë të argumentuara psi përputhen me nr. të analizës në zërat e preventivit.

4.Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i Banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara” pretendohet nga observuesit se specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e projektit dhe janë të argumentuara pasi përputhen me zërat e analizës së preventivit të punimeve. Gjithashtu pretendohet se kriteret janë të argumentuara për mjetet e kërkuar nga OE pjesëmarrës në tender.

5.Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndriçimi i qytetit Berat” pretendohet nga observuesit se specifikimet teknike janë të argumentuara dhe janë ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve. Gjithashtu janë paraqitur kriteret e kualifikimit të miratuara nga NJP.

6.Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti për nevojat e administratës së Bashkisë dhe drejtorive vartëse” pretendohet nga observuesit se AK ka ngritur një grup për përcaktimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike.

Në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje Asfalti” pretendohet nga observuesit se kundërshtojnë konstatimin e grupit të auditimit pasi kriteret janë argumentuar edhe pas ndryshimeve të sugjerimeve të APP dhe se NJP ka zbatuar me përpikmëri kriteret e kërkuara në këtë procedurë. Pretendohet se procedura e dytë është bërë pas miratimit të fondeve të saj me vendim të KB. Gjithashtu pretendohet nga zj. V.P. se nuk është pjesë e përgjegjësisë për hartimin e kriterëve pasi ka specialist të fushës për vendosjen e tyre ndërsa është marrë vetëm me specifikimet e fushës ekonomike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionet e dërguara sqaron se;

Grupi i auditimit pasi verifikoj pretendimet e paraqitur mbi Projektraportin e Auditimit, arrin në konkluzionin se nuk janë paraqitur dokumentacion, prova apo fakte të reja, ndryshe nga sa janë paraqitur në fazën e hartimit të Projektraportit. Sqarimet apo pretendimet e paraqitura janë të njëjta në thelb dhe në trajtim me ato çka janë paraqitur mbi aktkonstatimet e mbajtura në fazën e auditimit në terren. Gjithashtu sqarojmë se përgjegjësitë për personat përgjegjës, janë të përbashkëta në secilën fazë për procedurat e prokurimit si në hartimin e kriterëve të kualifikimit, hartimit të specifikimeve teknike, llogairtjes së fondit limit, në të gjitha rastet kur nuk ka një ndarje të qartë mbi detyrat e secilit anëtar. Nisur nga sa më sipër për këto arsye grupi i auditimit nuk merr në konsideratë pretendimet e paraqitura në hartimin e Raportit Përfundimtar të auditimit.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

1. Mbi zbatimin e kontratës “Ujësjellësi i Fshatit Duhanas, Fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”.

Kontrata e punimeve civile “Ujësjellësi i Fshatit Duhanas, Fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat” është nënshkruar me nr. 519/1 prot., datë 04.02.2021, me BOE “R. 2...” SHPK, me vlerë 438,068,428 lekë.

Projekti i zbatimit është hartuar nga Shoqëria S.. A. E.”. Afati i zbatimit të punimeve është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës së mbikëqyrjes së punimeve. Kontrata për mbikëqyrjen e punimeve është nënshkruar me nr. 189/10 prot., datë 24.02.2021, me BOE “4... & I.” (lider) përfaqësuar nga z. K. Ç. dhe “S. A. E.” SHPK.

Kontrata përfshin punime për linjat e ujësjellësit për zonat: Lapardha 1, Otlak-Orizaj, Orizaj, zona Informale dhe Duhanas.

Objekti është piketuar me datë 03.03.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve mban datën 01.03.2021. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë përfunduar datë 28.10.2021.

Kontraktori me shkresë nr. s'ka, datë 08.03.2021, ka njoftuar mbikëqyrësin e punimeve për disa problematika të cilat kanë lidhje me:

- Trungu kryesor shpërndarës G-T 2, është parashikuar për tu vendosur në krahun e majtë. Propozohet të kalohet në krahun e djathtë, pasi në krahun e majtë shtrihet linja kryesore e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Linja G-T 2-27-1, kalon në pronë private dhe propozohet të kalohet nga linja tjetër G-T 2-26 dhe shumë ndryshime të tjera si nevojë për spostim apo zgjatim linje. Ndryshime janë kërkuar edhe sipas shkresave datë 22.03.2021 dhe 30.06.2021.

Me shkresën e protokolluar në Bashkinë Berat nr. 4217 prot., datë 17.08.2021, është kërkuar zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve për 2 muaj, me argumentimet si më poshtë:

- Janë krijuar vonesa si rezultat i fillimit me vonesë të punimeve në Depon e Duhanasit, për arsye të procedurave të nevojshme të shpronësimit.

- Një projekt paralel në gjurmën e linjës kryesore të transmetimit Otlak-Depo e Baterisë, ka shfazuar programin e punimeve, duke pritur përfundimin e shtrimit të linjave elektrike në mënyrë që të mos dëmtohen tubacionet.

- Gjatë periudhës së zbatimit, temperaturat kanë qenë shumë të larta, duke bërë të pamundura realizimin e punimeve sipas planifikimit.

- Si rezultat i pandemisë, janë hasur vonesa në furnizimin me material si kasetat e matësve, mungesë e lëndës së parë nga prodhuesi.

Shtesa e afatit të përfundimit të punimeve është miratuar nga Bashkia Berat me shkresë nr. 4217/1 prot., datë 07.09.2021.

Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 437,990,401.3 lekë me TVSH. Akti i kolaudimit është hartuar me datë 24.10.2022, nga kolaudatori znj. M. K.me licencë nr. MK.....

Nga auditimi konstatohen mangësi si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mos marrje në dorëzim të punimeve në afatin e përcaktuar.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se ka kaluar një periudhë mbi 6 muaj referuar kolauditimit të punimeve dhe objekti nuk është marrë akoma në dorëzim nga Bashkia Berat.
Kriteri:	Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 10.2.
Ndikimi:	Mangësi në përllogaritjen e periudhës për të cilën punimet janë në përgjegjësinë e kontraktorit.
Shkaku	Mos ngritja e komisionit përkatës.
Rëndësia:	E mesme.
1.1. Rekomandimi:	Bashkia Berat të marrë masa për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve sipas kontratës përkatëse.

Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, pranë Bashkisë Berat z. L. B..

2. Titulli i gjetjes:	Punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.
Situata:	Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (librit të masave), rezulton se ka pasaktësi në lidhje me raportimin e sasisë së tubacioneve, sipas diametrave përkatës.

	<p>- Për linjat në zonën Otlak dhe Orizaj, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1. “Furnizim vendosje i tubave (përfshirë të gjitha mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin”, sasi të e raportuara në librin e masave dhe situacion përfundimtar, nuk është raportuar në mënyrë të saktë. Është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 50, Ø 63, Ø 75, Ø 110 dhe më pak për diametër Ø 140. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën 35,241 lekë. Po ashtu, për linjën në zonën Duhanas, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1 është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 75 dhe Ø 110. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën 56,435 lekë.</p> <p>- Në zonën Otlak-Orizaj, pas vendosjes së tubave për lidhjet e shtëpive, nuk është bërë rehabilitimi i shtresave asfaltike, në sasinë 76 m². Vlera 449,920 lekë (76 m² x 5,920 lekë/m²), është certifikuar më tepër. Mos rehabilitimi i rrugëve sipas specifikimeve, përveç vështirësisë që krijohen për përdoruesit e tyre, bën që dëmtimi i shtresave të rritet në mënyrë të vazhdueshme, duke çuar në degradimin e plotë të shtresave rrugore.</p> <p>- Në zonën Lapardha 1, rehabilitimi i sipërfaqes pas vendosjes së tubacioneve për lidhjen e shtëpive sipas zërit B.6.5 “Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare të rrugëve të asfaltuara”, është ndërtuar vetëm me binder dhe jo asfaltobeton. Për këtë zonë është certifikuar sasia 173.6 m², nga e cila sasia rreth 160 m², rezulton jo me shtresë asfaltike, por binder. Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, manuali nr. 3, çmimi për shtresë asfaltobeton me trashësi 6 cm është 2,049 lekë/m². Vlera 327,840 lekë (160 m² x 2,049 lekë/m²), është certifikuar në kundërshtim me specifikimet teknike. Mos realizimi i shtresave sipas përcaktimeve, rezulton me dëmtim të shpejtë të tyre, duke rritur shpenzimet për rehabilitimin e mëtejshëm të tyre.</p> <p>- Kutitë e matësve nuk janë veshur me polisterol në brendësi, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 6.3.2 “Materiali i kutive të matësve të ujit” ku përcaktohet: “<i>Trupi do të jetë me përmasa 570 x 370 x 120 mm, material llamarine çeliku ST235, 07/10 mm, shtresë me RAL7035 e cila do të vishet me polisterol EPS 15mm</i>”.</p> <p>- Në seksionin rrugor Ushqimore-Otlak, por dhe Lapardha 1, sa i takon lidhjeve të shtëpive të cilat ndërpresin segmentin rrugor, shtresat rrugore mbi kanalin e hapur për vendosjen e tubacioneve kanë pësuar ulje si pasojë e mos realizimit të ngjeshjes në parametrat e përcaktuara, por edhe si pasojë e përdorimit të materialit mbushës jashtë parametrave të kërkuar. Ky veprim është në kundërshtim me Specifikimet teknike, pika 4.2 “Shtresa bazë”, ku përcaktohet: “<i>Shtresa bazë do të thotë një shtresë e sipërfaqes së sipërme që mbështet drejtpërdrejt trafikun dhe/ose një shtresë menjëherë nën veshjen e sipërfaqes bituminoze. Trashësia minimale duhet të jetë 150 mm pas ngjeshjes së duhur. Materiali për shtresën bazë do të merret nga një burim i propozuar nga Kontraktori dhe aprovuar nga Inxhinieri. Nuk duhet të jetë plastike. Madhësia maksimale e çdo grimcë nuk duhet të kalojë 60 mm...</i>”.</p>
Kriteri:	Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve

	të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7. Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.
Ndikimi:	Realizimi i punimeve jo sipas specifikimeve dhe në raste i pa realizuar ndikon në eficiencën e investimit, pasi dëmtimi kryesisht i shtresave rrugore vazhdon jo vetëm për sipërfaqen nën punim, por dhe seksionin tjetër të rrugës.
Shkaku	Mos zbatimi i detyrimeve kontraktore.
Rëndësia:	E mesme.
2.1. Rekomandimi:	Bashkia Berat të marrë masa për ndalimin nga pagesa e garancisë së punimeve të vlerës 91,676 lekë , për përfitim të padrejtë nga ana e Kontraktorit BOE “R. & 2....” SHPK , si llogaritje të gabuara për dimensionet e tubacioneve.
2.2. Rekomandimi:	Bashkia Berat të kërkojë nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori marrjen e masave për rehabilitimin e shtresave rrugore të dëmtuara nga ndërhyrjet për vendosjen e tubacionit dhe të pa rehabilituara brenda periudhës së garancisë së riparimit të defekteve. Në rast të mos zbatimit sipas specifikimeve teknike, të zbritet vlera 777,760 lekë nga garancia e punimeve dhe të zbatohen sanksionet përkatëse, sipas dëmit të vlerësuar.

Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve BOE “4..... & I.”.

2. Mbi zbatimin e Kontratës “Blerje asfalti”, për vitin 2022.

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me nr. 497/1 prot., datë 04.07.2022, ndërmjet Bashkisë Berat përfaqësuar nga Titullari i AK z. B. Ç. dhe OE “Sh.” SHPK përfaqësuar nga z. Sh. K., me vlerë 44,828,400 lekë me TVSH. Afati i furnizimit është përcaktuar nga nënshkrimi i kontratës deri me datë 30.10.2022.

Kontrata përfshin furnizimin e 18,772 kg bitum M-3, 2250 ton binder, 1433 ton asfaltobeton dhe 275 m³ stabilizant, materiale të cilat do të përdoren për realizimin e shtresave asfaltike për 19 rrugë të brendshme dhe sheshe. Për furnizimin e materialeve është kontraktuar OE “Sh.”, ndërsa për zbatimin në terren është ngarkuar Agjencia e Shërbimeve pranë Bashkisë Berat.

Me fletë hyrje nr. 23, datë 10.07.2022, janë magazinuar 13590 kg bitum, 1590 ton binder, 872 ton asfaltobeton dhe 275 m³ stabilizant. Për marrjen në dorëzim të materialit është hartuar procesverbali nr. 1, datë 20.07.2022, nga z. E. A., z. D. L. dhe z. H. M.. Po ashtu sipas procesverbalit datë 04.11.2022, është marrë në dorëzim sasia 5182.5 ton kg bitum i lëngët, 660 ton binder dhe 561 ton asfaltobeton. Në procesverbale përcaktohet se komisioni kreu verifikimin dhe rezultoi se mallrat janë konformë specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk ka ndonjë shtyrje afati për zbatimin e kontratës.

Nga auditimi konstatohen mangësi si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangesi në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të investimit.
Situata:	<ul style="list-style-type: none"> - Në dosjen teknike të investimit është paraqitur një projektzbatim i cili nuk është nënshkruar nga personat e cituar, duke mos vërtetuar në këtë mënyrë procesin e ndjekur për hartimin e projektzbatimit, subjekti, apo personat të cilët e kanë realizuar etj. - Realizimi i punimeve është bërë nga Agjencia e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Berat, si dhe nuk është bërë asnjë prokurim për zbatimin e punimeve. - Nga ana e autoritetit Kontraktor, për mbikëqyrjen e punimeve nuk është përgjedhur ndonjë individ apo subjekt i licencuar.

	<p>- Në dosjen e investimit nuk rezulton dokumentacion mbi realizimin e shtresave rrugore, pas furnizimit me materialin për shtresat, dokumentacioni i cili ka të bëjë me:</p> <p>Dokumentacioni administrativo-ligjor për sipërmarrësin, si person juridik, dhe sheshin e ndërtimit, projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike, dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve, certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre, libri i masave etj.</p> <p>Sa më sipër arrihet në konkluzionin se realizimi i punimeve civile nga subjekte të pa licencuara, nuk jepet garanci për realizimin e investimit konformë kushteve teknike të zbatimit.</p> <p>- Nuk garantohet cilësia e materialeve të përdorura në ndërtim, për pasojë nuk garantohet jetëgjatësia e punimeve, rrjedhimisht eficaenca e përdorimit të fondeve.</p> <p>- Ndërtimi në përgjithësi dhe i infrastrukturës në këtë rast, kërkon realizimin e disa proceseve që kanë lidhje me përgjegjësinë e realizimit më cilësi, në sasi dhe sipas projekteve të miratuara, të mbikëqyrjes hap pas hapi dhe dokumentimit. Në mungesë të certifikatave të cilësisë së materialeve, në mungesë të testimit, në mungesë të librit të masave, nuk mund të jepet një opinion nëse punimet janë realizuar me cilësi dhe sasinë e kërkuar.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 5, 7, 8.</p> <p>- Udhëzimi i KM nr. 2, datë Kreu III, pika 9.</p>
Ndikimi:	Nuk jepet garanci nëse punimet janë realizuar në sasi dhe cilësinë e kërkuar.
Shkaku	Mos respektimi i dispozitave ligjore të fushës së ndërtimit
Rëndësia:	E Lartë.
1.1. Rekomandimi:	Bashkia Berat të marrë masat e duhura për realizimin e investimeve në respekt të dispozitave ligjore për realizimin e tyre. Krahas tenderimit për bazë materiale, duhet të bëhen tenderime për realizimin e punimeve nga subjekte të licencuara sipas objektit në të cilin prokurohet, si dhe realizimi i punimeve duhet të dokumentohet dhe raportohet për të garantuar realizim në sasi dhe cilësi.

2. Mbi zbatimin e kontratës “Blerje asfalti”, për vitin 2023.

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me nr. 32/1 prot., datë 17.01.2023, ndërmjet Bashkisë Berat përfaqësuar nga Titullari i AK z. B. Ç. dhe OE “Sh.” SHPK përfaqësuar nga z. Sh. K., me vlerë 29,054,100 lekë me TVSH. Afati i furnizimit është përcaktuar nga nënshkrimi i kontratës deri me datë 30.10.2022. Afati i zbatimit është përcaktuar 2 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës.

Kontrata përfshin furnizimin e 12,500 kg bitum M-3, 1750 ton binder, 841 ton asfaltobeton dhe 105 m³ stabilizant, materiale të cilat do të përdoren për realizimin e shtresave asfaltike për 19 rrugë të brendshme dhe sheshe. Për furnizimin e materialeve është kontraktuar OE “Sh.”, ndërsa për zbatimin në terren është ngarkuar Agjencia e Shërbimeve pranë Bashkisë Berat.

Me fletë hyrje nr. 5, datë 16.02.2023, janë bërë hyrje 6250 kg bitum i lëngë, 758 ton binder, 420 ton asfaltobeton dhe 50 m³ stabilizant. Sasitë e mësipërme janë marrë në dorëzim sipas procesverbalit datë 16.02.2023. Sasitë 6250 kg bitum i lëngët, 785 ton binder, 421 ton asfaltobeton dhe 55 m³ asfaltobeton, janë bërë hyrje me fletë-hyrje nr. 6, datë 03.03.2023 dhe janë marrë në dorëzim po në këtë datë nga komisioni përkatës. Në lidhje me zbatimin e kontratës në terren, problematika është e njëjtë me kontratën e nënshkruar në vitin 2022, trajtuar më sipër.

Konkluzion:

Realizimi i punimeve civile nga subjekte të pa licencuara, nuk jepet garanci për realizimin e investimit konformë kushteve teknike të zbatimit.

Nuk garantohet cilësia e materialeve të përdorura në ndërtim, për pasojë nuk garantohet jetëgjatësia e punimeve, rrjedhimisht efica e përdorimit të fondeve.

Ndërtimi në përgjithësi dhe i infrastrukturës në këtë rast, kërkon realizimin e disa proceseve që kanë lidhje me përgjegjësinë e realizimit më cilësi, në sasi dhe sipas projekteve të miratuara, të mbikëqyrjes hap pas hapi dhe dokumentimit. Në mungesë të certifikatave të cilësisë së materialeve, në mungesë të testimit, në mungesë të librit të masave, nuk mund të jepet një opinion nëse punimet janë realizuar me cilësi dhe sasinë e kërkuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. B. Ç..

2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 208/1 Prot, datë 10.03.2023, i ndryshuar, me objekt: “Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj

Bashkia Berat ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrikë.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit

LEJET E NDËRTIMIT DHE ZHVILLIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2022- 31.12.2022

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Berat, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Berat, janë miratuar **44 leje ndërtimi**, ndër të cilat leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **5 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **1 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë

miratuar **8 leje** ndërtimi, ndërsa leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **11 leje** ndërtimi, **7 leje** ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, **1 leje** ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, **4 leje** për ndryshim funksioni dhe **7 leje** ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen lejet e ndërtimit për ndërtime të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m² të miratuara nga Bashkia Berat, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022:

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
1	Certifikatë përdorimi	12	8
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	79	63
3	Leje infrastrukture	1	0
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	9	8
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	8	7
6	Leje për ndryshim funksioni	4	4
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	4	4
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	3	2
10	Leje rindertimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	32	28
12	Njoftim për fillim punimesh	21	19
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	0	0
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	14	11
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	6	5
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	2	1
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	7	7

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime

Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²							
Nr	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Nr. Prot.i aplikimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Vendimi Leje Ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit
1	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Godine 1 kat, sallë konferencash rruga Donika Kastrioti Berat.	354	E. G.	D. J.	Vendim Nr.204, datë 25/03/2022	18,057,914 lekë
2	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Godine banimi dhe sherbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nentoke, (kati per dhe parkim, dhe kati i pare 1/2 banim dhe 1/2 shërbim	3438	F. Sh.p. k	F. Sh.p. k	Vendim Nr.432, datë 14.07.2022	270,921,273 lekë
3	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	“Rindërtim i shkollës Babe Dude Karbunara”	4805	M. S.	Bashkia Berat	Vendim Nr.612, datë 14.10.2022	437,286,742 lekë
4	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Magazinë 1 kat	6503	Xh.	Xh.	Vendim Nr.88, datë 20.02.2023	10,930,477 lekë
5	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Objekt kulturi 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë	2389	A. A.	F.M.	Vendim Nr.343, datë 10.06.2022	23,158,261 lekë

me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m²:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit / Lekë
1.	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Godinë banimi dhe sherbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim	F. ShPK	Vendim Nr.432 datë 14.07.2022	270,921,273 Lekë
2.	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Godine 1 kat, sallë konferencash rruga Donika Kastrioti Berat	D. J.	Vendim Nr.204 datë 25/03/2022	18,057,914 Lekë
3.	Leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Objekt kulturi 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë	F. M.	Vendim Nr.343 datë 10.06.2022	23,158,261 Lekë
4.	Leje ndërtimi me sipërfaqe deri në 250 m ²	"Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti)	K. H.	Vendim Nr.636 datë 26.10.2022	4,617,928 Lekë
5.	Leje ndërtimi deri në 250 m ²	“Magazinë për bujqësinë 2 kat”	R.C.	Vendimi Nr.189, datë 16/03/2022	6,986,065 Lekë
6.	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtimin ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	“Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt ekzistues”	S. H.	Vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022	1,903,243 Lekë

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të

territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

Titulli i gjetjes 1: Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kushtet në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme të miratur për leje ndërtimi, me objekt:

1. "Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)", për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja "30 Vjetori", Berat. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit evidentohet që nuk është respektuar lartësia maksimale e lejuar e godinës në bazë të Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin Nr.3, datë 29.12.2016. Në parametrat e lejuar të Njesisë 1/134, nga 26 metra që është e lejuar lartësia e godinës është 27,05 metra, sipas VKM-së 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Pasuria pozicionohet në njësinë 1/40 sipas PPV dhe me kategorinë e zhvillimit 100% zonë banimi. Objekti ka aplikuar për rikonstruksion dhe shtesë në godinën ekzistuese, për një pikë karburanti. Në bazë të VKM-së, datë 13.5.2015/ Neni 19/ Lejet e ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKT-ja, pika rr) pikat e furnizimit me karburant; Duke u bazuar tek të dhënat e njësisë 1/40, në kondicionet urbane përcaktohet zhvillimi me intensitet 0.7 dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 40 %. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, sipërfaqja e gjurmës është 118 m², ndërsa sipërfaqja e truallit është 190 m², me koeficient shfytëzimi të territorit 62 %, duke tejkuluar parametrat e lejuara në zonë.

3. "Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në pasaportën me numër 114, në njësinë 1/31, me kategorinë e lejuar banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 0.7, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 40% dhe lartësia maksimale e ndërtimit 9 metra. Njësia ka si kufizim ligjor që çdo zhvillim hoteli duhet të jetë sipas udhëzimeve të një plani veprimi për turizmin. Në dokumentacionin e pronësisë, pasuria në të cilën zhvillohet objekti i përket zonës kadastrale nr.8501, në pasurinë me nr. 9/39, me sipërfaqe truall 330 m² dhe sipërfaqe ndërtese 107.6 m². Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit është 427 m² dhe intensiteti i ndërtimit është 1.29 nga 0.7 i lejuar në bazë të përcaktimeve të nënnyesisë 1/31. Ndërsa gjurma e ndërtimit ka sipërfaqe 142 m² dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit nga 40 % është 43%. Lartësia maksimale e objektit është 10 metra nga 9 metra e lejuar.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Në bazë të Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor

- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 38, Intensiteti i ndërtimit (I), përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.

- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 39, koeficienti i shfrytëzimit të territorit.

- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 37, lartësia e ndërtimeve.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, ndikon në: a) lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; b) normat e lejuara të distancave; c) vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë; ç) vlerat e trashëgimisë kulturore në zonë; d) diellëzimin dhe orientimin; dh) respektimin e normave mjedisore e) infrastruktura publike; f) hapësirat publike.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masat e duhura për të verifikuar materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse, përpara miratimit të lejeve.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika në të cilën pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 2: Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës nuk janë respektuar sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat. Në pjesën perëndimore dhe lindore trajtimi i faqes së objektit është kallkan, nevojitet të respektojë distancën nga kufiri i pronës 1 metër. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, u evidentua që nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës në orjentimin perëndimor dhe orjentimin lindor. Distanca minimale që është respektuar është 0.72 m, 0.76 m.

2. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Objekti është në lartësinë e 2 kateve dhe distanca që duhet respektuar nga kufiri i pronës është 3 metra. Distanca minimale që është ruajtur është 2.6 metra, duke mos ruajtur distancën minimale të lejuar nga kufiri i pronës.

3."Rikonstrukcion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Në planvendosjen e paraqitur nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës në orjentimin perëndimor dhe lindor që variojnë nga 15-51 cm nga kufiri i pronës. Distanca që duhet respektuar nga kufiri i pronës në orjentimin perëndimor është 2 metra, për objektin në lartësinë e 1 kati, ndërsa në orjentimin lindor duhet të respektohet distanca 1 metër nga kufiri i pronës, për faqen kallkan.

4."Magazinë për bujqësinë 2 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R.C., me adresë Lagjja "Parangua", Berat. Pasuria pozicionohet në njësinë 4/33 sipas PPV dhe me kategorinë e zhvillimit 100% zonë bujqësore. Në dokumentat e pronësisë të ngarkuara në sistemin e-Leje, janë paraqitur dy pasuri për zhvillim, 1. pasuria në zonën kadastrale nr.1587, me nr. pasurie 1463/64, me llojin e pasurisë ullishte, me sipërfaqe totale 344 m² dhe 2. pasuria në zonën kadastrale nr.1587, me nr. pasurie 1512/3, me llojin e pasurisë arë, me sipërfaqe totale 575 m². Në bazë të Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Territorit, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016, pika 3.1.5 përcaktohet se në zonat që i përkasin kategorisë bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin në tokën bujqësore. Në bazë të pikës 3.1.5, shkronja g, përcaktohen ndërtimet për qëllime dhe në funksion të aktivitetit bujqësor që mund të ndërtohen në tokë bujqësore. Në bazë të Vendim Nr. 283, datë 1.4.2015, i ndryshuar, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", objekti magazinë bujqësore bën pjesë në tipologjinë e objekteve të përcaktuara në këtë vendim. Në kreun III përcaktohet se rregullat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim shërbejnë dhe janë të detyrueshme për zbatim nga ana e autoriteteve përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit për hartimin e dokumenteve të planifikimit në të gjitha nivelet. Në bazë të kreut II, pika 10, ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 1 m³/m²; b) Të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera. Në planvendosjen e miratuar objekti ruan distancë minimale nga kufiri i pronës 3 metra, nga 7 metra që duhet të respektohet, duke mos qenë në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin Nr.283. Gjithashtu vëllimi maksimal i objektit tejkalon intensitetin e ndërtimit 1 m³/m²;

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 34, pika 4, distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër.

-Në bazë të Vendim Nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar, kreu II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe çënon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D. me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021 e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen e mënyrës dhe mungesën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.

Titulli i gjetjes 3: Mosparaqitja dhe mungesa e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet mënyra e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratur për leje ndërtimi, me objekt:

1. "Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)", për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja "30 Vjetori", Berat. Në planvendosje nuk pasqyrohet mënyra e aksesimit në parkimin nëntokësor, që pozicionohet pas parcelës. Mënyra e vetme e aksesit është nëpërmjet pronave të tjera kufizuese dhe jo nga aksi kryesor rrugor.

2. "Rikonstrukcion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Pasuria 11/710, në zonën kadastrale 8501, nuk ka akses nëpërmjet infrastrukturës rrugore dhe mënyra e vetme e aksesit është nëpërmjet një pasurie tjetër, e cila në bazë të kartelës së pasurisë me Nr. 11/711, në zonën kadastrale 8501 është pronë shtet. Distanca nga aksi kryesor rrugor është 47 metra.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Neni 14, pika 2, në të cilën përcaktohet se dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i mënyrës së aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimit dhe mungesa e saj ndikon në cënimin e pasurive të tjera me anë të të cilës kufizohet pasuria.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi. Gjithashtu në parcelat të cilat pozicionohen në zonat e reja për zhvillim dhe kufizohen/bëjnë pjesë në njësi për të cilat është parashikuar zhvillimi i Planit të Detajuar Vendor, bashkia të procedojë me miratimin e PDV-së për të gjithë zonën, në të cilën parashikohet edhe koncepti për infrastrukturën e re, e më pas të vijojnë me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021 e në vijim

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktikë tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores së planit të miratuar.

Titulli i gjetjes 4: Mospërputhja ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores së planit të miratuar.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar tipologjia e ndërtimit nuk përkon me tipologjinë e objekteve të lejuara në njësinë në të cilën zhvillohet, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi me objekt:

1. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë 1/165, me kategorinë e lejuar banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 0.5, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 30% dhe lartësia maksimale e ndërtimit 9 metra. Në njësinë në të cilin ndodhet pronësia, tipologjia e lejuar e ndërtimit sipas PPV është V.-V.. me densitet të mesëm. Zonë me dominancë tipologjike një familjare në më shumë se 80% ndërtesave, ku madhësia mesatare e parcelës është 500-1000 m². Tipologjia e kultit (fetare) nuk përkon me tipologjinë e lejuar të ndërtimit.

2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr.636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Pasuria pozicionohet në njësinë 1/40 sipas PPV dhe me kategorinë e zhvillimit 100% zonë banimi. Objekti ka aplikuar për rikonstruksion dhe shtesë në godinën ekzistuese, për një pikë karburanti. Në bazë të VKM-së, datë 13.5.2015/ Neni 19/ Lejet e ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKT-ja, pika rr, pikat e furnizimit me karburant;

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i mënyrës së aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimit dhe mungesa e saj ndikon në çënimin e pasurive të tjera me anë të të cilës kufizohet pasuria.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar tipologjinë e ndërtimit të lejuar në bazë të njërive strukturore, të përcaktuara sipas planit dhe të zhvillojë propozime të reja për përmirësim e Planit të Përgjithshëm Vendor, në bazë të nevojave dhe kërkesave të reja të zhvillimit të qytetit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të rilevimit topografik që pasqyron gjendjen ekzistuese të parcelës e objekteve me të cilat kufizohet dhe mospasqyrimi i duhur i planvendosjes në të cilën evidentohet njolla e objektit mbi parcelën që do të zhvillohet.

Titulli i gjetjes 5: Mosparaqitja e saktë e rilevimit topografik që pasqyron gjendjen ekzistuese të parcelës e objekteve me të cilat kufizohet dhe mospasqyrimi i duhur i planvendosjes në të cilën pasqyrohet njolla e objektit mbi parcelën që do të zhvillohet.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, në rilevimin topografik nuk pasqyrohej gjendja e reale e parcelës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, pasi nuk evidentohen ndërtimet sipas gjendjes ekzistuese.

Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: 1."Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Në shqyrtimin e dokumentacionit teknik të ngarkuar në sistemin e-leje, në projektin e paraqitur nuk pasqyrohet gjendja e ndërtesës ekzistuese, por vetëm objekti i ri i propozuar. Në bazë të fotove të gjendjes ekzistuese të dokumentuara në relacionin teknik paraqitet vetëm një strehë me konstruksion metalik dhe dy kolona, por jo ndërtesë tek e cila mund të realizohet një shtesë anësore si në aplikimin e zhvilluar për leje ndërtimi. Në dokumentacionin e pronësisë me numër pasurie 11/710, në zonën kasdatrale 8501, paraqitet sipërfaqja e pasurisë 190 m² truall dhe 63.1 m² ndërtesë. Gjurma e objektit në hartën treguese të pasurisë dhe rilevimi topografik nuk përputhen me gjendjen aktuale.

2. "Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Në planvendosjen e miratuar të ngarkuar në sistemin e-leje, paraqitet plansistemi i objektit, por nuk paraqitet njolla e objektit të ndërtimit mbi hartën e gjendjes ekzistuese. Gjithashtu nuk paraqiten numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet dhe nuk janë reflektuar të gjitha distancat nga kufiri i pronës.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 15, pika c, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi është edhe plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i saktë dhe me të gjithë elementët e ndërtimit të gjendjes ekzistuese, ndikon në zhvillimin e parcelës e në treguesit e zhvillimit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merrren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në

sistem, si edhe të verifikojë planvendosjen që të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konform kushteve teknike të projektimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021 e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

Titulli i gjetjes 6: Mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni Teknik i nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratur për leje ndërtimi, me objekt:

1. “Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat. Nga verifikimi I dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-Leje, projekti konstruktiv i paraqitur në dosjen teknike të aplikimit për leje ndërtimi është i njëjtë me projektin arkitektonik. Projekti konstruktiv nuk është realizuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit.

2. “Objekt kulturi 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni “M.”, me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.

3. “Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”, Berat. Duke qenë që objekti zhvillohet në një tokë bujqësore, nevojitet të paraqitet edhe VNM-ja. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15, pika ii), në dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit është edhe projekti konstruktiv, i cili nuk është realizuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit.

-Në bazë të Ligjit Nr. 10.440, datë 7.7. 2011, të ndryshuar, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me leje ndërtimi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë, duke cënuar qëndrueshmërinë e objektit dhe ndikuar në mjedis.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kritere të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 7: Aplikimi i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me kategorinë e lejes.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kritere të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, gjetje e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi me objekt:

“Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 256.83 m² dhe aplikimi duhet të bëhet për objekte më sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 250 m² dhe jo për ndërtim deri në 250 m². Ndryshimi i kategorisë së aplikimit, ndryshon edhe kërkesat në lidhje me dokumentacionin që nevojitet të dorëzojë në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit në bazë të VKM-së 408, neni 15, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi, pika 1/3, në të cilën përcaktohet se: “Për ndërtime të reja apo shtesa, me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m², nuk janë të detyrueshme projektet e instalimeve, polica e sigurimit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale, si dhe mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, me kushtin që zbatuesi të dorëzojë një deklaratë noteriale, me të cilën të konfirmojë, nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale, se objekti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektin përkatës.”

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi në kategorinë e ndryshme të lejes së ndërtimit, ndikon në mosplotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që nevojitet për të miratuar lejen e ndërtimit dhe ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me legjislacionin në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje aplikimin e lejeve të ndërtimit dhe sipërfaqeve të ndërtimit, në mënyrë që mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist per planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislationit të posacëm në fuqi.

Titulli i gjetjes 8: Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislationit të posacëm në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. "Magazinë për bujqësinë 2 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja "Parangua", Berat. Nga verifikimi i dokumentacioni të ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet mendimi i institucionit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Nenit 10/1, Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi.

-Në bazë VKM-së 408, të Nenit 14, pika 3, përcaktohet se: "Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislationit të posacëm në fuqi."

Ndikimi/Efekti: Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislationit të posacëm në fuqi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit pa qenë në konformitet me legjislationin në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist per planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet planvendosjes së miratuar dhe realizimit në terren të njollës së ndërtimit.

Titulli i gjetjes 9: Mosrealizimi i pozicionimit të njollës së ndërtimit në përputhje me planvendosjen e miratuar.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në realizimin në terren të njollës së ndërtimit dhe pozicionimit të saj, nuk përputhet me planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit, gjetje e cila u evidentua në rastit e mëposhtme me objekt: “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Nga verifikimi i fotove ajrore gjurma e objektit nuk është realizuar në përputhje me planvendosjen e miratuar. Në realizimin e ndërtimit të objektit evidentohet spostimi i gjurmës së ndërtimit, duke u pozicionuar ngjitur me kufirin e pronës.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-VKM-ja 408, Neni 27/1, Mbikëqyrja e punimeve, pika 3, në të cilën përcaktohet se: "Autoriteti vendor mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, sipas gjendjes faktike të objektit, brenda 15 ditëve pune nga depozitimi i tyre. Në mungesë verifikimi nga autoriteti vendor, brenda afatit të mësipërm, subjekti ndërtues mund të kalojë në fazën vijuese. Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollin e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle."

- Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, i ndryshuar, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 42, pika 4, përcaktohet se: "Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi."

Ndikimi/Efekti: Mungesa e verifikimeve në terren dhe mbajtja e aktkontrolleve ndikon në zhvillimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e miratuar, duke mosrespektuar parametrat e distancave nga kufiri i pronës dhe ndërmjet objekteve dhe ndikon në çënimin e zhvillimit të objekteve të reja në parcelat me të cilat kufizohet.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa për të mbajtur aktkontrollin për fazat e ndërtimit që vijnë pas njoftimit të fillimit të punimeve dhe verifikimin e konformitetit të tyre gjatë ndërtimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat;

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me moszbatimin në mënyrën e duhur të kontributit privat në favor të fondit publik të banesave sociale.

Titulli i gjetjes 10: Mosrealizimi i nënshkrimit të kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se kontributi privat në favor të fondit publik të banesave sociale nuk është realizuar në bazë të legjislacionit në fuqi, duke mos u nënshkruar kontrata mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të

banesave sociale. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat. Objekti ka sipërfaqe banimi 6697.46 m², sipërfaqe për të cilën nevojitet të kontribuojë në krijim e fonndit publik, në bazë të Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Neni 19, i cili përcakton si më poshtë: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.” Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk paraqitet marrëveshja për kalimin e sipërfaqes ndërtimore të favor të fondit publik. Në vend të saj kanë konvertuar sipërfaqen ndërtimore në vlerë monetare. Këtë veprim e kanë mbështetur në Vendim Nr. 49, datë 27/07/2022, të Këshillit Bashkiak, veprim që nuk është në përputhje me ligjin Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social.

Gjithashtu në llogaritjen e saj nuk përfshihet llogaritja e saktë:

$$6697,46 \text{ m}^2 \times 3\% = 200,92 \text{ m}^2$$

$$200,92 \text{ m}^2 \times 41400 \text{ leke/m}^2 = 8,318,245.32 \text{ Lekë}$$

Ndërsa në llogaritjen e vlerës sipas bashkisë është 7,290,540 Lekë, me një diferencë prej 1,027,705.32 Lekë.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: -Në bazë të Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Neni 19.

Ndikimi/Efekti: Konvertimi i sipërfaqes së ndërtimit në vlerë monetare ndikon në moszbatueshmërinë e ligjit, pasi sipërfaqja ndërtimore nuk kalon në mënyrë të drejtpërdrejtë në favor të fondit publik të banesave sociale si parashikohet sipas bazës ligjore. Gjithashtu mënyra e konvertimit të sipërfaqes së ndërtimit në vlerë monetare, lë hapësirë për mosllogaritjen në mënyrën e saktë dhe pasi kalon në të ardhurat e bashkisë nuk parashikohet me qartësi dhe me transparencë menaxhimi i tyre.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPZHT Berat të merren masa që të realizohet nënshkrimi i kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale dhe të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me përcaktimin sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në duke ju referuar vendimit të Këshillit Bashkiak.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipër me ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist per planifikimin e territorit dhe tegjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim; Z.E. S., me detyrë specialist projektimesh dhe regjistrin elektronik nga periudha 20/08/2021e në vijim.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua **1** praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosllogaritjen në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 11: Mosllogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Sallë Konferencash Berat", për të cilën është marrë vendimi Nr.204, datë 25/03/2022, me zhvillues D. J., në adresën lagjja "Donika Kastrioti" Berat. Mënyra e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në bazë të preventivit është si më poshtë: $18,057,914 \text{ Lekë} \times 3\% = 541,737.42 \text{ lekë}$. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Berat është 337,837 lekë, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën 541,737.42 lekë, e pasqyruar mësipër. Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme, prej 203,900.42 lekë përbën të ardhura të munguar shkaktuar Bashkisë Berat.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë.

-Ligji Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritjet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Ndikimi/Efekti: Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Berat.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 203,900.42 lekë, që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.L. B., me detyrë nënkryetar i Bashkisë Berat; Znj.E. N., me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe tegjistrit elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim.

Lidhur me objektin e mësipërm, me anë të email-it, në datë 16.05.2023 është observuar nga nënkryetari i bashkisë, Z.L. B., nga Znj.E. N. dhe nga Z. E. S., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)", për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja "30 Vjetori", Berat, shprehen se: "1. Bashkia Berat duke u mbështetur në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së planit të miratuar dhe vendimit të keshillit Kombëtar të territorit nr.3 date 29.12.2016 është miratuar leja e zhvillimit nr.396 date 22.06.2022, e cila është pjesë e

nenjesis 1/134 e cila eshte e njejte me nenjesin 1/133, te gjitha karakteristikat e objektit jane në perputhje me nenjesin, i respekton parametrat sipas kushtit te Planit te Pergjithshem Vendor ku eshte miratuar dhe leja e ndertimit. 2. Ne baze te Vkm 408 date 13.05.2015 Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit, neni 35 distancat e lejuar nga kufiri i pronës percaktohet si gjatesia pingule e faqes së ndertimit me kufirin e prones dhe eshte e barabarte me nr e kateve mbi toke +1 m duke qene se ne pjesen perendimore dhe lindore trajtimi i faqes se objektit është kallkan eshte rrespektuar distanca nga kufiri i prones ne baze te vkm 408 neni 34.4 ne te dyja jane rrespektuar distancat nga kufiri i pronesisë orjentim lindore dhe perendimore ku maksimalia e distaneces anen lindore 3.08 m, 1.02 m dhe ne ane perendimore eshte 1.79 m, 4.76 m. 3. Nga shqyrtimi i projektit te mbeshetur ne PPV me vendim nr.3 date 29.12.2016 dhe mbeshetur ne VKM 408 date 13.05.2015 Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit, objekti (soleta) e katit te fundit eshte e mbeshetur ne parametret e njesis 1/134 ku eshte 26 m, te gjitha lartesisë e kateve jane bere sipas parametrave qe kerkon rregullorja e PPV-se dhe VKM 408 date 13.05.2015 Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit duke u zbatuar standartet dhe normat e projektimit, parapet i taraces eshte nje kusht teknik i cili kerkohet per zbatimin e normave te sigurise ne objekt dhe si i tillë nuk mund te meret si lartesi objekti pasi objekti ne vetveti i ploteson kushtet dhe standartet e projektimit sipas rregullores. 4. Ne planvendosje eshte pasqyruar aksesin nga ana funksionale per parkimin nentokesor per te siguruar nje zgjidhje racionale per te pasur nje funksion teknikisht te saktë per objektin dhe me zhvillimin e zones eshte i arritur aksesimi. 5. Objekti ka nje siperfaqe banimi 6697.46 m² siperfaqe per te cilen duhet te kontribuoj per krijimin e fondit publik ne baze te ligjit 22/2018 per stresim social neni 19 i cili percakton si meposhte, cdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale dhe vendimit nr 49 date 27.07.2022 te keshillit Bashkiak ku fondet ne baze te ligjit 22/2018 Per strehimin social do te kalojne per zgjidhen e strehimit social. Gjithashtu ne llogaritjen e siperfaqes duke u mbeshetur ne Ligjin 22/2018 cdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale. Prandaj siperfaqja funksionale banim eshte siperfaqja e cila perdoret per te vetmin qellim banim dhe e cila ne momentin qe mbaron objekti merr certifikat pronesie, pra nje dokument ligjor. Siperfaqja ne lejen e miratuar eshte $6697.46 \times 3\% = 200.92 \text{ m}^2$.

$200.92 \times 41400 \text{ leke/m}^2 = 8,318,245.32 \text{ Leke}$.

Ndersa llogaritja nga ana jone eshte bere ne baze te procedure se siperpermendur e cila del me me vleren prej $5870.42 \text{ m}^2 \times 3\% = 176.1 \text{ m}^2$.

$176.1 \text{ m}^2 \times 41400 \text{ leke} = 7,290,540 \text{ leke}$ sipas akt-marveshjes lidhur midis paleve.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, në raport me përcaktimin e njësisë së cilës i përket parcela në të cilën do të zhvillohet objekti në lejen e ndërtimit, duhet të jetë e njëjtë me përcaktimin e njësisë në lejen e zhvillimit. Diferenca e kriterëve ndërmjet dy parcelave është nevoja për zhvillimin e Planit të Detajuar Vendor përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Në lidhje me respektimin e distancës nga kufiri i pronës, në bazë të VKM-së 408, neni 34, pika 4, përcaktohet se: “Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra-tjetrës dhe për të cilat nuk sigurohet deklaratë e të dyja palëve për kallkan, në kushtet e moscenimit të sigurisë së secilit objekt duhet të jetë jo më pak 2 (dy) metra, ku secila ndërtesë mbart detyrimin për respektimin e distancës jo më pak se 1 (një) metër nga

kufiri i pronës.” Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, distanca e objektit nga kufiri i pronës është më pak se 1 metër, duke cënuar sigurinë e objekteve. Përsa i përket respektimit të lartësisë së lejuar të ndërtimit në bazë të PPV-së, duke u bazuar në VKM-në 408, neni 37, pika 1, gërma a, përcaktohet se: “Lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;”, pra duke përfshirë edhe lartësinë e parapetit. Në lidhje me aksesin e parkimit nëntokësor nuk evidentohet në materialet e ngarkuar në sistem një mënyrë aksesimi që të përshkojë në parcelën që do të zhvillohet ndërtimit, pa cënuar parcelat e tjera me të cilat kufizohet objekti. Lidhur me kontributin privat në favor të fondit publik të banesave sociale, në bazë të Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Neni 19, përcaktohet se: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërbllim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.” Duke u bazuar në ligjin e sipërcituar, nevojitet të realizohet nënshkrimi i kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale dhe të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me përcaktimin sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në duke ju referuar vendimit të Këshillit Bashkiak.Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: ”Sallë Konferencash Berat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.204, datë 25/03/2022, me zhvillues D. J., në adresën lagjja “Donika Kastrioti” Berat, shprehen se: “1.Ne baze te Planit te Pergjithshem Vendor te miratuar me Vendim e Keshillit Kombetar te Territorit Nr.3 date 29.12.2016 zona ne te cilen zhvillohet objekti bene pjese ne njesine 1/163 dhe ploteson kondicionte urbane sipas kesaj rregullore te PPV-se. 2.Duke u bazuar ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” te ndryshuar ne baze te neni 27 taksa e ndikimit në infrastrukture, pika 1 percakton se : Baza e taksës është vlera në leke e investimit të ri që kërkohej të kryhej sipas preventivit ose vlera në leke e cmimit të shitjes për meter katror të investimit të ri, menyrja e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukture për këtë rast është bërë në bazë të sipërfaqes së ndërtimit ku vlera është 337,837 leke, ndërsa me preventivin vlerë është 541,737.42 leke dhe për arketimin e diferencës së ndërmjet dy vlerave të mesiperme do vazhdohej procedura që kjo diferencë të arketohet në Bashkinë Berat.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, të vijohet më tej me procedurat për arketimin e diferencës së vlerës, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat, shprehen se: “1.Në bazë të Planit të Përgjithshëm dhe rregullores së planit të miratuar me vendimin e këshillit kombëtar të territorit Nr.3 datë 29.12.2016 zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë 1/165 dhe nga

kerkesat e qytetareve lindi nevoja për ndërtimin e këtij objekti. Në lidhje me pikën 4 ku citoni se gjurma e objektit nuk është realizuar në perputhje me planvendosjen e miratuar dhe nga fotoja ajrore e realizimit të objektit në të cilën evidentohet spostimi i gjurmës së objektit duke u pozicionuar ngjitur me kufirin e pronës ju sqarojme se nga ana e zhvilluesit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion tekniko ligjor për kontrollin e objektit nga ana jone, zhvilluesi nuk ka bërë asnjë njoftim për akt kontrollet, si piketimi i objektit, ngritje kantieri, kuota 0.00 etj.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, përsa i përket ndryshimit të tipologjive të ndërtimit të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, duke qenë që PPV është miratuar në vitin 2016, bashkia mund të zhvillojë propozime të reja për përmirësim e Planit të Përgjithshëm Vendor, në bazë të nevojave dhe kërkesave të reja të zhvillimit të qytetit, përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Në lidhje me zhvillimin në terren të lejes së ndërtimit, në bazë të VKM-së 408, Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, në të cilën përcaktohet se: "Autoriteti vendor mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas shkronjave "a", "c", "ç" dhe "dh", të pikës 1, sipas gjendjes faktike të objektit, brenda 15 ditëve pune nga depozitimi i tyre. Pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe pas njoftimit të fillimit të punimeve të ndërtimit nevojite të mbahen aktkontrollet për fazat e ndërtimit dhe verifikimin e konformitetit të tyre gjatë ndërtimit nga autoriteti vendor. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjia "Clirim", Berat, shprehen se: "Pasuria pozicionohet në njesinë 1/40 sipas PPV, dhe aplikimi është bërë për rikonstruksion dhe shtesë në godinën ekzistues i cili ka qenë ekzistues dhe më para, duke parë dhe dokumentin e pronësisë. Në bazë të Vkm 408 datë 13.05.2015 Per miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, neni 35 distancat e lejuar nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia pingule e faqes së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me nr e kateve mbi tokë +1 m duke qenë se në pjesën perëndimore distanca është 2 m dhe në orjentimin lindor trajtimi i faqes së objektit është kallkan dhe leja është marrë për rikonstruksion objekti pasi ka dokument pronësie objekt është respektuar distanca nga kufiri i pronës në baze të vkm 408 neni 34. Pasuria me nr 11/710 ZK 8501 lidhur me infrastrukturen rrugore nuk ka akses por duke qe se pasuria me nr.11/711 ZK 8501 është në pronësi Shtet, krijohet mundësia e aksesimit me infrastrukturen rrugore duke bërë të mundur nëpërmjet procedurave për marrje me qera dhe sigurohet aksesueshmeria.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, përsa i përket objektit ekzistues, nga verifikimi në terren figuron vetëm një strukturë metalike, e cila nuk ka të njëjtin konfigurim me gjurmën e paraqitur në planin e rilevimit. Gjithashtu në projektin e ndërtimit të paraqitur në aplikimin për shtesë objekti, nuk pasqyrohet projekti i gjendjes ekzistuese të objektit, por vetëm ndërtimi i ri. Përsa i përket aksesit në pronësi, një nga kriteret për miratimin e lejes së ndërtimit është aksesimi në parcelë nëpërmjet infrastrukturës kryesore dhe dytësore. Mënyra e aksesimit në parcelë duhet të jetë e përcaktuar përpara miratimit të lejes së ndërtimit dhe duhet të pasqyrohet në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: "Magazinë për bujqësinë 2 kat", për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R.C., me adresë Lagjia "Parangua",

Berat, shprehen se: 1.Pasuria pazicionohet në njësinë strukturore 4/33 sipas PPV dhe me kategorinë e zhvillimit 100% bujqësi, dokumentat e pronësisë janë dy pasuri me nr.1463/64 ZK 1587 dhe pasuria me nr.1512/3 ZK, objekti ndërtohet ne pasurine me nr.1512/3 ZK 1587 e llojit arë me siperfaqe totale 575 m², dhe procedura është bërë në bazë të rregullores se PPV-se dhe dokumentat tekniko ligjore janë proceduar me zbatimin e VKM 408 date 13.05.2015 per miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit. 2. Në bazë te Vkm 408 date 13.05.2015 Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit, neni 35 distancat e lejuar nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatesia pingule e faqes së ndertimitme kufirin e pronës dhe është e barabarte me nr e kateve mbi toke +1 m dhe në këtë rast kemi proceduar me VKM e siperpermendur. 3.Aplikimi për rastin në fjale ka qenë për leje ndërtimi të ri deri në 250 m² dhe nuk është kërkuar Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, duke u bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016, pika 3.1.5 përcaktohet se në zonat që i përkasin kategorisë bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndërtimin në tokën bujqësore. Në bazë të pikës 3.1.5, shkronja g, përcaktohen ndërtimet për qëllime dhe në funksion të aktivitetit bujqësor që mund të ndërtohen në tokë bujqësore.Në lejen e ndërtimit aplikohet për zhvillimin e një objekti në funksion të bujqësisë dhe që zhvillohet në një parcelë me statusin arë. Duke ju referuar PPV dhe Vendimit Nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, objekti magazinë bujqësore bën pjesë në tipologjinë e objekteve të përcaktuara në këtë vendim dhe duhet të zhvillohet në bazë të kondicioneve të përcaktuara në këtë vendim. Përsa i përket Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duke qenë që objekti zhvillohet në një tokë bujqësore dhe ndërtimi ndikon në çënimin e tokës bujqësore, duhet pajisur edhe me VNM-në. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektin: “Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat, shprehen se: “Në bazë të Planit të Përgjithshëm dhe rregullores së planit te miratur me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.3 date 29.12.2016, zona në të cilën ndodhet objekti është një zonë e cila kërkon zhvillim dhe mbushje urbane dhe për këtë arsye është lejuar rikonstruksioni dhe ndërtimi i ketij objekti që zona të marrë një zhvillim urbanistik dhe të rrisin qasjen në zonë.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në pasaportën me numër 114, në njësinë 1/31, sipas së cilës janë të përcaktuara kondicionet urbane që nevojitet të plotësojnë zhvillimet e ndërtimeve të reja. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me Nr. 208/1 Prot., datë 10.03.2023, i ndryshuar, me objekt: **“Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IVMT), prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

-Auditim mbi plotësimi i kritereve arsimore për punonjësit e IMT, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” etj;

- Auditimi mbi vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi

- Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT.

- Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (neni 81-Inspektimi, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, etj.).

1.Në lidhje me plotësimin e kritereve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Berat, dy punonjës nga 4 punonjës të inspektoriatit të mbrojtjes së territorit, nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës, të paraqitur në tabelën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes 1: Mosplotësimi i kritereve arsimore i punonjësve të IVMT-së.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Berat, 1 kryeinspektorë dhe 1 inspektor nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë: 1.Z.G. H., me pozicion kryeinspektor, ka përfunduar arsimin e lartë në akademinë ushtarake; 2.Z.P.I., me pozicion inspektori ka diplomë masteri profesional, në pedagogji me profil didaktikë;

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: Ligji Nr.183/2014, datë 24.12.2014, neni 11,të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit përcaktohet se: "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit".

Ndikimi/Efekti: Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Berat të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: I.Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat

2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT. Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Berat, gjatë periudhës 01.01.2022 -31.12.2022, ka marrë 14 vendime për "Dënim me gjobë", të pasqyruara në tabelën e evidentuar në aktkonstatimin përkatës për mbulimin e kësaj pike të drejtimit të auditimit të datës 05.05.2023 dhe Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes 2: Moslikujtimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Berat.

Situata: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Berat, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, ka marrë 14 vendime për "Dënim me gjobë", nga të cilat 6 janë likuajduar, ndërsa 8 vendime janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 1 vit, 1,350,000 lekë. Vendimet për gjobë janë dhënë në vitin 2022 dhe në vitin 2023 është vijuar me kërkesë për urdhër ekzekutimi.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Ligji Nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar, neni 5.

-Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 9/neni 22.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Berat nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 1,350,000 lekë.

Për sa më lart, për vendimet e gjobave të pa arkëtuara mbajnë përgjegjësi: Z.E. D., me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.G. H., me pozicion Kryeinspektori IVMT Berat, nga periudha 13.01.2021 e në vijim; Z.S. B., me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 10.04.2020-31.03.2023; Z.P. I., me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 23.02.2022-16.11.2022;

3. Në raport me vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IVMT-së, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Më poshtë pasqyrohet tabela e vendimeve "Për prishje objekti", për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe vendimet e ekzekutuara:

Nr.	Emër	Mbiemër	Nr.i Vendimit	Datë	Adresa	Proçes gjyqësor
1	B.	N.	279	05.05.2022	Nj. Administrative Roshnik, Fshati Roshnik	Proçes gjyqësor nr 2320/1 prot. datë 19.12.2022
2	P.	Z.	280	26.05.2022	Rajoni nr.1 Lagja Çlirim	Proçes gjyqësor nr 748 prot. datë 07.02.2022
3	R.	B.	581	06.10.2022	Rajoni nr.1 Lagja Barikad	Prishur

Në bazë të vendimeve dhe të dhënave të vendosura në dispozicion, janë marrë 3 vendime për prishje objekti, nga të cilat 1 është ekzekutuar dhe 2 nuk janë ekzekutuar, pasi janë në proces gjyqësor.

4. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimin në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes 1: Mospërputhja ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimin në terren të ndërtimit.

Situata: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara u konstatuan ndryshime në realizim e objektit nga projekti i ndërtimit dhe pozicionimi i gjurmës së ndërtimit në ndryshim nga planvendosja e miratuar. Me ndryshimet e evidentuara gjatë realizimit të punimeve në terren, ndërtimet nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara dhe nuk respektojnë zhvillimin e ndërtimeve sipas rregullores së planifikimit të territorit në fuqi.

1. “Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”, Berat. Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit evidentohet që realizimi i objektit nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit, kryesisht pjesa e hyrjes dhe aksesit në objekt, duke përfshirë edhe shkallët. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Berat, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit 107, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundravajtje administrative dhe ligji 9780, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

2. “Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat.

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit evidentohet që realizimi i objektit nuk përputhet plotësisht me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Berat, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit 107, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundravajtje administrative dhe ligji 9780, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

3. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni “M.”, me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit dhe nga foto ajrore evidentohet që pozicionimi i objektit në parcel nuk përkon me planvendosjen e miratuar. Me ndryshimin e pozicionit të gjurmës së ndërtimit, ndryshon raporti i distancave ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës dhe ndërmjet objekteve që kufizohet, duke mos respektuar distancat minimale që duhet të ruajë, në bazë të legjislacionit në fuqi. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Berat, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit 107, Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundravajtje

administrative dhe ligji 9780, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

Kriteri: Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Ligji Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 51, Inspektimi:

-Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 5, detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës.

-Ligji Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 12, ushtrimi i kontrollit

Ndikimi/Efekti: Zbatimi i realizimit të punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjisllacionin në fuqi. Ndryshimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Berat

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga IVMT Berat të merren masa në vijimësi për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë problematikat që konstatohen nga kontrolli i kryer, duke ekzekutuar vendimet e marra.

Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.E. D, me detyrë Kryetari i Bashkisë Berat; Z.G. H., me pozicion Kryeinspektori IVMT Berat, nga periudha 13.01.2021 e në vijim; Z.S. B., me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 10.04.2020-31.03.2023; Z.P. I., me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 23.02.2022-16.11.2022.

Lidhur me objektin e mësipërm, me anë të email-it, në datë 16.05.2023 është observuar nga ish inspektori i IVMT-së Z. A. K., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me auditim mbi ekzekutimin e vendimeve për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV, shprehet se: "Të gjitha gjobat e pa likujduara janë dërguar në Gjykat për kthimin e tyre në tituj ekzekutiv e rivendosje në afat dhe janë duke u ndjekur procedurat ligjore."

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendimet për gjobë janë dhënë në vitin 2022, ndërsa me kërksën për urdhër ekzekutimi është proceduar në vitin 2023. Në bazë të verifikimit të të dhënave të periudhës së ushtrimit të detyrës nga data 18.06.2021 deri në datën 01.03.2022, vendimet për gjoba datojnë pas periudhës tuaj të punësimit.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektoriati i mbrojtjes së territorit, shprehet se: "Dy objektet e pa prishura edhe pse janë në proces gjyqësor i janë dërguar listat për prishje Agjensisë së Shërbimeve për të planifikuar e zbatuar prishjen, shtuar këtu edhe objektet e lëna nga kontrolli KLSH-së nga kontrolli mëparshëm."

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, në aktkonstimin e mbajtur janë evidentuar vetëm të dhënat në raport me ekzekutimin e vendimeve, duke qenë që janë në proces për ekzekutimin e tyre.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektet: 1.“Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”,Berat; 2. “Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 3.“Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat, shprehet se:" Une ish-Inspektori A. K. , kam qene ne krye te detyres vetem gjate periudhes 18.06.2021 deri ne date 01.03.2022. Nuk kam qene pjese e bashkise ne periudhen e dhenies se lejes pasi kisha dhene doreheqjen nga pozicioni inspektor tek IVMT Berat,dhe si rrjedhoje nuk mund te jem pergjegjes per inspektim pasi zhvendosjes nga puna.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, në bazë të verifikimit të të dhënave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe periudhës në të cilën keni ushtruar detyrën si inspektor i IVMT-së Berat, pretendimi juaj merret në konsideratë.

Lidhur me objektin e mësipërm, me anë të email-it, në datë 16.05.2023 është observuar nga kryeinspektori i IVMT-së Z. G. H., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me auditim mbi ekzekutimin e vendimeve për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV, shprehet se: "Të gjitha gjobat e pa likuajuara janë dërguar në Gjykat për kthimin e tyre në tituj ekzekutiv e rivendosje në afat dhe janë duke u ndjekur procedurat ligjore.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendimet për gjobë janë dhënë në vitin 2022, ndërsa me kërkesën për urdhër ekzekutimi është proceduar në vitin 2023. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektoriati i mbrojtjes së territorit, shprehet se: "Dy objektet e pa prishura edhe pse janë në proces gjyqësor i janë dërguar listat për prishje Agjensisë së Shërbimeve për të planifikuar e zbatuar prishjen, shtuar këtu edhe objektet e lëna nga kontrolli KLSH-së nga kontrolli mëparshëm.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga ana Juaj, në aktkonstimin e mbajtur janë evidentuar vetëm të dhënat në raport me ekzekutimin e vendimeve, duke qenë që janë në proces për ekzekutimin e tyre.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për objektet: 1.“Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja

“Parangua”, Berat; 2. “Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 3. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni “M.”, me adresë Lagjja “Uznove”, Berat, shprehet se: “Nga verifikimet e zhvilluara në terren disa objekte nuk janë aritur të verifikohen për shkak të mungesës së stafit të inspektorëve pasi në këte periudh ka qënë vetem një Inspektor në detyrë, sistemi i lejave nuk ka funksionuar, ngakrkesës së punës për lirim dhe prishjen e ndërtimeve në hapësirat publike për investimet që ka kryer Bashkia.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në zbatim të ligjit të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", Neni 15, përcakton se: "Veprimet ose mosveprimet e krye-inspektorëve/inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve të IKMT-së, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale ose jo, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë." Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të programit të auditimit nr. 208/1prot., datë 10.03.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Berat, referuar drejtimit të auditimit nr. 7, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1. Dokumentacioni i vënë në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve, planet e veprimit, shkresën brenda 20 ditëve për planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve;*
 - 2. Urdhërin për njohjen dhe zbatimin me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;*
 - 3. Dokumentacion mbështetës për realizimin e rekomandimeve;*
 - 4. Pyetësori i dërguar ndaj subjektit Bashkia Berat mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve;*
- Për sa më sipër konstatohet se:*

2.7.1 Hartimi i programit (Plan veprimet) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Me shkresën e KLSH nr. 55/15, datë 27.07.2022 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Berat, sipas Programit të Auditimit me nr. 55/1 prot. datë 18.01.2022, i ndryshuar.

Nga Bashkia Berat në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet me përjashtim të një rasti për masë administrative i cili nuk është pranuar nga Bashkia Berat.** Bashkia Berat ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Plan veprimi i masave për zbatimin e rekomandimeve janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. me shkresën nr. 4027prot, datë 16.08.2022.

Bashkia Berat ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit të cilën e ka dërguar me shkresën nr. 4026prot, datë 16.08.2022.

2.7.2 Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga Bashkia Berat, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*” rezulton se nga ana e Bashkia Berat është dërguar raporti mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor për zbatimin e rekomandimeve veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit funksional për KLSH-në, me shkresën nr. 520prot, datë 27.01.2023.

Titulli i gjetjes: *Mos raportim brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit dhe mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

Situata: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Berat ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1104/17 datë 07.10.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Berat nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “*Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij*”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatim i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Berat të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Berat me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

2.7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 25 masa organizative, 6 masa për shpërblim dëmi, 10 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efieciencë dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara. I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Berat t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa Disiplinore për 13 punonjësit e atakuar në material. Gjithashtu është rekomanduar Kryeinspektorit të IMTV, 2 masa administrative për dy mbikëqyrësa të punimeve referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit.

Titulli i gjetjes: Bashkia Berat nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 375/9 datë. 15.09.2022 i ka dërguar Bashkinë Berat Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin, për përmirësimin e gjendjes, është kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

-Nga 25 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 Masa Organizative, janë realizuar 1 masë, janë në proces 7 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.

-Nga 6 Masa Dëm Ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim 6 Masa, të cilat janë ende në proces zbatimi 6 masa.

-Nga 10 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 10 masa, të cilat janë në proces zbatimi 10 masa.

-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Berat: 1 rekomandim për 13 punonjës në lidhje me procedurat e prokurimit, i cili është i pa zbatuar, 1 rekomandim për 2 mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e punimeve i cili është realizuar, 1 rekomandim për 3 punonjës për probleme të konstatuara në fushën e IMT, i cili nuk është pranuar, pra i pa realizuar si dhe për 2 punonjës të PMZSH, i cili është realizuar. Gjithashtu është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezultoi e pa zbatuar.

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,

Shkaku: Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 1,422,101 lekë.

Ndikimi/Efekti: Ndikon në përmirësimin e proceseve të veptimtarisë së Bashkisë Berat.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe ato të realizuara pjesërisht si vijon;

Për 7 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, 3 masa janë pjesërisht të zbatuara si dhe për 14 masa organizative të pa zbatuara.

Për 6 masa dëm ekonomik, të cilat 1 masë është realizuar dhe 5 masa janë ende në proces zbatimi.

Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, nga të cilat janë 10 masa në proces zbatimi;

Për rekomandimin e lënë në lidhje me marrjen e masa disiplinore, të lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkia Berat, nga ku rezultoi asnjë masë e dhënë për 13 punonjës dhe një masë administrative të cilat janë pa realizuar.

Në mënyrë të detajuar po i paraqesim më poshtë:

Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, nga titullari i Bashkisë Berat është ngritur grupi i punës me nr. 4027prot, datë 16.08.2022, me përbërje z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë, zj. R. Sh. Drejtori i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, z. G. D. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mëshitetëse, z. S. T. me detyrë Drejtor i Taksave

dhe Tarifave Vendore, z. L. B. me detyrë Drejtor i Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, z. P. S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, z. E. K. Drejtor i Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit, z. G. H. me detyrë Kryeinspektor i IMVT, anëtarët e Njësisë së Prokurimit në vijim, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, Komisionet e shqyrtimit të ankesave, ku është hartuar Programi e Punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Zbatimin e rekomandimeve në rubrikat e masave respektive të detajuara në plan veprimin janë realizuar si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Berat nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, nuk është bërë përditësimi i saj duke mos reflektuar ndryshimet strukturore të bëra për periudhën objekt auditimi. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status “*ekselent*”, si dhe pozicione me status “*Grup i veçantë*”, ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017.

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm, u konstatua se kjo njësi ka ushtruar veprimtarin e saj me 2 auditues, nga 3 që përcakton kuadri ligjor. Nuk është realizuar numri i auditimeve konform planit vjetor të auditimeve dhe planeve strategjike të miratuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për plotësimin e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm me tre punonjës dhe kjo strukturë të realizojë numrin e

auditimive të planifikuara në planet vjetore.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2020 dhe vitin 2021 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2020 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,134,803 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 816,589 mijë lekë, ose në masën 72%, ndërsa për vitin 2021 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,256,645 mijë lekë, realizimi 979,512 lekë, ose në masën 78%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 174,671 mijë lekë, realizuar 89,288 mijë lekë, ose në masën 51 %, ndërsa për vitin 2021, vlera e planifikuar është 282,200 mijë lekë, realizuar 155,906 mijë lekë, ose në masën 55 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

3.1.Rekomandim: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar.

Në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

4.Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 është 95,527,220 lekë, krahasuar me vlerën në fillim të vitit ushtrimor prej 142,082,430 lekë, është ulur me 46,555,210 lekë, ose në masën prej 33%.

Edhe pse janë marrë masa të mira për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2021, konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor për të gjithë periudhën e auditimit. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime prej 75,938,443 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 11,002,467 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 4,954,630 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 3,380,140 lek, të tjera 251,540 lekë.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

5.Gjetje nga auditimi: Konstatohet se Bashkia Berat nuk ka krijuar Sektor të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në arkëtimin e të ardhurave pasi në këtë institucion evidentohet një numër i lartë i detyrimeve të, prej 15,154 taksapagues të kategorisë familjare dhe private në vlerën 236,557 mijë lekë.

Gjithashtu konstatohet se struktura organizative e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore nuk është plotësuar me të gjithë specialistët, pasi mungojnë në këtë strukturë specialisti për kontrollin e biznesit, specialisti për taksat dhe tarifave në Njësinë Administrative Sinje, agjenti për arkëtimet e taksave dhe tarifave të familjeve dhe bizneseve në Njësinë Administrative Otlak, mangësi të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave në arkëtimin e të ardhurave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregulloren e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore me të gjithë specialistët që ka miratuar në strukturë si dhe të krijohet Sektor të Masave Shtrenguese.

Brenda vitit 2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Për vitin 2019 të ardhurat nga 503,966 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 307,716 mijë lekë ose në masën 61 %, për shkak të mosrealizimit në zëra të veçantë si taksa e rentës, taksa e ndikimit në infrastrukturë etj.

Për vitin 2020, planifikimi është në vlerën 528,209 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 333,588 mijë lekë ose 63 %.

Gjatë auditimit është konstatuar se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqitet me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,800 mijë lekë**, taksat vendore me rritje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **4,479 mijë lekë**, tarifave vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër (2020/2021), për vlerën **46,400 mijë lekë**, ulje dhe ngritje të cilat janë të pa shoqëruara me argumentim nga Bashkia Berat.

Për vitin 2021, Bashkia Berat nuk ka miratuar paket të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2020, miratuar me VKB nr. 60, datë 18.12.2019.

Për vitin 2021 të ardhurat nga 500,173 lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 412,173 mijë lekë ose 82 %.

Për vitin 2021, ka pasur mos realizim në vlerën 87,938 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.

Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

7.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Berat, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*), derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Berat nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nënin 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorinë e Doganave dhe nuk mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare.

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Berat nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk

realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

8.Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2021 gjendja e llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 365,251,315 lekë, e cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë Berat. Nga analiza e llogarisë konstatohet se për vlerën 62,019,852 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk ka dokumentacion me pretendimin se është e trashëguar nga ish komunat qysh nga vitit 2015. Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa për evidentimin e këtyre debitorëve dhe arkëtimin e kësaj vlere, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për evidentimin e debitorëve ndaj Bashkisë Berat në vlerën 62,019,852 lekë, për të cilën deri tani mungon dokumentacioni analitik.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

9.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 37,444,849 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 52,591,859 lekë, me rritje prej 15,147,010 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua se vlera 52,591,860 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale për 67 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”.

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

10.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve rezulton se për periudhën objekt auditimi 01.10.2019 deri më 31.12.2021 në Bashkinë Berat rezultojnë 4 investime në proces që nuk janë mbyllur brenda vitit ushtrimor 2021, respektivisht: 1. Objekti - Ujësjellësi Velabisht me vlerë kontrate 154,991,516 lekë; 2. Objekti - Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat me vlerë kontrate 438,06,428 lekë; 3. Objekti - Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara me vlerë kontrate 32,130,929 lekë; 4. Objekti -

Përmirësimi i shtresave rrugore në segmentet rrugore Rruga Antipatrea, Kryqëzimi Spitali Rajonal-Kryqëzimi i By Pass me vlerë kontrate 27,386,832 lekë.

Nga analiza e llogarisë 231 "Investime në proces" rezulton se Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021. Drejtoria e Financës ka bërë kapitalizmin e aktiveve për pjesën e parashikuar për tu likuiduar në buxhet dhe jo për vlerën e situacionit përfundimtar si dhe nuk disponon të dhëna analitike për objektet të cilat nuk janë marrë në dorëzim nga bashkia sipas aneksit nr. 10 pika 3. bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33 dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 56, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (212) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

Nga pasqyrat financiare të vitit 2022, rezulton se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

11.Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjetës Kanalizime Berat SHA ndërsa paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjetës Kanalizime Berat SHA, me NUIS "J....." e cila është shoqëri aksionare me objekt "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotëron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në "Ujësjetës Kanalizime Berat ShA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në vlerën 797,785,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata jo materialë" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".

11.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek "Ujësjetës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

12.Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 84,301,285 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Për 74 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga

Bashkia, në vlerën 63,016,632 lekë, sipas aneksit nr.12, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit, nuk është bërë likuidimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likuidimin e këtyre fondeve për operatorët ekonomik që kanë kryer punimet, nuk janë njoftuar këta operatorë për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme. Veprimet e mosveprimet në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 30, 50.

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

13.Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Brenda vitit 2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 2 prona si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të cilat nuk janë të pasqyruara në llogaritë përkatëse të AAM. Gjithashtu përta i përket pronave të kaluara me VKM në Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative (Sinjë, Otlak,

Roshnik dhe Velabisht), në total 7659 *prona* të cilat nuk janë të regjistruara, nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuara dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve si dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (AShK) Berat. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu II, pika 16.

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një grupi për verifikimin faktik të pronave të kaluara me VKM si dhe të krijohet rregjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Berat.

14.2.Rekomandimi: Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 51 pronave të certifikuara në ASHk Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Berat më 31.12.2022.

Deri më 31.12.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020, ka marrë pjesë vetëm një operatorë ekonomik, BOE “2.. & R.” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 365,057,023 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 365,057,023 lekë pa TVSH, me një OE i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”, ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “Z.” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 9,447,915 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 9,942,305 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975.

lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”, kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “T... & V. H.” ShPK, i renditur i katërti, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DST.

Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 17,905,258 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” Bashkia Berat” me vlerë të fondit limit 27,789,747 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, ka marrë pjesë 2 OE dhe vetëm operatori ekonomik “Z.” ShPK, ka paraqitur ofertës ekonomike me vlerë 26,775,773 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, por nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat është kualifikuar dhe shpallur fitues. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 26,775,773 lekë pa TVSH, me një OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik. Në të gjitha rastet e mësipërme KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorët ekonomik, por duhet t’i kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor skualifikimin e tyre dhe anulimin e tenderit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa (a).

15.1.Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe te pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, “Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”, në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta për kualifikim të DST që lidhen me kapacitetin teknik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu në këto procedura prokurimi janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e, nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në dy procedurat e mësipërm me natyrë ndërtim i linjës së ujësjiellësit, në të cilët kërkohet njohuri të specializuara për kriteret e kapacitetit teknik, formimi profesional i specialistit të fushës (i cili është inxhinier ndërtimi dhe inxhinier gjeolog), nuk përputhet plotësisht me natyrën e objektit të prokurimit (inxhinier hidro), veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 2 të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të jap argumentim për çdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal. Të gjitha kriteret e vendosura, të kenë lidhje të ngushtë me përmasat e natyrën e kontratës.

16.2.Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që në procedurat e prokurimit të cilat kërkojnë njohuri të specializuara lidhur me kapacitetin teknik, formimi profesional i specialistit të fushës të ketë përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

17.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019”, komision i marrjes në dorëzim të mjetit nuk ka kryer kontrollin e plotë fizik të mjetit zjarrfikës dhe nuk është shprehur nëse mjeti i dorëzuar nga operatori ekonomik “T.” ShPK plotëson ose jo specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Numri i specifikimeve teknike të mjetit të dorëzuar, për të cilat është shprehur komisioni, është shumë i vogël krahasuar me ato të kërkuara në DST. Komisioni nuk ka dhënë sigurinë e duhur nëse mjeti zjarrfikës i dorëzuar është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit nuk ka zbatuar urdhrin nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat.

17.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa që në rastet e marrjes së mallrave në dorëzim, komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëjnë identifikimin dhe ballafaqimin e të gjitha specifikimeve teknike të mjetit, me ato të vendosura në dokumentet standarde të tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

18.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019”, konstatohet se komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka trajtuar pretendimin e operatorit ekonomik “A. G.” ShPK, që lidhet me skualifikimin pa të drejtë të tij nga KVO. Komisioni ka anashkaluar këtë shqyrtim dhe është shprehur për çështje të tjera të DST, të cilat nuk kanë lidhje me çështjen e ankesës. Me veprimet dhe mos veprimet e tij komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk ka zbatuar urdhrin e titullarit nr.699 datë 16.10.2019, si dhe nuk i ka dhënë këtij të fundit informacionin e duhur për një vendimmarrje të drejtë për ecurinë e mëtejshme të tenderit. Ky komision duhet të analizonte faktin nëse skualifikimi që ka bërë KVO, është i drejtë ose jo dhe për këtë duhet të kishte dalë me një vendim të cilin duhet ta adresonte te Titullari i AK dhe personi përgjegjës për prokurimin.

18.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa që në rastet e ankesave të bëra nga operatorët ekonomik për çështjet e procedurave të prokurimit publik, komisionet e ngritura për këtë qëllim të shqyrtojnë çështjet për të cilat pretendon anketuesi dhe të informojnë Titullarin e AK për konkluzionin e arritur, në mënyrë që ky informacion të shërbejë për vendimmarrjen e mëtejshme të procesit të prokurimit publik nga Titullari.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

19.Gjetje nga auditimi: Për të realizuar administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre e të tjera detyra që lidhen me procedurat e prokurimit publik, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, veprim në kundërshtim me nenin 57 -Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, të VKM 14 “ datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

19.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin me qëllim administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre e të tjera detyra që lidhen me procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit publik për procedurat “Shërbim konsulence” me objekt “Studim Projektimi KUZ Lagjia Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas” dhe “Hartim projekti Ura e re mbi lumin Osum dhe rikonstruksion i rrugës Gorice-Bilce”, është ngritur KVO me anëtarë që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, por me profesion agronom (edhe kryetar i KVO-së), jurist, ekonomist. Vendosija në KVO e antarëve që nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet, bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/b.

20.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa që në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence”, zyrtarët e prokurimeve të zgjidhen ekspertë të fushës së objektit që prokurohet me qëllim realizimin me objektivitet të procedurës së prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

21.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik” dhe “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, u konstatua se për këto objekte, ka vonesa në fillimin e procesit të kolaudimit (respektivisht 1 vit dhe 100 ditë nga data e përfundimit të punimeve), veprim ky në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kapitulli II, “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 2.

21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa që nëpërmjet grupeve të punës, të realizojë në kohë kolaudimin dhe më pas marrjen në dorëzim të veprave ndërtimore, me qëllim vënien në punë në kohë dhe mirëmbajtjen e tyre, për t’i shërbyer komunitetit me investimet e kryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe të dhënave në SPE për procedurën e prokurimit me objekt “Hartim projekti Ura e RE mbi lumin Osum” dhe “Rikonstruktion i rrugës Gorice-Bilce”, rezulton që OE “N. G.”, ka paraqitur në zbatim të pikës 2.3.3 të KVK si ekspert mjedisi, z. K. B. (edhe arkitekt), i cili nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nuk është i pajisur me licencën III.2.A – “Kategoria shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të kërkuar në DT, duke bërë kualifikimin e tij në kundërshtim me legjislacionin e PP.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 37 “Shërbimi i Konsulencës”, pika 4/dh, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 14,751,780 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

22.1.Rekomandim: Titullari i Bashkisë Berat dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

23.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e dy lejeve si vijon:

- Çështja me nr.4689 prot. datë 07.10.2020 dhe lejes së ndërtimit nr. 809, datë 27.11.2020 me objekt “Godine banimi dhe shërbimi 1,4 dhe 8 kate dhe 1 kate parkimi nëntokë”;

- Çështja me nr.2201 prot. datë 20.05.2021 dhe lejes së ndërtimit nr. 377, datë 01.07.2021 me objekt “Godine banimi dhe shërbimi 1, 6 dhe 8 kate dhe 1 kate parkimi nëntokë”;

Referuar sistemit e-Leje rezulton për lejet e sipërcituara nuk janë mbajtur akt kontrole me subjektin zhvillues; mbikëqyrësin e punimeve dhe firmën zbatuese të punimeve të ndërtimit në kundërshtim me nenin 27/1 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si dhe nenin 51 107 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”.

23.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

24.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, IMT Bashkia Berat ka mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal vendim prishje, në 10 raste për objektet pa leje sipas aneksit nr. 3 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Rezulton se nga IMT nuk është marrë asnjë masë tjetër për prishjen e ndërtimeve pa leje dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, në kundërshtim me nenin 10 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV”, i ndryshuar.

24.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndajë të cilave është

mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

25.Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Berat, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, si dhe nuk ka hartuar një plan veprimi të ri për masat e ri kërkuara, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga 11 masa organizative të ri kërkuara janë zbatuar 3 masa, janë në proces 7 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative.

Nga 2 masa shpërblim dëmi në vlerën 1,203,900 lekë, është në proces gjyqësorë 1 masë në vlerën 188,400 lekë dhe në proces zbatimi 1 masë në vlerë 1,015,500 lekë.

25.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020, si dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e shtatë masave organizative të cilat janë në proces, një masë organizative të pa zbatuar, një masë shpërblim dëmi në vlerën 1,015,500 lekë.

Menjëherë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohe në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,686,164 lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përlllogaritjes së fondit limit të objektit “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, zhvilluar në vitin 2021, rezulton se është marrë pa asnjë referencë teknike të dokumentuar kostoja e llogaritshme 199,904,106 lekë pa TVSH për lagjen Uznovë dhe 98,158,293 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, duke bërë llogaritjen e fondit limit të projektimit veçmas për secilin nën objekt respektivisht 9,285,473 lekë pa TVSH për KUZ Uznovë dhe 6,645,647 lekë pa TVSH për fshatin Duhanas, ose 15,931,120 lekë gjithsej. Llogaritja e fondit limit si dy objekte të ndara, është e paargumentuar teknikisht dhe ka rritur fiktivisht fondin limit të këtij objekti prokurimi. Nga rillogaritja e fondit limit, sipas rrugës së ndjekur nga hartuesi i fondit limit, fondi limit i këtij objekti do të jetë 12,195,733 lekë, ose 3,735,387 lekë më shumë se fondi i planifikuar i

projektimit. Për sa më sipër, diferenca prej **3,394,267 lekë** midis ofertës ekonomike fituese 15,590,000 lekë me vlerën e fondit limit që duhet të ishte llogaritur në fakt 12,195,733 lekë, është dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Berat.

1.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,394,267 lekë pa TVSh** nga z. L. B., në cilësinë e hartuesit të fondit limit të objektit “Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e llogaritjes së gabuar të fondit limit.

Deri më 31.10.2022

Me shkresën i ka dërguar z. L. B. shkresën me nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” i është dërguar z. L. B. për zhdëmtimin e shumës 3,394,267 leke. Nga ana e z. L. B. është dërguar gjykates administrative te shkallës së parë Vlorë akti i njoftimit të padisë me nr. 1924, dt 23.11.2022 me objekt pavleshmërinë absolute të këtij akti.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

2.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019 kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, midis të cilëve edhe operatori ekonomik “A. G.” ShPK, i renditur i pari, me vlerën më të ulët të ofertës ekonomike prej 6,950,000 lekë pa TVSh, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, por nga KVO ky operatorë ekonomik është skualifikuar padrejtësisht. Nga Autoriteti Kontraktor është shpallur fitues operatori ekonomik “T.” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 8,480,000 lekë pa TVSh. Skualifikimi i operatorit ekonomik “A. G.” ShPK, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “T.” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë, ka sjellë **dëm ekonomik në vlerën 1,530,000 lekë pa TVSh**, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.

Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2.

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,530,000 lekë** pa TVSh nga anëtarët e KVO: znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve z.G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, z. L. B., me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Berat.

Deri më 31.10.2022

Me shkresën me nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. U është njoftuar 3 antareve te KVO per zhdemtimin e vleres 1.530.000 leke. Nga ana e personave pergjegjës është depozituar pranë Gjykates Administrative Vlore; akti i njoftimit padia nr 1902, dt 18.11.2022 me objekt pavleshmeri absolute te ketij akti.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, komisioni vlerësimi të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “G. C. G.” ShPK, me marzhë fitimi 16%, ose vlerë të ofertës ekonomike 16,382,394 lekë i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, si dhe ka s’kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “O.” ShPK me marzhë fitimi 5.3%, ose vlerë të ofertës ekonomike 14,855,147 lekë, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST. Veprimet e KVO kanë shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 1,527,247 lekë si diferencë midis dy ofertave.** KVO duhet të kishte kualifikuar OE “O.” ShPK dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK shpalljen e tij fitues. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2.

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,527,247 lekë** pa TVSh nga anëtarët e KVO: L. B., me detyrë n/kryetar i Bashkisë Berat, z. P. S. me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. E. M., me detyrë specialiste e prokurimeve publike.

Deri më 31.10.2022

Me shkresën me nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. U është njoftuar 3 antareve të KVO për zhvendimin e vlerës 1.527.247 leke. Nga ana e personave përgjegjës është depozituar pranë Gjykatës Administrative Vlore e akti i njoftimit padia nr 1902, dt 18.11.2022 me objekt pavleshmeri absolute të ketij akti.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës 28,867,632 lekë me TVSh, realizuar në vitin 2020, fituar nga BOE “M.” ShPK & “E.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të situacionuara, por të pakryera në fakt në vlerën **1,245,690 lekë pa TVSh, e cila konsiderohet dëm ekonomik.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE “M.” ShPK & “E.” ShPK.

4.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,245,690 lekë pa TVSh** nga BOE “M.” ShPK & “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019, me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.10.2022

Drejtoria e Menaxhimit Financiar për arkëtimin e vlerës prej 1,245,690 lekë pa TVSH me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik, Bashkia Berat” vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore për punime të

pakryera, i ka dërguar BOE M. shpk & E. shpk shkresën me nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Më tej, nga ana e Drejtorisë Juridike të Bashkisë Berat është ngritur Kërkesë Padi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me nr 5604 prot datë 28.10.2022 ndaj subjekteve M. shpk dhe E. shpk me objekt “Detyrimin e palëve të paditura M. shpk dhe E. shpk për shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 1,245,690 lekë TVSH për punime të pakryera, por të likujduara”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është realizuar.

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020, me vlerë të kontratës me 154,991,516 lekë TVSh, fituar nga BOE “E. A.” ShPK& “V. K.” ShPK& “L.” ShPK& “E.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të situacionuara, por të pakryera në fakt në vlerën **863,960 lekë pa TVSh, e cila konsiderohet dëm ekonomik.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE “E. A.” ShPK& “V. K.” ShPK& “L.” ShPK& “E.” ShPK.

5.1.Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës **863,960 lekë pa TVSh** nga BOE “E. A.” ShPK & “V. K.” ShPK & “L.” ShPK & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020, me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njesisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 31.10.2022

Është dërguar BOE E. A. shpk & V. K. shpk & L. shpk & E. shpk shkresa nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Më tej, nga ana e Drejtorisë Juridike të Bashkisë Berat është ngritur Kërkesë Padi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me nr 5578 prot datë 28.10.2022 ndaj subjekteve E. A. shpk & V. K. shpk & L. shpk & E. shpk me objekt “Detyrimin e palëve të paditura E. A. shpk & V. K. shpk & L. shpk & E. shpk për shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 863,960 lekë TVSH për punime të pakryera, por të likujduara” .

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është realizuar.

6.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjete për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik “M.” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 4,000,000 lekë dhe është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “L. B.” ShPK me vlerë të ofertës ekonomike 3,875,000 lekë pa TVSh, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është oferta me vlerën më të ulët. Veprimet e KVO kanë shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 125,000 lekë pa TVSh, si diferencë midis dy ofertave të operatorëve ekonomik.** Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirë përdorim i fondeve publike dhe trajtim i barabartë midis operatorëve ekonomik, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2.

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **125,000** lekë pa TVSh nga anëtarët e KVO: z.Xh. Ç., me detyre specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, z.F. D., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, z.A. Sh., me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat.

Deri më 31.10.2022

Me shkresën nr 4027/2 prot datë 09.10.2022 për “Njoftim për përfundime të dala nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” janë njoftuar 3 antarët e KVO për zhvendëtimin e shumës 125.000 leke. Duke filluar nga muaji janar 2023 janë marrë masat për kryerjen e ndalesave nga pagat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, u konstatua se ky objekt me vlerë të situacionuar 154,991,516 lekë me TVSH, edhe pasi janë miratuar ndryshimet në volume (shtesa/pakësimi) në vlerën 139,591,298 lekë me TVSh, ose 90% të vlerës totale, përsëri nuk e kryen funksionin për të cilën është planifikuar të kryhej ky investim. Mos funksionimi i objektit ka sjellë mos furnizimin me ujë të komunitetit, si dhe **përdorimin pa eficientë dhe efektivitet të fondeve publike prej 154,991,516 lekë me TVSh.**

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t’i shërbyer komunitetit në kohë. Të marrë masa për vendosjen në funksionim të linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve nuk do të lejoj ndryshimet e projekt preventivave, vetëm në rastet kur ato janë të argumentuar mirë teknikisht dhe vetëm në rastet kur treguesit e veprës do behet sa më eficiente. Ka përfunduar funksionimi i linjës kryesore të shpërndarjes së furnizimit me ujë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2020 ka shpenzuar vlerën 25,244,853 lekë, nga e cila vlera 16,211,833 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 22 raste, ndërsa vlera 9,033,020 lekë për 6 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmi etj.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 është shpenzuar vlera 10,342,530 lekë, nga e cila 10,064,661 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 9 raste, ndërsa vlera 277,869 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi.

Për vitin 2020 dhe 2021 nga Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore pavarësisht objektit të dëmshpërblimit, është shpenzuar vlera **35,587,383 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Deri më 31.10.2022

Kryetari i Bashkisë ka gritur” Grup Pune”me Urdher nr 624,dt 20.10.022 për analizimin e dosjeve gjyqësore dhe analizen eshkaqeve te humbjeve gjyqësore e parandaliminin e tyre.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, rezulton se tubacioni i situacionuar me DN 200 mm dhe t= 14.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=11.9 mm. Gjithashtu edhe tubacioni i situacionuar me DN 63 mm dhe t= 4.7 mm, është vendosur jo sipas preventivit të ripunuar, por me t=4 mm. Nga sa sipër, vlera e tyre prej 36,698,392 lekë me TVSH, përbën shpenzim jo me efektivitet të fondeve të Bashkisë Berat.

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave teknike të bashkisë, të marrë masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke ushtruar kontrole periodike gjatë realizimit të kontratave të realizuara me fondet publike, në mënyrë që të realizohen objekte që ti shërbejnë komunitetit me efektivitet, për një kohë sa më të gjatë dhe në mënyrë cilësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit te Investimeve do te te ushtroje kontroolle periodike mbi zbatimin e projekteve sipas kontrates ne menyre qe te realizohen objekte qe ti sherbejne komunitetit me efektivitet, per nje kohe sa me te gjate dhe ne menyre cilesore.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje rezultoi se në Bashkinë Berat po kryhen investime ku investitor dhe zhvillues nuk është Bashkinë Berat, por Ujësjiellës Kanalizime Berat –Kuçovë ShA, për të cilën Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat nuk ka mundur përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve, konkretisht objektet:

- “Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimeve në qytetin e Beratit” me vlerë preventivi prej 10,426,746 euro, për të cilën nuk është bërë llogaritja dhe pagesa e

taksën së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,261,636 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat**. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKB nr. 57, datë 28.12.2015 “Për miratimin e paketës fiskale, viti 2019”.

4.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Urban, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është Bashkia Berat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,261,636 lekë**.

Deri më 31.10.2022

Nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urbani është kërkuar ASHK-së për llogaritje të sakta për taksën e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është bashkia e po punohet për vjeljen e kesaj takse.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Berat janë vendosur 31 gjoba në vlerën 9,585,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 2,885,000 lekë, mbetur pa arkëtuar vlera 6,700,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, paraqitur analitikisht në aneksin nr. 2 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikantët IMT-ja, nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

5.1.Rekomandimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë, kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar sipas aneksit nr. 2, pika 6, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2022

IMTV-ja në bashkëpunim me drejtorinë Juridike ka dërguar në gjykatë të gjitha ceshtjet administrative brenda afatit 2 vjeçar nga periudha e auditimit. Aktualisht IMTV –ja është në proces të zbatimit të rekomandimeve dhe në pritje të vendimit të gjykatës për keto ceshtje. Në titujt ekzekutiv do aplikohet edhe kamat vonesat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej **236,557 mijë lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Vlera e detyrimit nga taksapaguesit familjar është 132,259,090 lekë, nga e cila detyrimi për taksën e tokës bujqësore është 62,722,750 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga taksapaguesit privat është 104,298,029 lekë.

Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **236,557 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSh (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSh, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

d-Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Deri më 31.10.2022

Jane derguar bankave te nivelit dyte urdherat e bllokimit nr 5608-5690, prot, dt 31.10.022 te llog bankare. Jane derguar ASHK-së Kerkese per vendosje barrë hipotekore shkresa nr 5715prot,dt 1.10.022. Nga njesite eshte evidentuar ne menyre elektronike lista e debitoreve si dhe eshte ber lajmerimi per vjeljen e tyre nepermjet postes.Ështe Bashkepiunuar me agjenten, Drejtoria Rajonale Tatimore, ASHK, Drejtorine Rajonale Sherbimit Transportit Rrugor dhe Dega e doganes Berat, me shkresen 4572 prot, dt 14.09.022.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e PZHT, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (AShK) Berat.

Për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **43,115,950 lekë** për 1291 persona, nga e cila kanë paguar detyrimet 381 persona me vlerë **12,996,634 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej **910** persona me vlerë **30,119,316 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Berat.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Berat nuk ka të evidentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga ALUIZNI përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat ti jetë drejtuar AShK për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1.

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **30,119,316 lekë** ndaj **910** personave si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore AShK Berat, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 31.10.2022

Nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave i është kërkuar ASHK-së vendosjen e bares hipotekore dhe bare siguruesëper vjeljen e detyrimeveme shkresen nr 5715, 55716dt 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me licencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, rezulton se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 23 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë dhe 1 subjekt që tregon me shumicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 23 subjekte janë pajisur me autorizim 10 prej tyre, kanë mbyllur aktivitetin 3 subjekte, ndërsa nuk janë licensuar me leje për tregtim karburanti 10 subjekte, si pasojë e të cilës janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 8,950,000 lekë, paraqitur në mënyrë analitike në aneksin nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Në dy raste janë nënshkruar akt marrëveshje me subjektet për pagimin me këste të detyrimeve, veprim i pa mbështetur ligjërisht nga Bashkia Berat.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.

8.1.Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **8,950,000 lekë**, për 10 subjekte, sipas aneksit nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2022

U është derguar njoftim shkresor për shlyerjen e detyrimeve gjithë debitorëve, si dhe janë lidhur akt mareveshje per shlyer detyrimet.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i arkëtimin të të ardhurave nga dhënia me qira e objekteve, u konstatua se nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës 3 subjekte, gjithsej **në vlerën 379,893 lekë me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore** (sipas aneksit nr.9 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit). Veprimet e mësipërme janë në papajtueshmëri me nenin

12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura.

9.1.Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **379,893 lekë**, nga tre subjektet debitor, sipas aneksit nr.9 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit, duke llogaritur dhe shtuar edhe kamatëvonesat, në përputhje me kushtet e kontratës.

Deri më 31.10.2022

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, rezultoi se, edhe pas ndryshimeve në projekt, të kërkuara nga sipërmarrësi dhe të miratuara nga investitori, grupa septike në fshatin Lapardha 1, me vlerë të situacionuar 913,030 lekë pa TVSH, nuk është në funksion, pasi është e veçuar dhe e pa lidhur me rrjetin e ndërtuar të KUZ. duke mos qenë në eficientë.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit të inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen, të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, si dhe të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve nuk do të lejoj ndryshimet e projekt preventivave, vetëm në rastet kur ato janë të argumentuar mirë teknikisht dhe vetëm në rastet kur treguesit e veprës do behet sa më eficiente.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces.

E. MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, që për procedurat e prokurimit publik të cilat janë zhvilluar bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **12 punonjësve**, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit) dhe anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit, në procedurat e prokurimit, si më poshtë:

1. Znj. M. S., inxhinierë, me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave dhe strehimit social, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, specialiste e fushës dhe hartuese e kritereve të kapacitetit teknik, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

2. Znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetillësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

3. Znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në tre procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetillësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019 (në cilësinë e anëtres së komisionit të vlerësimit të ofertave).

4. Z. L. B., arkitekt, me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në pesë procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetillësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020 (në cilësinë e hartuesit të fondit limit dhe kryetarit të komisionit vlerësimit të ofertave).

5. Z.P. S., me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në katër procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetillësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020.

6. Znj. E. M., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në pesë procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjia Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020

7. Znj. E. N. (A.), inxhinier, me detyrë specialiste për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit dhe hartuese e kritereve të veçanta të DST (specialiste e fushës për kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional), për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësies Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

8. Z.F. D., me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të njësies së prokurimit dhe hartues i kritereve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019.

9. Z.G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, në cilësinë e ish anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019.

10. Z. E. C., inxhinier mekanik, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, në cilësinë e anëtarit të njësies së prokurimit (specialisti i fushës), ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 18.10.2021, me urdhrin nr.562, datë 14.10.2021, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Blerje mjete për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

11. Znj. B. K., me detyrë inxhinier ndërtimi në Drejtorinë e Urbanistikës, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit dhe hartues i kritereve të veçanta të DST

(specialiste e fushës për kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional), për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

12. Z. A. Dh. me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

13. Z.A. Sh., me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Blerje mjeti për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Hartim projekti” Ura e Re mbi lumin Osum dhe rikonstrukcion i rrugës Gorice-Bilce”, zhvilluar në vitin 2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

II. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Berat t’i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Berat, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore për dy mbikëqyrësit e mëposhtëm:

1. **Z. G. B.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 2134/6 prot datë 29.06.2020 me objekt “Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht”, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me TVSh) 154,991,516 lekë, me sipërmarrës punimesh BOE “E. A.” ShPK & “V. K.” ShPK & “L.” ShPK & “E.” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 863,960 lekë pa TVSh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. **Z. P. M.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 2047/1 prot datë 14.05.2019 me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik”, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me TVSh) 28,867,632 lekë, me sipërmarrës punimesh BOE “M.” SHPK & “E.” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,245,690 lekë pa TVSh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Ky rekomandim është realizuar pasi janë vendosur gjobat përkatëse për të dy mbikëqyrësit.

III. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në fushën e IMT, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 15 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë), në raport me shkeljet e konstatuara për tre persona:

1. Z. G. H. me detyrë, Kryeinspektor i IMTV;

2. Z. F. M., ish Kryeinspektor i IMTV;

3. Z. S. B. me detyrë, Inspektor i IMTV;

Për mos marrjen e masa për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar si dhe për mos marrje të masave për shndërrimin vendimeve të kundërvajtjes administrative në titull ekzekutiv, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe nenit 30

“Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Hapur proces gjyqësor është përgjigja e subjektit ndërkohë që nuk është vënë asnjë dokumentacion në dispozicion në lidhje me këtë rekomandim.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është pranuar, pra rezulton i pa zbatuar.

F. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Berat, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos vulosjen e urdhrit të prokurimit në thesar në disa procedura prokurimi, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154.

- Për anomali në planifikimin e buxhetit me të ardhurat e veta, pasi konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e etëqeverisjes vendore.

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, etj.

2. Znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2020-31.12.2021.

- Për anomali në planifikimin e buxhetit me të ardhurat e veta, pasi konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar etj., në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore.

- Për mos mbajtjen të ngurtësuar 5% të vlerës së kontratës, për riparimin e defekteve të mundshme gjatë një periudhë një vjeçare në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në DST, etj.

3. Z. S. T. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 236,557 mijë lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është pranuar, pra rezulton i pa zbatuar.

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, LIGJIN 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dh enë pikën 1, germa (i), neni 29të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin embrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe të nenit 82 dhe 84 të “Rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Berat**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit:

1.Z. S.H., me detyrë inspektor i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në cilësinë e anëtarit të komisionit për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës, për anomali të konstatuara gjatë kryerjes së këtij procesi, pasi komisioni nuk është shprehur nëse mjeti i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DST, në kundërshtim me urdhrin e titullarit, nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot., “Për ngritjen e komisionit për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës”. Gjithashtu në cilësinë e anëtarit të komisionit për shqyrtimin e ankesës së bërë nga operatori ekonomik “A. G. ShPK, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019”, për mos shqyrtim të ankesës së operatorit ekonomik, pasi komisioni nuk është shprehur për çështjen që ankohet operatori ekonomik.

2. Z D. N., me detyrë drejtues mjeti në Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në cilësinë e anëtarit të komisionit për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës, për anomali të konstatuara gjatë kryerjes së këtij procesi, pasi komisioni nuk është shprehur nëse mjeti i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DST, në kundërshtim me urdhrin e titullarit, nr.793, datë 27.11.2019, nr.5990 prot., “Për ngritjen e komisionit për kontrollin fizik të mjetit zjarrfikës”.

Jane nxjerrë dy urdhëra për masa disiplinore, Urdheri nr. 46 dhe Urdheri nr 47. dt 20.01.2023 për dhenie mase disiplinore per dy punonjes.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

H. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Berat pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë

në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

8.a. Auditim mbi shpenzimet për konsumin e karburantit të mjeteve të Aparatit të Bashkisë Berat.

Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit gazoil për mjetet e flotës së Aparatit të Bashkisë Berat konstatohet se:

Bashkia Berat ka në varësi Njësitë Administrative Velabisht, Otllak, Sinjë dhe Roshnik. Për dhënien e shërbimeve të cilat mbuloohen nga Bashkia Berat nëpërmjet Aparatit të saj disponon në total 15 mjete (nga të cilat 3 automjete janë të pa targuara) në gjendje pune të tipit autovetura, kamion, zjarrëfikse dhe 3 pajisje të cilat punojnë me karburant gazoil të motopompë me rrota, I. dhe F..

Përcaktimi i normativave për konsumin e karburantit gazoil për mjetet e flotës së Aparatit të Bashkisë Berat është kryer mbi bazën e urdhrave të titullarit të institucionit duke u ngritur grupe pune me specialistët të fushës, nga të cilët janë kryer testimet përkatëse sipas procesverbale për secilin mjet konkretisht si më poshtë:

-Me Urdhrin nr. 118, datë 14.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë z. P. S. është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. L. A., z. K. I., z. E. N., z. S. N. dhe z. Y. N. për caktimin e normativave për automjetet M. B. me targë AA..., M. B. me targë AA..., O. V. me targë AA... dhe M. me targë AA... për të cilat grupi i punës ka mbajtur procesverbalin me shkresën nr. 854/1 prot., datë 19.02.2018.

-Me Urdhrin nr. 422, datë 28.05.2019, të Kryetarit të Bashkisë z. P. S. është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. L.A., z. E. Gj. dhe z. K. I. për caktimin e normativave për automjetin B.. me targë AA... për të cilat grupi i punës ka mbajtur procesverbalin me shkresën nr. 2874/1 prot., datë 30.05.2019.

-Me Urdhrin nr. 113, datë 14.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë z. P. S. është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. Y. N., z. F. D. dhe z. E. Gj. për caktimin e normativave për automjetin M. B. me targë AB.... për të cilat grupi i punës ka mbajtur procesverbalin me shkresën nr. 876/1 prot., datë 07.03.2022.

-Me Urdhrin nr. 765, datë 01.11.2016, të Kryetarit të Bashkisë z. P. S. janë miratuar normativat mbi konsumin e karburantit për 9 mjetet e sektorit të MZSH-së dhe për 3 motopompat të llojit me rrota, I. dhe F..

Shpërndarja e karburantit kryhet mbi bazën e planifikimit mujor të miratuar nga titullari i institucionit, nëpërmjet sistemit të kartave të personalizuar të secilit drejtues mjeti.

Litër/Orë

Nr.	Aparati i Bashkisë Berat	Targa	Lloji i mjetit	Sasia e tërhequr	Normativa
1	Aparati i Bashkisë	AA....	M.	2,400	8
2	Aparati i Bashkisë	AA.....	M. B.	1,180	12
3	Aparati i Bashkisë	AA.....	M. B.	2,978	11
4	Aparati i Bashkisë	AA.....	B....	2,315	13.2
5	Aparati i Bashkisë	AA.....	O. V.	2,380	8.8
6	Aparati i Bashkisë	AB.....	M. B.(Furgon)	920	15
7	MZSH	AB	M.	1,614	34
8	MZSH	AB.....	I.	1,740	39
9	MZSH	AA.....	V.	1,480	30
10	MZSH	MR.....	S.	0	53
11	MZSH	Pa targar	I.	1,494	30
12	MZSH	Pa targar	S.	985	30
13	MZSH	Pa targar	V.	460	13.5

14	MZSH	BR.....	M.	270	13
15	MZSH	AB.....	F.R.	304	13
16	MZSH	-	Motopompë I.	293	9 L/Orë
17	MZSH	-	Motopompë me rrota	28	11.5 L/Orë
18	MZSH	-	Motopompë F.	14	1.5 L/Orë
Totali				20,855	

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Me zgjedhje nga 18 mjete për të cilat për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, është konsumuar sasia 20,855 litra karburant gazoil, janë audituar shpenzimet për 5 automjete për të cilat është konsumuar sasia 11,253 litra karburant gazoil ose në masën 53.9% të sasisë totale si më poshtë:

					Litër/Orë
Nr.	Aparati i Bashkisë Berat	Targa	Lloji i mjetit	Sasia e tërhequr	Normativa
1	Aparati i Bashkisë	AA.....	M.	2,400	8
2	Aparati i Bashkisë	AA.....	M. B.	1,180	12
3	Aparati i Bashkisë	AA.....	M. B.	2,978	11
4	Aparati i Bashkisë	AA.....	B....	2,315	13.2
5	Aparati i Bashkisë	AA.....	O. V.	2,380	8.8
Totali				11.253	

Burimi i të dhënave: Bashkia Berat.

Titulli i gjetjes: Nuk ka rregulla të miratuara për monitorimin e procesit të karburantit për mjetet e Aparatit të Bashkisë Berat.

Situata: 1. Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit gazoil për 5 automjete të Aparatit të Bashkisë Berat konstatohet se, nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për të gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.,. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kontrolli teknik, autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletë-dalja nga magazina, kuponi tatimor, fletë-udhëtimi.

2. Mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit justifikues:

a. Në rubrikën e parë “Fletë-udhëtimi” përcaktohet tipi i mjetit, targa, personi i cili e ka mjetin në ngarkim mjetin (shoferi) nënshkruar prej tij, personi autorizues, nënshkruar prej tij dhe sasia e tërhequr e karburantit nga magazina së bashku me kuponin tatimor sipas targave.

b. Në rubrikën e dytë “Kryerja e detyrës” pasqyrohet lëvizja e mjetit (duke përshkruar lëvizjen e mjetit në qyetet apo në fshtra) dhe kilometrat në total që ka përshkruar mjeti sipas ditëve. Në këtë rubrikë nuk evidentohet sa është kilometrazhi në fillim të kryerjes së shërbimit dhe sa është në përfundim të lëvizjes.

c. Në rubrikën e tretë “Rezultatet e punës së mjetit gjatë kohës në shfrytëzim” është pasqyruar ndarja sipas kategorisë së rrugës së përshkruar, konsumi i normativës dhe fakti i konsumit.

3. Nga organet drejtuese të Bashkisë Berat nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual, rregulla ku të jetë pjesë e rregullores së brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit, organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit të karburantit për mjetet e flotës si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për meaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 19, neni 19, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36.

Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i saktë dhe transparent i procesit të monitorimit për konsumin e karburantit.

Shkaku: Mos implementimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për automjetet, makineritë-pajisjet e bashkisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. D. Kryetar i Bashkisë Berat në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. R. Sh. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Pika 8.b. Shqyrtimi i ankesave të ardhura në KLSH.

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit “Të ndryshme të dala gjatë auditimit” u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e Bashkia Berat, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së Z. E. M. dhe Zj. O. F., në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit Z. G. H. me detyrë Kryeinspekt Mbrojtjes së Teritorit, në Bashkia Berat.

Objekti i këtij akt verifikimi janë 3-kërkesat e administruara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me praktikat nr. 47/4 prot., datë 20.03.2023, nr. 47/5 prot., datë 04.04.2023 dhe nr. 47/6 prot., datë 05.04.2023, të paraqitura nga zj. D. B., qytetare e Bashkisë Berat, konkretisht si më poshtë vijon; Në Bashkia Berat referuar programit të auditimit me nr. 208/1prot., datë 10.03.2023, i ndryshuar, është kryer auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Bazuar në veprimtarinë audituese të fazës në terren, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit ka konstatuar:

Bazuar në kronologjinë e shkresave të praqitura bashkëlidhur kërkesave të përcjella në Kontrollin e Lartë të Shtetit nga zj. D. B., se, kjo problematikë ka lindur më herët. Nga ana e pretendueses kërkohet që, Bashkia Berat të marrë masat e duhura për vënien në zbatim të Urdhrit nr.

Për të cilin ka dërguar shkresë edhe Bashkisë Berat, Kryeministrisë, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Avokatit të Popullit, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, etj.

Bazuar në shkresat e vëna në dispozicion rezulton se zj. B. trajtohet nga Bashkia Berat me një bonus qeraje prej 15,000 lekë/muaj. Në lidhje me ankesën e saj, Bashkia Berat, ka parashikuar trajtimin e zj. B. me projektin me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë për vitin 2023”, projekt i cili është ende në proces.

Nga Bashkia Berat referuar kërkesës së Zj. B. me nr. 1380 prot., datë 10.02.2023, i është kthyer përgjigje nga Kryetari i Bashkisë se banesa e saj nuk figuron në listën e banesave që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqsi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, pasi nuk është paraqitur kërkesë për ndihmë financiare pranë Bashkisë Berat sipas

VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret për procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore. Pra banesa e zj. B. nuk është trajtuar si Emergjencë Civile. Gjithashtu në vijim të kërkesave të paraqitura të ankimeses, është vënë në dispozicion të saj, shkresa me nr. 5003 prot., datë 06.10.2022, urdhri i titullarit të Bashkisë Berat për ndjekjen e operacionit të prishjes së objektit të kundërligjshëm të z. R.B., sips urdhrin nr. 581, datë 06.10.2022.


Nga grupi i auditimit i cili po kryen veprimtarinë audituese në Bashkia Berat sipas programit të auditimit me nr. 1027/1prot, datë 15.11.2022, u kërkuar dokumentacion në lidhje me ankesat e paraqitura nga zj. B., pranë KLSH dhe Bashkia Berat, nga ku u vendos në dispozicion informacioni i mëposhtëm:

Lidhur me problematikën disa vjeçare të Znj.D. B. për prishjen e objektit të kundërligjshëm të Z.R. B., nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Berat, ka realizuar prishjen e objektit të kundërligjshëm sipas urdhërit nr. 581, datë 06.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Berat, (foto bashkëlidhur). Pretendimi i ankueses që nuk është realizuar prishja e objektit dhe si pasojë është dëmtuar banesa e saj nuk qëndron pasi objekti i ankueses ka qënë i amortizuar dhe me shkresën nr.90/2 prot., datë 20.05.2019 është shpallur nga ana e Insitutit të Ndërtimit i pabanueshëm deri në rehabilitimin e gjithë zonës, dhe shtetasja është sistemuar nga Bashkia Berat në një ambient tjetër banimi duke u trajtuar me bonus qeraje.

Lidhur me problematikën e tjera që ka ankuesja, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Berat, sqaron se nuk është organi kompetent për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Në lidhje me prishjen e objektit të pretendueses, është mbajtur procesverbali me datë 19.10.2022, nga përfaqësues të Bashkia Berat, z. M. K. Administratori i Lagjes, z. G.H. Kryeinspektori i IMTV, z. A. F. Këshilltar i Kabinetit, z. P. Xh. Drejtor i Shërbimit Social, zj. M. S. Përgjegjës i Sektorit të Strehimit, z. A. M. Shef i PMNZ, z. Gj. N. Drejtor i Policisë Berat, pronarët e banesës e cila u prish z. R. B., zj. A. B. e z. Gj. B..

Më poshtë fotot e vëna në dispozicion nga IMTV Berat.





IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

-Bashkia Berat nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullin III, pika 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

-Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

-Për vitin 2022 titullari i Bashkisë Berat nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.

-Për 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”.

-Bashkia Berat e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me shkresën nr. 737, datë 07.02. 2018 “*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Berat dhe institucioneve në varësi*”. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

-Bashkia Berat për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

-Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të riskut për vitin 2022, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut, nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

-Titullari i Bashkisë për vitin 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

-Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Berat, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komuniukimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Berat ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet

se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim nenin 8 të këtij ligji.

-Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Berat mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1., faqe 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim:

-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.

-Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune real për zbatimin e menjëhershëm të tyre.

-Titullari i institucionit të ndjekë me rigozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e auditit të brendshëm sipas strukturës së miratuar përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në fakt kjo njësi nuk është e plotësuar sipas strukturës së miratuar, pasi për vitin 2022, përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.212, date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 2, ku përcaktohet se Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi 3 anëtarë, përfshirë drejtuesin e njësisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën1., faqe 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

2.1. Rekomandim: Titullari i institucionit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditit të Brendshëm me specialistë sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim kryerjen e auditimeve pa cënuar veprimtarinë e kësaj strukture, marrjen e masave për kryerjen e auditimeve me risk, rritjen e numrit të auditimeve dhe evidentimin e problematikave, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në dobi të komunitetit duke eliminuar në të ardhmen mangësitë e konstatuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka hartuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Berat.

-Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk është hartuar “Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

-Njësia e Auditit të Brendshëm megjithëse ka realizuar planin vjetor të auditimeve, konstatojmë se nuk janë audituar drejtori që paraqesin risk në këtë Bashki si, Drejtoria e Integritimit European dhe Projekteve, Drejtoria e Tatim taksave dhe tarifave të bizneseve, Drejtoria e Planifikimit Urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve Drejtoria e shërbimit social dhe ndihmës ekonomike, Drejtoria e Turizmit dhe aktiviteteve, etj.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit

Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm.

-Nuk janë audituar fushat me risk si edhe nuk është audituar ecuria dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH.

-Mungon memo e planifikimit të auditimit në të gjitha dosjet e auditimit.

Për vitin 2022, mbi 60% e fushave të aktivitetit të Bashkisë Berat, të vlerësuara me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (*Trajtuar më hollësisht në pikën1., faqe 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1. Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e realizimit të tyre.

3.2. Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në drejtori që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është në vlerën 1,211,327 mijë lekë, i miratuar me VKB nr. 94, datë 28.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA-ve 2022-2024”, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet që: “Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësive së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji”. Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Financës znj. R. Sh. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. D. sipas shkresës me nr. 6785 prot., datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësive së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”. *Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.1-2.5, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar konkretisht, totali i buxhetit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 2,153,808 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,769,650 mijë lekë ose në masën 82% me një mosrealizim në vlerën 384,158 mijë lekë.

-Për Artikullin 600 “Paga” është planifikuar në vlerën 480,793 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 440,671 mijë lekë ose në masën 92%. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë e vendeve vakant në strukturë si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë. Konkretisht numri i punonjësve në strukturën e Bashkisë Berat për vitin 2022 është 776 punonjës dhe numri faktik mesatar është 733 pra ka 43 vende vakante ku struktura është realizuar në masën 94%.

-Për Artikullin 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar në vlerën 80,935 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 74,626 mijë lekë ose në masën 92%.

-Për Artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar në vlerën 450,600 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 340,481 mijë lekë ose në masën 76%.

-Për Artikullin 603 “Subvencione” është planifikuar në vlerën 33,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 33,000 mijë lekë ose në masën 100%.

Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për F.. “T.” Sh.a, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë. Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga F.. “T.” Sh.a për financimin e shpenzimeve të domosdoshme.

-Për Artikullin 604 “Transferta korrente të brendshme” është planifikuar në vlerën 10,742 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 9,168 mijë lekë ose në masën 85%. Këto shpenzime përfaqësojnë detyrimet kontraktuale apo ligjore ndaj agjentëve për arkëtimin e taksave dhe tarifave si psh Ujësjetllësi për tarifën e arketuara nga familjet, Drejtoria Rajonale e Tatimeve për Tatimin e thjeshtuar dhe Tatimit mbi të ardhurat personale.

-Për Artikullin 606 “Transferta për buxhetet, familjet dhe individët” është planifikuar në vlerën 510,914 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 484,037 mijë lekë ose në masën 95%. Transfertat për përfituesit e ndihmës ekonomike, paafëtisë, bursat për nxënësit e arsimit parashkollor dhe të mesëm, ndihmat për rastet e fatkeqësive.

-Për Artikullin 609 “Fondi rezervë dhe i kontigjencës” është planifikuar në vlerën 581,821 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 387,664 mijë lekë ose në masën 67%. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46. *Më hollësisht trajtuar në nënparagrafët 2.1-2.5, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat në datën 01.01.2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 95,527,220 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit

2022 vlera 77,527,220 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 60,876,887 lekë, ose 78 % e vlerës së planifikuar, diferenca prej 16,650,333 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 1,367,992 lekë, duke e çuar në 31.12.2021 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 36,018,325 lekë.

Përsa trajtuar më sipër më datë 01.01.2022, Bashkia Berat ka detyrime të prapambetura me burim financimi nga granti, të cilat janë detyrime për investime nga Ministria e Infrastrukturës në vlerën 75,056,351 lekë, është krijuar gjatë vitit 2022 detyrim me vlerë 138,662,088 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në vlerën 173,518,439 lekë.

Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2022, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur me 59,508,895 lekë, ose në masën prej 41.5%.

Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 32,415,751 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 1,067,850 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 576,800 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 1,706,384 lekë, detyrime të tjera në vlerën 251,540 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.1-2.5, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Drejtorja e Taksave dhe Tarifave ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimin i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DTT Bashkia Berat, pasi evidentohet një numër i lartë detyrimesh të paarkëtuara (debitor), për biznesin e madh dhe atë të vogël, institucione shtetërore në vlerën 97,326,756 lekë si dhe abonentë familjarë në vlerën 145,381,248 lekë. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara.

Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat, janë evidentuar mangësi në plotësimin e saj me specialit respektivisht: Përgjegjës Sektori i Taksave dhe Tarifave të Biznesit, Specialist i Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave të Biznesit, Specialist për Taksat dhe Tarifat në Njësinë Administrive Sinjë dhe Punonjës për parkimi dhe tregjet çka sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimet fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “ç”,*

Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Kreu XI, "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar" i ndryshuar, nenet 88-104, dhe Rregulloren e Brendshme e miratuar me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për plotësimin e stafit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave me specialist të fushës dhe përshtatjen e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Udhëzimin i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, gërma "a" dhe "b", Kreu III, pika 32, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifavat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

8.2 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifavat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Berat në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në ifrastrukturë dhe DRSHTRR Berat në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Berat nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë

të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjorbitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbliidhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me insitucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; **në 7 (shtatë)** procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjen. Gjithashtu rezulton se disa prej kërkesave të veçanta si licenca, akte ekspertiza ligjore etj., në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. Vendosja e kriterëve kufizues dhe të pa argumentuara sjellin për pasojë diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu në 4 procedura prokurimi rezulton se nuk janë argumentuar specifikimet teknike të vendosura. Veprime e mosveprime këto të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik, e konkretisht nuk janë në përrputhje me me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5, neni 36, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijim

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit për vitin 2022 rezulton se janë kryer 2 procedura prokurimi ndara nga njëra tjetra, me të njëjtin kod CPV dhe objekt prokurimi, të cilat konsiderohen copëzime fondesh dhe shmangie nga kryerja e

procedurave standarde të prokurimit. Procedura të cilat janë trajtuar sipas kritereve midis kufijve të ulët dhe të lartë monetar, pra nëse do të kryheshin së bashku vlera e tyre shkon mbi kufirin e lartë monetar. Kryerja në mënyrë copëzuar të fondeve, ul afatet e pranimit të dokumentacionit, nuk u jep kohë OE të marrin informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e përgatitjes së dokumentacionit mbi kriteret e kërkuara, *duke sjellë një konkurrencë jo të ndershme, pabarazi midis OE, përdodim fondesh jo në përputhje me parimet e efikasitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, nuk nxit pjesëmarrjen, trajtimin e barabartë, dhe mosdiskriminimin e OE.* Konkretisht janë procedurat e prokurimit me objekt:

1. “Blerje asfalt”, me REF-41318-09-12-2022 me fond limit në shumën **24,999,990 lekë pa TVSh**, me afat për pranimin e ofertave 20 ditë, ku kanë marrë pjesë dy OE nga të cilët është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar e shpallur fitues OE “Sh. ShPK”, me vlerë kontrate në shumën 24,211,750 lekë.

2. “Blerje asfalt”, me REF-29817-05-18-2022, me fond limit në shumën **35,545,730 lekë pa TVSh**, me afat për pranimin e ofertave 20 ditë, ku kanë marrë pjesë dy OE nga të cilët është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar e shpallur fitues OE “Sh. ShPK”, me vlerë kontrate në shumën 37,357,000 lekë. Pra shuma e të dy shpalljeve është në shumën **60,545,720 lekë pa TVSh**, vlerë e cila trajtohet me procedurën e kufirit të lartë monetar, për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave e cila është në vlerën e fondit limit 40,000,000 lekë pa TVSh. *Veprime e mosveprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me nenin 2, nenin 3, nenin 33, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 11, pika 1/a), pika 5, neni 12, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Autoriteti kontraktor Bashkia Berat, të marrin masat që, gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se, bazuar në verifikimin e profileve të anëtarëve, në komisionet e krijuara konstatohet se në Njësinë e Prokurimit në një procedurë nuk ka asnjë specialist të fushës i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kritereve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave në 3 raste nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri për objektin që prokurohet. *Veprime jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74, pika 2, dhe neni 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

Menjëhere dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në dy raste nga Autoriteti Kontraktor nuk është dokumentuar llogaritja e vlerës së kontratës dhe fondit limi. *Veprim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, neni 76, pika 2-3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në dosjen teknike të investimit sipas kontratës “Blerje asfalt” është paraqitur një projektzbatim i cili nuk është nënshkruar nga personat e cituar, duke mos vërtetuar në këtë mënyrë procesin e ndjekur për hartimin e projektzbatimit, subjekti, apo personat të cilët e kanë realizuar etj.

- Realizimi i punimeve është bërë nga Agjencia e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Berat, si dhe nuk është bërë asnjë prokurim për zbatimin e punimeve.

- Nga ana e autoritetit Kontraktor, për mbikëqyrjen e punimeve nuk është përzgjedhur ndonjë individ apo subjekt i licencuar.

- Në dosjen e investimit nuk rezulton dokumentacion mbi realizimin e shtresave rrugore, pas furnizimit me materialin për shtresat, dokumentacion i cili ka të bëjë me:

Dokumentacioni administrativo-ligjor për sipërmarrësin, si person juridik, dhe sheshin e ndërtimit, projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike, dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve, certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre, libri i masave etj.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se realizimi i punimeve civile nga subjekte të pa licencuara, nuk jepet garanci për realizimin e investimit konformë kushteve teknike të zbatimit.

Nuk garantohet cilësia e materialeve të përdorura në ndërtim, për pasojë nuk garantohet jetëgjatësia e punimeve, rrjedhimisht efica e përdorimit të fondeve.

Ndërtimi në përgjithësi dhe i infrastrukturës në këtë rast, kërkon realizimin e disa proceseve që kanë lidhje me përgjegjësinë e realizimit më cilësi, në sasi dhe sipas projekteve të miratuara, të mbikëqyrjes hap pas hapi dhe dokumentimit. Në mungesë të certifikatave të cilësisë së materialeve, në mungesë të testimit, në mungesë të librit të masave, nuk mund të jepet një opinion nëse punimet janë realizuar me cilësi dhe sasinë e kërkuar. ***Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 5, 7, 8, si dhe Udhëzimi i KM nr. 2, datë Kreu III, pika 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)***

14.1. Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masat e duhura për realizimin e investimeve në respekt të dispozitave ligjore për realizimin e tyre. Krahas tenderimit për bazë materiale, duhet të bëhen tenderime për realizimin e punimeve nga subjekte të licencuara sipas objektit në të cilin prokurohet, si dhe realizimi i punimeve duhet të dokumentohet dhe raportohet për të garantuar realizim në sasi dhe cilësi.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se ka kaluar një periudhë mbi 6 muaj referuar kolauditimit të punimeve dhe objekti nuk është marrë akoma në dorëzim nga Bashkia Berat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 132-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

15.1. Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve sipas kontratës përkatëse.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit gazoil për 5 automjete të Aparatit të Bashkisë Berat konstatohet se, nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

2. Mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit justifikues:

a. Në rubrikën e parë “Fletë-udhëtimi” përcaktohet tipi i mjetit, targa, personi i cili e ka mjetin në ngarkim mjetin (shoferi) nënshkruar prej tij, personi autorizues, nënshkruar prej tij dhe sasia e tërhequr e karburantit nga magazina së bashku me kuponin tatimor sipas targave.

b. Në rubrikën e dytë “Kryerja e detyrës” pasqyrohet lëvizja e mjetit (duke përkthyer lëvizjen e mjetit në qyetet apo në fshatra) dhe kilometrat në total që ka përkthyer mjeti sipas ditëve. Në këtë rubrikë nuk evidentohet sa është kilometrazhi në fillim të kryerjes së shërbimit dhe sa është në përfundim të lëvizjes.

c. Në rubrikën e tretë “Rezultatet e punës së mjetit gjatë kohës në shfrytëzim” është pasqyruar ndarja sipas kategorisë së rrugës së përkthyer, konsumi i normativës dhe fakti i konsumit.

3. Nga organet drejtuese të Bashkisë Berat nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual, rregulla ku të jetë pjesë e rregullores së brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit, organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit të karburantit për mjetet e flotës si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 213-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

16.2 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për automjetet, makineritë-pajisjet e bashkisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifave vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat më datën 31.12.2022 (vlerë e cila e konstatuar përgjatë auditimit), konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për

taksat dhe tarifate vendore janë në vlerën 411,883,674 lekë (prej 279,310,927 lekë ose 67.8 % të debitorëve e zënë debitorët e taksave) ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 434,784,105 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 155,473,178 lekë.

2. Gjithashtu konstatohet se, për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nga analiza e kësaj llogarie vlera prej 62,019,852 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish-Komunat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish-Komunat kaluan në administrim nga Bashkia Berat, me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për gjetjen e origjinës dhe arkëtimin e kësaj vlere. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të sistemojë llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifate vendore të kategorisë privat dhe familjar.

17.2 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 62,019,852 lekë trashëguar nga ish-Komunat.

Deri më datë 31.03.2024

18. Gjeje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” konstatohet se vlera prej 88,163,131 lekë kosto historike e kësaj llogarie përbëhet nga 68 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrushme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime” dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.2 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 88,163,131 lekë kosto historike dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Deri më datë 31.03.2024

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Berat nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj..) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është

realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave, tokës bujqësore produktive dhe jo produktive sipas sipërfaqeve faktikë, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27.

-Për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 2 prona si dhe përpara vitit 2019 janë certifikuar 49 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 7659 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 49 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) NJSH, ndërsa 2 objekte janë transferuar me VKM e sipercituara dhe janë të pajisura me certifikat pronësie. Nga Drejtoria e Shërbimeve, Emergjencave civile dhe Pronave, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Berat në Drejtorinë rajonale të ASHK Berat, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 51 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Berat. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

19.2 Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

19.3 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 51 prona të certifikuara në ASHK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiare.

Deri më datë 31.03.2024

20. Gjeje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se deri më datën 31.12.2022, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 97,337,675 lekë në total në Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë Sh.a dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat

financiara të Bashkisë Berat. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për sistemin e vlerën 97,337,675 lekë në llogarinë 213 “Rrugë rjete vepra ujore” e cila i përket aktiveve të transferuara nga Bashkia Berat drejt Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë.

Deri më datë 31.03.2024

21. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 283,538,478 lekë kosto historike. Në këtë vlerë është përfshirë edhe tre mjete konkretisht Kamion me targe TR....., Fadroma B., Ekskavator N. me vlerë kosto historike 4,922,000 lekë të cilat nuk është në gjendje pune. Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 4,922,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 4,922,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 3 automjeteve të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Deri më datë 31.03.2024

22. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2022 paraqitet si aksionare me 65.32% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Berat SHA ndërsa Bashkia Berat paraqitet si aksionare me 34.68% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Berat SHA, me NUIS “J.....” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 876,860 dhe kapital në vlerë monetare prej 876,860,000 lekë. Referuar ekstraktit historik Bashkia Berat zotron 572,787 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 572,787,000 lekë, ose 65.32 % të aksioneve në pjesëmarrje të Bashkisë Berat në “Ujësjellës Kanalizime Berat SHA. Referuar bilancit kontabël 2020-2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet në vlerën 79,075,000 lekë me një nënvlerësim të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën

797,785,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivët afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2024

23. Gjetje nga auditimi: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 21,101,803 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 414,238,546 lekë dhe pakësim në vlerën 430,582,053 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,758,296 lekë. Shtesa e detyrime të Bashkisë Berat për llogarinë 401-408 gjatë vitit 2022 është në vlerën 4,758,296 lekë e cila përbëhet nga 20 shpenzime kryesisht kontrata supervizimi/mbikëqyrje, shërbime dhe blerje mallrash të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten më sipër. Angazhime të marra mbi bazën e planifikimit të pritshëm për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë por këto angazhime janë marrë pa u siguruar të ardhurat reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 217,685,991 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 279,603,637 lekë dhe pakësim në vlerën 246,211,533 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,685,991 lekë të cilat i përkasin kryesisht vendimeve gjyqësore, shërbimeve dhe blerjeve. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 50, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 70. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandim: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoje shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 217,685,991 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Deri më datë 31.03.2024

24. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 85,583,155 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit Berat. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 20,346,860 lekë dhe pakësim në vlerën 17,434,270 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 88,495,745 lekë. Për 109 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia janë ngurtësuar fonde në vlerën 63,016,632 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar

në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të nxjerrjes jashë përdormit të aktiveve, në dy raste për Qendrën Lira dhe Agjencinë e Shërbimeve Publike Berat, në total janë asgjësuar aktive në vlerën totale 1,727,548 lekë për të cilat nuk uk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Konkretisht nuk dokumentohet mënyra e dorëzimit të aktiveve në vend depozitim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nëni 19, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 122. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planit e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit., përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat; 2.“Rikonstruksion objekti, shtesë anësore”, (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 3. “ Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për

“Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 38, Intensiteti i ndërtimit (I), Neni 39, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, Neni 37, lartësia e ndërtimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masat e duhura për të verifikuar materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse, përpara miratimit të lejeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika në të cilën pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat; 2. “Objekt kulturi 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat; 3. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 4. “Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 34, Neni 35; me Vendim Nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen e mënyrës dhe mungesën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr.432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat; 2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr.636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 14, në të cilën përcaktohet se dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi. Gjithashtu në parcelat të cilat pozicionohen në zonat e reja për zhvillim dhe kufizohen/bëjnë pjesë në njësi për të cilat është parashikuar zhvillimi i Planit të Detajuar Vendor, bashkia të procedojë me miratimin e PDV-së për të gjithë zonën, në të cilën parashikohet edhe koncepti për infrastrukturën e re, e më pas të vijojnë me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktikë tek të cilat pasqyrohet e njëjta situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores së planit të miratuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë", për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja "Uznove", Berat; 2. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.3, datë 29.12.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar tipologjinë e ndërtimit të lejuar në bazë të njërive strukturore, të përcaktuara sipas planit dhe të zhvillojë propozime të reja për përmirësim e Planit të Përgjithshëm Vendor, në bazë të nevojave dhe kërkesave të reja të zhvillimit të qytetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 praktika tek të cilat pasqyrohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të rilevimit topografik që pasqyron gjendjen ekzistuese të parcelës e objekteve me të cilat kufizohet dhe mospasqyrimi i duhur i planvendosjes në të cilën evidentohet njolla e objektit mbi parcelën që do të zhvillohet, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. "Rikonstruksion objekti, shtesë anësore", (pikë karburanti), për të cilën është marrë vendimi Nr. 636, datë 26/10/2022, me zhvillues K. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat; 2. "Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues", për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja "Clirim", Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem, si edhe të verifikojë planvendosjen që të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konform kushteve teknike të projektimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit

të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1.“Shtesë kati në lartësi, anësore ambiente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 2. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat; 3. “Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015,i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15; me Ligjin Nr. 10.440, datë 7.7. 2011, të ndryshuar, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uznove”, Berat; Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në *përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15; (Më hollësisht trajtuar pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje aplikimin e lejeve të ndërtimit dhe sipërfaqeve të ndërtimit, në mënyrë që mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1.“Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 10/1; Neni 14. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet planvendosjes së miratuar dhe realizimit në terren të njollës së ndërtimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Objekt kulturi 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni "M.", me adresë Lagjja “Uzrove”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me *ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, i ndryshuar, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 42 dhe me VKM-në 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 27/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1. Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa për të mbajtur aktkontrollet për fazat e ndërtimit që vijnë pas njoftimit të fillimit të punimeve dhe verifikimin e konformitetit të tyre gjatë ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me moszbatimin në mënyrën e duhur të kontributit privat në favor të fondit publik të banesave sociale, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat parkimi nëntokë, (kati përdhe parkim dhe kati i parë 1/2 banim dhe 1/2 shërbim)”, për të cilën është marrë vendimi Nr.432, datë 14/07/2022, me zhvillues F. ShPK, në adresën Lagjja “30 Vjetori”, Berat. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me *ligjin Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Neni 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1.Rekomandim: Nga DPZHT Berat të merren masa që të realizohet nënshkrimi i kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale dhe të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me përcaktimin sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në duke ju referuar vendimit të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Berat, Kryeinspektori dhe një inspektor i IVMT-së nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me *Ligji Nr.183/2014 datë 24.12.2014, neni 11, të arsimimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 178-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

36.1. Rekomandim: Nga Bashkisë Berat të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 3 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. U konstatuan ndryshime në realizimin e objektit nga projekti i ndërtimit dhe pozicionimi i gjurmës së ndërtimit në ndryshim nga planvendosja e miratuar, përkatësisht në rastet e mëposhtme: 1. “Magazinë për bujqësinë 2 kat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.189, datë 16/03/2022, me zhvillues R. C., me adresë Lagjja “Parangua”,

Berat; 2. “Shtesë kati në lartësi, anësore ambjente për hoteleri-agroturizem me çati, në objekt eksistues”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 303, datë 18/05/2022, me zhvillues S. H., me adresë Lagjja “Clirim”, Berat; 3. “Objekt kulti 3 kat me shërbime 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë”, për të cilën është marrë vendimi Nr.343, datë 03/06/2022, me zhvillues Fondacioni “M.”, me adresë Lagjja “Uznove”, Berat. Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 51 dhe me Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 178-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1. Rekomandim: Nga IVMT Berat të merren masa në vijimësi për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë problematikat që konstatohen nga kontrolli i kryer, duke ekzekutuar vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Gjetje na auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna na auditimi i mëparshëm konstatohet se, Bashkia Berat ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1104/17 datë 07.10.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Berat nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raportin rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 184-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38. Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Menjëherë

39. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Berat nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 55/15, datë 27.07.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

-Nga 25 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 Masa Organizative, janë realizuar 1 masë, janë në proces 7 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 14 masa.

-Nga 6 Masa Dëm Ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim 6 Masa, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe janë ende në proces zbatimi 4 masa.

-Nga 10 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 10 masa, të cilat janë në proces zbatimi 10 masa.

-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Berat: 1 rekomandim për 13 punonjës në lidhje me procedurat e prokurimit, i cili është i pa zbatuar, 1 rekomandim për 2 mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e punimeve i cili është realizuar, 1 rekomandim për 3 punonjës për probleme të konstatuara në fushën e IMT, i cili nuk është pranuar, pra i pa realizuar si dhe për 2 punonjës të PMZSH, i cili është realizuar. Gjithashtu është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezulton e pa zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 184-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

39.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara duke rikërkuar zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për plotësimin e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm me tre punonjës dhe kjo strukturë të realizojë numrin e auditimeve të planifikuara në planet vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1.Rekomandim: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Berat dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore me të të gjithë specialistët që ka miratuar në strukturë si dhe të krijohet Sektor të Masave Shtrënguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Berat nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për evidentimin e debitorëve ndaj Bashkisë Berat në vlerën 62,019,852 lekë, për të cilën deri tani mungon dokumentacioni analitik.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë (231) në llogaritë (212) ose (213), sipas objekteve pasi një pjesë e tyre janë mbyllur dhe duhet të kapitalizohet në aktive afatgjata materiale.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

11.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Berat ShA me vlerë 572,787,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

13.1.Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Brenda vitit 2023

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një grupi për verifikimin faktik të pronave të kaluara me VKM si dhe të krijohet rregjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Berat.

14.2.Rekomandimi: Drejtorin e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 51 pronave të certifikuara në AShK Berat, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Berat më 31.12.2022.

Deri më 31.12.2023

15.1.Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive të KVO lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të jap argumentim për çdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal. Të gjitha kriteret e vendosura, të kenë lidhje të ngushtë me përmasat e natyrën e kontratës.

16.2.Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që në procedurat e prokurimit të cilat kërkojnë njohuri të specializuara lidhur me kapacitetin teknik, formimi profesional i specialistit të fushës të ketë përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa që në rastet e marrjes së mallrave në dorëzim, komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëjnë identifikimin dhe ballafaqimin e të gjitha specifikimeve teknike të mjetit, me ato të vendosura në dokumentet standarde të tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa që nëpërmjet grupeve të punës, të realizojë në kohë kolaudimin dhe më pas marrjen në dorëzim të veprave ndërtimore, me qëllim vënien në punë në kohë dhe mirëmbajtjen e tyre, për t'i shërbyer komunitetit me investimet e kryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndajë të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 601/56 datë 04.12.2020, si dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e shtatë masave organizative të cilat janë në proces, një masë organizative të pa zbatuar, një masë shpërblim dëmi në vlerën 1,015,500 lekë.

Menjëherë

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Deri më 31.10.2023

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave teknike të bashkisë, të marrë masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke ushtruar kontrole periodike gjatë realizimit të kontratave të realizuara me fondet publike, në mënyrë që të realizohen objekte që ti shërbejnë komunitetit me efektivitet, për një kohë sa më të gjatë dhe në mënyrë cilësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Urban, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që zhvillues nuk është Bashkia Berat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,261,636 lekë**.

Deri më 31.10.2023

5.1.Rekomandimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë, kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar sipas aneksit nr. 2, pika 6, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2023

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **236,557 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në AKSh (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSh, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

d-Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Berat, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Deri më 31.10.2023

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për

arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **30,119,316 lekë** ndaj **910** personave si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore AShK Berat, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 31.10.2023

8.1.Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë liçencë në vlerën **8,950,000 lekë**, për 10 subjekte, sipas aneksit nr. 8 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Deri më 31.10.2023

9.1.Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **379,893 lekë**, nga tre subjektet debitor, sipas aneksit nr.9 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit, duke llogaritur dhe shtuar edhe kamatëvonesat, në përputhje me kushtet e kontratës.

Deri më 31.10.2023

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet stafit të inxhiniero-teknik, të marrë masa që në të ardhmen, të miratojë ndryshimet e projekt preventivit, vetëm në rast se ato janë të argumentuara teknikisht, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, si dhe të përmirësojnë treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficente.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, që për procedurat e prokurimit publik të cilat janë zhvilluar bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj 12 punonjësve, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit) dhe anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit, në procedurat e prokurimit, si më poshtë:**

1. Znj. M. S., inxhinierë, me detyrë përgjegjëse e sektorit të pronave dhe strehimit social, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, specialiste e fushës dhe hartuese e kriterëve të kapacitetit teknik, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

2. Znj. F. A., juriste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetllësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

3. Znj. A. Zh., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në tre procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetllësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë të Njësisë Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019 (në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të fertave).

4. Z. L. B., arkitekt, me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në pesë procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetllësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020 (në cilësinë e hartuesit të fondit limit dhe kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave).

5. Z.P. S., me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në katër procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjetllësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjja Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020.

6. Znj. E. M., ekonomiste, me detyrë specialiste e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në pesë procedura prokurimi me objekt:

- “Ujësjiellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 372,286,076 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat dhe drejtorive në vartësi”, me vlerë të fondit limit 17,790,833 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe të pa favorizuara”, me vlerë të fondit limit 9,942,305 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2020.

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

- Studim Projektimi KUZ Lagjia Uznovë, Rajoni nr.3 dhe fshatit Duhanas”, Bashkia Berat, zhvilluar në vitin 2020.

7. Znj. E. N. (A.), inxhinier, me detyrë specialiste për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit dhe hartuese e kritereve të veçanta të DST (specialiste e fushës për kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional), për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarjes se furnizimit me ujë të Njësies Administrative Velabisht Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 131,138,064 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

8. Z.F. D., me detyrë përgjegjës i sektorit mekanik në Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të njësies së prokurimit dhe hartues i kritereve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019.

9. Z.G. B., me detyrë ish specialist i prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin n.80, datë 26.12.2019, në cilësinë e ish anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- “Blerje mjet zjarrfikës për MZSh”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019.

10. Z. E. C., inxhinier mekanik, me detyrë ish specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, në cilësinë e anëtarit të njësies së prokurimit (specialisti i fushës), ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 18.10.2021, me urdhrin nr.562, datë 14.10.2021, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Blerje mjete për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

11. Znj. B. K., me detyrë inxhinier ndërtimi në Drejtorinë e Urbanistikës, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit dhe hartues i kritereve të veçanta të DST.

(specialiste e fushës për kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional), për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

12. Z. A. Dh., me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në një procedurë prokurimi me objekt:

- Rikonstruksion i rrugës “Inerte”, ndërtim ure b/a, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat”, me vlerë të fondit limit 18,497,975 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020.

13. Z.A. Sh., me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Berat, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në dy procedura prokurimi me objekt:

- “Blerje mjete për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë”, me vlerë të fondit limit 4,050,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020”.

- “Hartim projekti” Ura e Re mbi lumin Osum dhe rikonstrukcion i rrugës Gorice-Bilce”, zhvilluar në vitin 2021.

III. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në fushën e IMT, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 15 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë), në raport me shkeljet e konstatuara për tre persona:

4. Z. G. H. me detyrë, Kryeinspektor i IMTV;

5. Z. F. M., ish Kryeinspektor i IMTV;

6. Z. S. B. me detyrë, Inspektor i IMTV;

Për mos marrjen e masa për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar si dhe për mos marrje të masave për shndërrimin vendimeve të kundërvajtjes administrative në titull ekzekutiv, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe nenit 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Berat, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. R. Sh., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos vulosjen e urdhrin të prokurimit në thesar në disa procedura prokurimi, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154.

- Për anomali në planifikimin e buxhetit me të ardhurat e veta, pasi konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, në

kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e etëqeverisjes vendore.

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, etj.

2. Znj. A. Sh., me detyrë specialiste e buxhetit, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2020-31.12.2021.

- Për anomali në planifikimin e buxhetit me të ardhurat e veta, pasi konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar etj., në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore.

- Për mos mbajtjen të ngurtësuar 5% të vlerës së kontratës, për riparimin e defekteve të mundshme gjatë një periudhë një vjeçare në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mjet zjarrfikës për MZSH”, me vlerë të fondit limit 9,247,500 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në DST, etj.

3. Z. S. T. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 236,557 mijë lekë.

NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Berat pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Menjëherë

40. Gjetje nga auditimi: Në katër raste, nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt:

1- “Rindërtim i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara Berat”; 2- “Ndriçimi i qytetit Berat”, 3- “Ndërtim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashkë segmentet rakorduese me rrugën Gjeroven Berat” dhe 4- “Rivitalizimi i mjedisve atraktive turistike në fshatin turistik Roshnik” konstatohet se, në mënyrë të gabuar, është caktuar i njëjti zyrtar pjesëmarrës në grupet e punës, si në hartimin e preventivit të punimeve (fondit limit), specifikimeve teknike (pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit), po ashtu edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, çka përbën “konflikt interesi” në kuptimin e LPP-së si dhe cënon besim publik në kryerjen e procedurave të prokurimit. Veprim i NJP (personit përgjegjës për prokurimin) në mospërputhje me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; neni 73 pika 3, neni 75 pika 2 dhe

nenin 78 pika 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Personi përgjegjës për prokurimin, të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike (librit të masave), sipas kontratës “Ujësjiellësi i Fshatit Duhanas, Fshati Lapardha 1, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat”, rezulton se ka pasaktësi në lidhje me raportimin e sasisë së tubacioneve, sipas diametrave përkatës.

- Për linjat në zonën Otlak dhe Orizaj, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1. “Furnizim vendosje i tubave (përfshirë të gjitha mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin”, sasi të e raportuara në librin e masave dhe situacion përfundimtar, nuk është raportuar në mënyrë të saktë. Është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 50, Ø 63, Ø 75, Ø 110 dhe më pak për diametër Ø 140. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën **35,241 lekë**. Po ashtu, për linjën në zonën Duhanas, sasia e tubacioneve sipas zërit D.1 është certifikuar më shumë tubacione për diametrat Ø 75 dhe Ø 110. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “R. & 2...” SHPK, është në shumën **56,435 lekë**.

- Në zonën Otlak-Orizaj, pas vendosjes së tubave për lidhjet e shtëpive, nuk është bërë rehabilitimi i shtresave asfaltike, në sasinë 76 m². **Vlera 449,920 lekë** (76 m² x 5,920 lekë/m²), është certifikuar më tepër. Mos rehabilitimi i rrugëve sipas specifikimeve, përveç vështirësisë që krijohen për përdoruesit e tyre, bën që dëmtimi i shtresave të rritet në mënyrë të vazhdueshme, duke çuar në degradimin e plotë të shtresave rrugore.

- Në zonën Lapardha 1, rehabilitimi i sipërfaqes pas vendosjes së tubacioneve për lidhjen e shtëpive sipas zërit B.6.5 “Prerja, prishja dhe rikthimi në gjendjen fillestare të rrugëve të asfaltuara”, është ndërtuar vetëm me binder dhe jo asfaltobeton. Për këtë zonë është certifikuar sasia 173.6 m², nga e cila sasia rreth 160 m², rezulton jo me shtresë asfaltike, por binder. Bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, manuali nr. 3, çmimi për shtresë asfaltobetonit me trashësi 6 cm është 2,049 lekë/m². **Vlera 327,840 lekë** (160 m² x 2,049 lekë/m²), është certifikuar në kundërshtim me specifikimet teknike. Mos realizimi i shtresave sipas përcaktimeve, rezulton me dëmtim të shpejtë të tyre, duke rritur shpenzimet për rehabilitimin e mëtejshëm të tyre.

- Kutitë e matësve nuk janë veshur me polisterol në brendësi, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 6.3.2 “Materiali i kutive të matësve të ujit” ku përcaktohet: “*Trupi do të jetë me përmasa 570 x 370 x 120 mm, material llamarine çeliku ST235, 07/10 mm, shtresë me RAL7035 e cila do të vishet me polisterol EPS 15mm*”.

- Në seksionin rrugor Ushqimore-Otlak, por dhe Lapardha 1, sa i takon lidhjeve të shtëpive të cilat ndërpresin segmentin rrugor, shtresat rrugore mbi kanalën e hapur për vendosjen e tubacioneve kanë pësuar ulje si pasojë e mos realizimit të ngjeshjes në parametrat e përcaktuara, por edhe si pasojë e përdorimit të materialit mbushës jashtë parametrave të kërkuar. Ky veprim është në kundërshtim me Specifikimet teknike, pika 4.2 “Shtresa bazë”, ku përcaktohet:

“Shtresa bazë do të thotë një shtresë e sipërfaqes së sipërme që mbështet drejtpërdrejt trafikun dhe/ose një shtresë menjëherë nën veshjen e sipërfaqes bituminoze. Trashësia minimale duhet të jetë 150 mm pas ngjeshjes së duhur. Materiali për shtresën bazë do të merret nga një burim i propozuar nga Kontraktori dhe aprovuar nga Inxhinieri. Nuk duhet të jetë plastike. Madhësia maksimale e çdo grimcë nuk duhet të kalojë 60 mm...”

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. Realizimi i punimeve jo sipas specifikimeve dhe në raste i pa realizuar ndikon në eficiencën e investimit, pasi dëmtimi kryesisht i shtresave rrugore vazhdon jo vetëm për sipërfaqen nën punim, por dhe seksionin tjetër të rrugës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 108-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa për ndalimin nga pagesa e garancisë së punimeve të vlerës 91,676 lekë, për përfitim të padrejtë nga ana e Kontraktorit BOE “R. & 2...” SHPK, si llogaritje të gabuara për dimensionet e tubacioneve.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Berat të kërkojë nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori marrjen e masave për rehabilitimin e shtresave rrugore të dëmtuara nga ndërhyrjet për vendosjen e tubacionit dhe të pa rehabilituara brenda periudhës së garancisë së riparimit të defekteve. Në rast të mos zbatimit sipas specifikimeve teknike, të zbritet vlera 777,760 lekë nga garancia e punimeve dhe të zbatohen sanksionet përkatëse, sipas dëmit të vlerësuar.

Brenda periudhës së garancisë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, në bazë të Ligjit Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46 dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Neni 27. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt:” Sallë Konferencash Berat”, për të cilën është marrë vendimi Nr.204, datë 25/03/2022, me zhvillues Dëshmitarët e Jehovahit, në adresën lagjja “Donika Kastrioti” Berat, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 203,900 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 160-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës 203,900 lekë që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

Menjëherë

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 është shpenzuar vlerën 13,199,926 lekë, nga e cila vlera 8,199,565 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 6 raste, ndërsa vlera 5,000,361 lekë për 3 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, si shfuqizim akti e anulim vendimi (dënim me gjobë IMT, dëmshpërblim dëmi). Për sa trajtuar më sipër **vlera 13,199,926 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Berat.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe

nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 60.

Gjithashtu Bashkia Berat ka zbatuar vendimin gjyqësor nr. 283, datë 22.04.2022, për shlyerjen e detyrimeve ndaj përfituesve të PAK, si detyrime të prapambetura si rezultat e moszbatimit të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, dhe dëmin e shkaktuar nga moslikujtimi në kohë, **në vlerën 6,377,140 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financia për Buxhetin e Shtetit.** Fondet janë akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. *Më hollësisht trajtuar në nënpikat 2.1-2.5, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 5 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 94, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”. Pjesë e këtij buxheti janë parashikuar edhe fondet për projektet artistike të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”. Nga Bashkia Berat për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 2 subjekte është likuiduar shuma 1,631,150 lekë. **Vlera 1,631,150 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 79-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Berat konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën **205,801,565 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën **60,045,082 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Berat janë në **vlerën 265,846,647 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat e përbëra nga:**

- Detyrime për taksën e truallit në vlerën **3,040,910 lekë** për 6,838 familje;
- Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën **23,925,480 lekë** për 6,448 familje;
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **66,676,085 lekë** për 8,077 familje;
- Detyrime për taksën e pastrimit në vlerën **29,132,983 lekë** për 6,394 familje;
- Detyrime për taksën e ndriçimit në vlerën **9,167,850 lekë** për 3,102 familje;
- Detyrime për taksën e gjelbërimit në vlerën **4,689,895 lekë** për 6,387 familje;
- Detyrime për taksën e arsimit në vlerën **3,221,805 lekë** për 5,408 familje;
- Detyrime për taksën e vaditjes dhe kullimit në vlerën **5,526,240 lekë** për 3,151 familje;
- Detyrime për moslikudimin e kamatëvonesave në vlerën **23,138,643 lekë** e ndarë kjo 13,371,796 lekë biznesi i madh, 7,738,608 lekë biznesi i vogël dhe 2,028,239 lekë të tjera.
- Detyrime nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh në vlerën **97,326,756 lekë**. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në nën-pikën 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 265,846,647 lekë**, e cila përbëhet nga:

- 3,040,910** lekë detyrime për taksën e truallit për 6,838 familje;
- 23,925,480** lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 6,448 familje;
- 66,676,085** lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 8,077 familje;
- 29,132,983** lekë detyrime për taksën e pastrimit për 6,394 familje;
- 9,167,850** lekë detyrime për taksën e ndriçimit për 3,102 familje;
- 4,689,895** lekë detyrime për taksën e gjelbërimit për 6,387 familje;
- 3,221,805** lekë detyrime për taksën e arsimit për 5,408 familje;
- 5,526,240** lekë detyrime për taksën e vaditjes dhe kullimit për 3,151 familje;
- 23,138,643** lekë kamatëvonesa e ndarë kjo 13,371,796 lekë biznesi i madh, 7,738,608 lekë biznesi i vogël dhe 2,028,239 lekë të tjera.
- 97,326,756** lekë detyrime nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh.
 - a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.
 - b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

- c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
- d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
- e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Berat, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikim Urban Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizinit Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Berat). Konkretisht deri më datën 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 48,995,273 lekë nga të cilat deri më datë 31.12.2022, është likuduar vlera 13,525,010 lekë si dhe kanë mbetur për likuidimin e kësaj takse 1,229 persona në vlerën **35,470,263 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat**. Gjithashtu Bashkia Berat nuk ka të evedentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Berat jetë drejtuar ASHK Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **35,470,263 lekë** ndaj **1,229** personave.

2.2 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Berat vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrajnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos

ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve, konstatohet se në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 20 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 20 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, nga të cilat 8 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 8 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 1 subjekt i cili nuk ushtron aktivitet në tregtim me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre si dhe nuk janë licensuar me leje tregtim karburanti 8 subjete të cilat ushtrojnë aktivitet dhe kanë pa paguar detyrimin fiskal në vlerën **6,700,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Berat**. Gjithashtu në dy raste janë nënshkruar aktmarrëveshje me subjektet për pagimin me këste të detyrimeve. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisjen me licenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **6,700,000 lekë**, për 8 subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: a. Kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore:

Bashkia Berat ka aktive 11 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore të cilat i përkasin Njësisë Administrative Velabisht që prej vitit 2008. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Velabisht. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën **37,195 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat**.

b. Kontratat për dhënien me qira të ndërtesave:

Për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total janë nënshkruar 15 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve apo efinteozë të cilat administrohen nga Bashkia Berat. Bashkia Berat posedon titull pronësie (Vërtetim hipotekor) vetëm për 4 objekte për të cilat janë nënshkruar 3 kontrata qiraje ndërsa për 11 objekte për të cilat janë nënshkruar 11 kontrata qiraje nuk posedon titull pronësie, ndërkohë që këto objekte janë dhënë me qira. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të ambienteve për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u konstatua se Bashkia Berat nuk ka lidhur kontrata të reja me subjektet po ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit i cili

administron 14 kontrata konstatohet se, 1 subjekt nuk ka shlyer detyrimet e kontratës në vlerën **135,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Berat.**

c. Ligjshmëria e lidhjes së kontratave të qirasë të ndërtesave/objekteve:

Nga auditimi i ligjshmërisë së 14 kontratave të sipërpërmendura për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën e konkurimit si më poshtë:

- Në 14 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Në 14 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Në 14 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Në 14 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- Në 14 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Në 14 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

d. Mbi monitorimin e kontratave:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Berat nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 14 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.

Veprime këto në kundërshtim me *Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar, Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3, pika 7, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”. (Më hollësisht trajtuar në nënparagrafin 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve me të marrë masa për të llogaritur detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **172,195 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve të cilët kanë marrë me qira tokë bujqësore dhe ndërtesa me qira.

4.2 Rekomandim: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë sa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre.

4.3 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Berat, Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se për vitin 2022 por edhe para kësaj periudhe, në territorin e Bashkisë Berat kanë ushtruar aktivitetet subjektet si më poshtë:

1. Subjekti **“P. R. S.” SHPK** me Leje minerare shfrytëzimi nr.1359, dhe NIPT K....., datë 08.06.2009, me vendodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **13,915,000 lekë** për periudhën 2017, 2018, dhe 9 mujorin e vitit 2019. Në lidhje me këtë situatë Bashkia Berat ka paditur këtë të fundit në Gjykatën e Shkallës së Parë me çështje nr. 1570/387/91, datë 21.12.2017. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

2. Subjekti **“B... S.” SHPK** me leje minerare shfrytëzimi nr. 1379, datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **20,207,000 lekë** për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019. Në lidhje me këtë situatë Bashkia Berat ka paditur këtë të fundit dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë me Vendimi nr. 904, datë 03.07.2018. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

3. Subjekti **“B.” SHPK** me leje minerale shfrytëzimi nr. 1394, datë 18.06.2009, me vendodhje Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **8,470,000 lekë** për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

4. Subjekti **“T. E.” SHPK** me leje minerale shfrytëzimi nr. 1101/1, datë 10.10.2017, me vendodhje Roshnik, Berat me sipërfaqe 7 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **19,250,000 lekë** për periudhën 2017-2022 dhe 3 mujorin e vitit 2023. Subjekti “T. E.” SHPK me shkresën me nr. 1956/1 prot., datë 11.03.2019, nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullozor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me Vendim Këshillit Bashkiak nr. 69, datë 07.05.2019, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullozor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror por nuk ka ardhur miratimi nga MTM.

5. Subjekti **“E.” SHPK** me leje minerale shfrytëzimi nr. 1597, datë 17.11.2012, me vendodhje Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **23,613,000 lekë** për periudhën 2017-2021, dhe 11 mujorin e vitit 2022. (Detyrim i përlllogaritur deri me përfundimin e lejes mierare).

6. Subjekti **“T... B.” SHPK** me leje minerare shfrytëzimi nr. 1694, datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **30,250,000 lekë** për periudhën 2017-2022 dhe 3 mujorin e vitit 2023. Subjekti “T... B.” SHPK me shkresën me nr. 3155/1 prot., datë 01.10.2021, nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullozor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 01.07.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullozor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për vitin 2021.

7. Subjekti **“K.” SHPK** me leje minerare shfrytëzimi nr. 1909, datë 19.05.2021, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 13.5 ha, ka si detyrim pa arkëtuar ndaj Bashkisë Berat vlerën **10,890,000 lekë** për periudhën 7 mujorin e vitit 2021, 2022 dhe 3 mujorin e viti 2023. Subjekti “K.” SHPK me shkresën me nr. 4799/1 prot., datë 22.07.2021, nga Ministria e

Turizimit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor /kullosor ka zhvilluar procedurën ligjore dhe me vendim me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 18.10.2021, ka dhënë dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik për veprimtaritë minerare dhe gjeologjike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror por nuk ka ardhur miratimi nga MTM.

Detyrimi total nga subjektet të cilat kanë lidhur kontrata për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor deri më datë 31.12.2022, është në vlerën **126,595,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Berat**. Gjithashtu në Bashkinë Berat 7 subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së. *Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", për shfrytëzimin e grupit të rërave dhe zhavorre Bituminoze neni 15, pika 5, Neni 24, pika 10, Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.6, faqe 47-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve të marrë masat e duhura dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **92,473,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj 5 subjekteve debitorë të cilët ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit minerar dhe inerteve. Gjithashtu për 2 subjektet e tjerë të cilët kanë detyrimin në vlerën prej **34,112,000 lekë** dhe janë në proces gjyqësor nuk mund të japim një rekomandim deri në shprehjen me vendim të Gjykatës në lidhje me këto procese.

5.2 Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar të masa të menjëhershme ku t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Berat, gjatë periudhës 01.01.2022 -3 1.12.2022, ka marrë 14 vendime për "Dënim me gjobë", nga të cilat 6 janë likuaduar, ndërsa 8 vendime janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 1 vit, 1,350,000 lekë. Vendimet për gjobë janë dhënë në vitin 2022 dhe në vitin 2023 është vijuar me kërkesë për urdhër ekzekutimi. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me *Ligji Nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet*

administrative”, neni 9/neni 22. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 178-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 1,350,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Berat**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

A. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për;

1. **Zj. R. Sh.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2022, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm;
2. **Z. Xh. M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për parregullsitë e konstatuara në ushtrimin e detyrave në sektorin e Auditit të Brendshëm;
3. **Zj. O. H.**, me detyrë audituese në Sektorin e Auditit të Brendshëm, për parregullsitë e konstatuara në ushtrimin e detyrave në sektorin e Auditit të Brendshëm;
4. **Zj. E. N.**, me detyrë specialist për planifikimin e territorit dhe regjistrin elektronik, nga periudha 24/06/2020 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në lejet e ndërtimit të miratuara në 6 raste;
5. **Zj. A. Zh.**, me detyrë specialist prokurimesh, Ekonomist pranë Drejtorisë Juridike, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në gjashtë procedura, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit;

B. “Vërejtje” për;

1. **Zj. F. A.**, me detyrë specialist prokurimesh, Jurist, pranë Drejtorisë Juridike, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në katër procedura, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit;
2. **Zj. M. S.**, me detyrë Përgjegjës për Pronat dhe Strehimin, Inxhinier Ndërtimi, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në dy procedura;

3. **Z. E. S.**, me detyrë specialist për projektet dhe Regjistrin Elektronik, Urbanist, Arkitekt, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në dy procedura, gjithashtu për parregullsitë e konstatuara në lejet e ndërtimit të miratuara në 6 raste;
4. **Z. A. Dh.**, me detyrë inxhinier pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe monitorimit, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në pesë procedura.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Berat**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

A. “Vërejtje me paralajmërim” për;

1. **Z. L. B.**, me detyrë Zëvendës Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në lidhje me problemet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në 2 raste, gjithashtu për parregullsitë e konstatuara në lejet e ndërtimit të miratuara në 6 raste;
2. **Z. B. Ç.**, me detyrë Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike, për problemet e konstatuara në lidhje zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në dy procedura;

B. “Vërejtje” për;

1. **Z. G. H.**, me pozicion Kryeinspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 10.04.2020-31.03.2023, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara, në 3 raste;
2. **Z.S. B.**, me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 10.04.2020-31.03.2023, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara, në 3 raste;
3. **Z. P. I.**, me pozicion inspektor i IVMT-së Berat, nga periudha 23.02.2022-16.11.2022, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara, në 3 raste.
4. **Z. E. S.**, me detyrë Specialist protokolli, Jurist, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në dy procedura;
5. **Zj. V. P.**, me detyrë specialiste finance, Ekonomiste, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në dy procedura;

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të

dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT